

RAPORTI VJETOR I INSTAT 2021

Tabela e Përmbajtjes

Përmbajtja

Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT	3
I. Sistemi Kombëtar Statistikor	5
Parimet e statistikave zyrtare	5
Objektivat zhvillimorë të Sistemit Kombëtar Statistikor 2017-2021	6
Performanca e Sistemit Kombëtar Statistikor	7
Zbatimi i PSZ 2017-2021 dhe aktivitetet përmirësuese për PSZ 2022-2026.....	9
II. Zbatimi i Planit Vjetor 2021 të PSZ	13
Fusha “Statistikat Demografike dhe Sociale”	13
Fusha “Statistikat Ekonomike”	14
Fusha “Statistikat Sektoriale”	15
Fusha e Statistikave të Mjedisit dhe <i>Multidomain</i>	17
III. Censet.....	19
Censi i Popullsisë dhe Banesave	19
Censi i Bujqësisë	21
IV. Veprimtaria e Institutit të Statistikave – INSTAT	23
Misioni, Vizioni, Vlerat.....	23
Objektivat e Zhvillimit të INSTAT-it	24
V. Cilësia e të dhënave të prodhuara nga INSTAT-i.....	28
Ngarkesa e të Intervistuarve.....	29
Komunikimi dhe Publikimet	34
VI. Bashkëpunimet ndërkombëtare.....	47
VII. Integrimi Evropian	52
VIII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm	54
IX. Organigrama dhe baza ligjore	55
Struktura e Institutit të Statistikave	55
Kadri Rregullator për fushën e prodhimit të statistikave zyrtare	56
X. Veprimtaria e organizmave mbështetëse të prodhimit statistikor	60
Veprimtaria e Bordit Drejtues	60

Veprimtaria e Këshillit të Statistikave	61
Veprimtaria e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën.....	62
XI. Zbatimi i Rekomandimeve	65
Rekomandimet e Kuvendit.....	65
Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit	69
Rekomandimet e <i>Peer Review</i> 2018	70
XII. Burimet financiare dhe njerëzore	73
Burimet Financiare	73
Burimet Njerëzore	76

Fjala përshëndetëse e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT

Të nderuar lexues,

Dokumenti në vazhdim është paraqitja e veprimtarive më kryesore të institutit të statistikave si institucioni koordinues i Sistemit Kombëtar Statistikor, prodhuesi dhe shpërndarësi kryesor i statistikave zyrtare në vend, për vitin 2021.

Viti 2021 korrespondoi me vitin e fundit të Programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare, 2017-2021, vit me të cilin INSTAT dhe vetë sistemi u përball me një vit të vështirë, i impaktuar nga pandemia globale Covid 19, vit ku përballimi i sfidave me mundësitë e ofruara u bë termi i ditës, si në drejtim të zhvillimit të metodave inovative, në drejtim të infrastrukturës, vlerësimit statistikor, qasjes tek përdoruesit me informacion real, cilësor dhe të besueshëm.

INSTAT gjatë vitit 2021 performoi veprimtarinë e tij statistikore duke ruajtur vlerat e statistikave zyrtare, duke zbatuar parimet themelore të statistikave zyrtare të miratuara nga Kombet e Bashkuara dhe parimet e Kodit të Praktikave të Statistikave Evropiane, si një institucion i pavarur, profesional dhe koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor.

Pavarësisht sfidave, INSTAT dhe agjensitë statistikore, kanë rritur gamën e produkteve statistikore duke i shpërndarë ato në kohë dhe transmetuar në Eurostat, duke u bërë pjesë e vazhdueshme e databazës së statistikave evropiane, ku Shqipëria ka një vlerësim pozitiv.

Në drejtim të rritjes së standartizimit të proceseve statistikore ka zhvilluar dhe përditësuar arkitekturën standarte të dokumentimit të produkteve statistikore dhe strukturave me orientim prodhues-përdorues, në INSTAT dhe po punon për zbatimin e tij edhe pranë agjensive statistikore. Burimet kryesore të sigurimit të informacionit për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare janë vrojtimit statistikore dhe burimet administrative. Bashkëpunimi me institucionet kontribuuese me informacion statistikor kanë bërë që të rritet ndjeshëm përdorimi i burimeve administrative si burim primar apo i kombinuar i statistikave zyrtare.

Qasja e statistikave zyrtare pranë përdoruesve nëpërmjet rrugëve më të lehta të komunikimit ka bërë që të ato të jenë sa më vizuale nëpërmjet dashbordeve, infografikëve, apo pasqyrimit të tyre edhe në media sociale. Këtë e tregojnë më së miri treguesit në rritje të kënaqësisë së përdoruesve apo besimit në statistikat zyrtare.

Modernizimi i proceseve statistikore ka konsistuar në automatizimin dhe standartizimin e proceseve të prodhimit statistikor dhe përpunimit të të dhënave, duke zhvilluar më tej infrastrukturën teknologjike në proceset e grumbullimit apo përpunimit, si dhe aksesin online në të dhënat mikro për kërkuesit shkencor.

Ndjekja dhe monitorimi i produkteve statistikore për të siguruar cilësinë sipas standarteve janë realizuar nëpërmjet instrumenteve monitoruese si vetvlerësimi dhe auditit statistikor në të gjithë proceset e grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes.

Viti 2021 u karakterizua me përgatitjen për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave, aktivitet i cili do të kryhet në Tetor 2022. Në këtë drejtim, pasja e një baze të plotë ligjore, ngritja e strukturave mbështetëse, puna

parapërgatitore sipas strategjisë së zhvillimit të tij, mbulimi i plotë me fonde i aktiviteteve të censit është një arritje për institucionin dhe për vetë procesin.

Zhvillimi i kapaciteteve ka marrë një rëndësi të veçantë nga INSTAT dhe ka ndikuar në rritjen profesionale të stafit të këtij institucioni, dhe jo vetëm. Në bashkëpunim me partnerët tanë për të patur, statistika të forta rajonale, INSTAT ka punuar jo vetëm për shtimin e gamës së statistikave në këto nivele detajimi, por ka punuar dhe për zhvillimin profesional të punonjësve të bashkive për një qasje sa më cilësore në drejtim të përdorimit të të dhënave dhe analizave socio-ekonomike. INSTAT miraton dhe konsulton, strategjinë e zhvillimit, planet e veprimit, burimet financiare dhe njerëzore, planin e rekrutimeve nëpërmjet Bordit drejtues dhe Këshillit të Statistikave, duke i miratuar më pas në Kuvendin e Shqipërisë.

INSTAT ka një rol të rëndësishëm në prodhimin e treguesve për monitorimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, duke bërë të mundur matjen e tyre për vendin nëpërmjet rritjes së numrit të indikatorëve statistikorë.

Statistikat janë gjuha e komunikimit të progresit të një vendi, dhe si të tilla integrimi i tyre në familjen e madhe evropiane është një proces i rëndësishëm. Për këtë arsye, puna për rritjen e nivelit të përputhshmërisë së akteve ligjore shqiptare me ato evropiane, ka qenë në fokus të këtij institucioni. Për realizimin e veprimtarisë së tij, INSTAT ka bashkëpunuar ngushtësisht me agjensitë statistikore, Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me rreth 30 institucione, kontribues me rekorde administrative dhe informacion statistikor, me universitete si përfaqësues të botës akademike dhe me institucione kërkimore shkencore, me partnerë ndërkombëtarë nëpërmjet programeve afat shkurtra dhe afatmesme.

Sfida e vazhdueshme e këtij institucioni si drejtues i prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave zyrtare në vend vazhdon dhe mbetet cilësia dhe publikimi në kohë, si elementë kryesorë të rritjes së besimit të përdoruesve në statistika reale, transparente, cilësore dhe gjithpërfshirëse!

Sinqerisht,

Elsa DHULI

Drejtore e Përgjithshme

I. Sistemi Kombëtar Statistikor

Sistemi Kombëtar Statistikor në Shqipëri përbëhet nga tërësia e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare sipas Programit të Statistikave Zyrtare. Përkufizimi, veprimtaria dhe aktivitetet koordinuese janë të parashikuara në legjislacionin për statistikat zyrtare.

Aktualisht, prodhuesit e statistikave zyrtare janë:

- a) Instituti i Statistikave dhe zyrat statistikore rajonale në varësi të tij;
- b) Banka e Shqipërisë;
- c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Agjencitë statistikore zhvillojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë statistika zyrtare, të cilat lidhen me fushën e kompetencave të parashikuara në legjislacionin për organizimin e funksionimin e tyre, si dhe në përputhje me parimet e statistikave zyrtare, të përcaktuara në legjislacionin për statistikat zyrtare.

Parimet e statistikave zyrtare

Për të siguruar besueshmërinë e publikut në statistikat zyrtare, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore janë udhëhequr nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, të përafuara edhe nga legjislacioni shqiptar në vitin 2018.

Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane përcakton standarde për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane, për të siguruar statistika cilësore dhe për të arritur besueshmërinë e përdoruesve në to. Ai është ndërtuar mbi një përkufizim të përbashkët të cilësisë së Sistemit të Statistikave Evropiane (SSE) dhe shtrihet në të gjitha fushat e rëndësishme të mjedisit institucional, proceset e prodhimit të statistikave deri në publikimin e statistikave zyrtare evropiane. Parimet e statistikave zyrtare që përmban ky kod janë të përafuara edhe në ligjin për statistikat zyrtare, përkatësisht në nenet 4 e 5 të tij. Synimi i përafërimit të këtyre standardeve mundëson zbatimin e duhur të PSZ-së, nëpërmjet përmirësimit të proceseve të mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të statistikave zyrtare dhe rritjen e imazhit në publik drejt besueshmërisë në statistikat zyrtare. Parimet e statistikave zyrtare, rezultatet sipas të cilave u përmendën më lart, janë si në vijim:

a) "paanshmëria", që nënkupton mënyrën objektive dhe të pavarur të prodhimit të statistikave, të lira nga çdo presion politik ose i grupeve të tjera të interesuara, veçanërisht lidhur me përzgjedhjen e teknikave, përkufizimeve dhe metodologjisë më të mirë të përshtatshme për të arritur objektivat e vendosur. Ajo nënkupton disponueshmërinë e statistikave me një vonesë sa më të vogël për të gjithë përdoruesit;

b) "besueshmëria", që është karakteristikë e statistikave për të reflektuar sa më mirë që të jetë e mundur realitetin, të cilin ato janë parashikuar të përfaqësojnë. Ajo nënkupton përdorimin e kritereve shkencore për zgjedhjen e burimeve, metodave dhe procedurave;

c) "pavarësia profesionale", që i referohet personelit të INSTAT-it ose të agjencive statistikore, gjatë zbatimit të programit, të cilit nuk i lejohet të kërkojë ose të marrë udhëzime nga Qeveria, autoritetet e tjera shtetërore, partitë politike ose çfarëdo lloji grupi tjetër i interesuar, veçanërisht në përzgjedhjen e burimeve të të dhënave, metodave dhe procedurave statistikore, në përmbajtjen, formën dhe kohën e shpërndarjes, si dhe në zbatimin e konfidencialitetit statistikor;

ç) "përkatësia", që është mbledhja e të dhënave që kufizohet në atë çfarë është e nevojshme për arritjen e rezultatit të kërkuar;

d) "kosto-efektiviteti", që është përdorimi më i mirë i mundshëm i të gjitha burimeve të disponueshme dhe kufizimi i barrës së atyre që përgjigjen. Puna dhe kostoja që kërkon prodhimi i statistikave duhet të jenë në përpjesëtim me rëndësinë e rezultatit të kërkuar;

dh) "konfidencialiteti statistikor", që është mbrojtja e të dhënave që lidhen me njësi statistikore të veçanta, të cilat janë marrë direkt për qëllime statistikore ose indirekt nga burime administrative ose të tjera kundër çdo shkeljeje të së drejtës së konfidencialitetit. Ajo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e paligjshëm;

e) "transparenca", që është e drejta e atyre që përgjigjen të kenë informacion mbi bazën ligjore, qëllimin për të cilin janë kërkuar të dhënat dhe masat mbrojtëse të marra.

Objektivat zhvillimorë të Sistemit Kombëtar Statistikor 2017-2021

Gjatë vitit 2021 INSTAT-i, në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore dhe institucionet furnizuese me të dhëna administrative, hartoi Projekt-Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026. Ky proces filloi me ngritjen e Grupit të Punës në INSTAT, ngritjen e ekipeve teknike me anëtarë nga INSTAT dhe institucionet prodhuese/ofruese të të dhënave statistikore dhe duke vijuar më pas me zhvillimin e takimeve konsultative të këtyre ekipeve për çdo fushë statistikore. Si rezultat i diskutimeve të zhvilluara në këto takime u përcaktuan aktivitetet dhe indikatorët statistikorë që parashikohen të kryhen/prodhohen në harkun kohor 2022-2026. Në muajin Dhjetor 2021, INSTAT-i dërgoi në Këshillin e Ministrave Projekt-Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 për tju propozuar Kuvendit për miratim. Gjithashtu në Dhjetor të po atij viti, u dërgua në Këshillin e Ministrave edhe Projekt-Plani Vjetor për vitin 2022.

Në kushtet kur Programi parashikon planin e veprimtarisë së gjithë Sistemit Kombëtar Statistikor në procesin e prodhimit statistikor, u pa e arsyeshme që në brendësi të tij të përfshihen edhe objektivat zhvillimorë të SKS, duke krijuar një lidhje sintetizuese midis objektivave zhvillimorë, aktiviteve statistikore që i dedikohen realizimit të këtyre të fundit dhe indikatorëve matës të performancës së SKS në drejtim të jetësimit të objektivave.

Ecuria e aritjes së objektivave të SKS, për vitin 2021, ka qenë si vijon:

*Objektivi 1: Formalizimi i Sistemit Kombëtar Statistikor dhe harmonizimi i bazës ligjore në fushën e prodhimit statistikor me ato të BE-së. Me ngritjen e Komitetit të Prodhuesve është forcuar dhe bashkëpunimi i agjencive statistikore në proceset e prodhimit statistikor, si dhe në procesin planifikimit dhe monitorimit të aktiviteve statistikore. Ndërkohë, në kuadër të përafritimit me BE, gjatë vitit 2021 janë përafuar me *acquis* 2 akte ligjore të propozuara nga INSTAT-i, si dhe janë zbatuar rekomandimet e Peer Review 2018 të Eurostat në masën 74%.*

Objektivi 2: Përmirësimi i cilësisë statistikore në përputhje me standardet evropiane, duke kënaqur kërkesat gjithnjë e më rritje të përdoruesve. Për arritjen e këtij objektivi, gjatë vitit 2021 janë transmetuar pranë Eurostatit 3.770.059 data points, në krahasim me 2.989.437 të dërguara një vit më parë. Numri i vizitave në faqen e INSTAT ka arritur në 3,285,976. Niveli i kënaqësisë së përdoruesve për statistikën e prodhuara nga INSTAT-i është rankuar në shkallën 3.87 nga 5 pikë të plota ose, e shprehur në përqindje, ky nivel përfaqëson vlerën 77.3 % Janë prodhuar 55 tregues për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe janë realizuar 11 aktivitete nga të cilat janë prodhuar të dhëna të disagreguara në nivel vendor.

Objektivi 3: Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të strukturave të prodhimit statistikor. Për modernizimin e mëtejshëm të proceseve të prodhimit statistikor, specifikisht në procesin e mbledhjes së të dhënave, janë ndërtuar/përditësuar 3 aplikacione CATI/CAWI dhe 9 aplikacione CAPI. Për ngritjen e kapaciteteve të SKS, janë zhvilluar një sërë trajnimesh mbi tema të ndryshme statistikore të organizuar nga INSTAT-i apo nga institucione/organizata të huaja statistikore me pjesëmarrjen e stafit të agjencive statistikore. Në këtë aspekt, nëpërmjet Qendrës së Trajnimit Statistikor, INSTAT ka ofruar trajnime për stafin e INSTAT-it, Bankës së Shqipërisë,

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me qëllim zbatimin e GSBPM, metadatën, raportet e cilësisë auditin statistikor. Për modernizimin e mëtejshëm të proceseve të prodhimit statistikor, Banka e Shqipërisë ka punuar për automatizimin e të gjitha fazave të përpunimit statistikor, ka përditësuar procesin e mbledhjes së të dhënave me anë të software platform VIZOR, ka investuar në ndërtimin e programit për automatizimin e procesit të prodhimit, shpërndarjes dhe raportimit në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare (EUROSTAT, FMN, Bankë Botërore, WTO, etj.) të statistikave të sektorit të jashtëm, bilanci i pagesave, pozicioni i investimeve ndërkombëtare, investime të huaja direkte.

Objektivi 4: Rritja e rolit të përdoruesve në proceset e aktiviteteve statistikore, si të interesuarit e drejtpërdrejtë në performancën e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor. Duke qenë se plotësimi i nevojave të përdoruesve është një ndër qëllimet kryesore të SKS, arritja e këtij qëllimi është e lidhur pashmangshmërisht me rritjen e rolit të përdoruesve në procesin e prodhimit dhe planifikimit statistikor, pasi integrimi i tyre në veprimtarinë e SKS lehtëson procesin e artikullimit të nevojave për të dhëna që këto përdorues kanë. Në këtë kuadër, hartimi i projekt-Programit të ri të Statistikave Zyrtare 2022-2026 iu nënshtua një procesi gjithpërfshirës konsultativ me grupet e interesit, duke i dhënë zë në këtë proces nevojave të përdoruesve për të dhëna të temave të ndryshme statistikore.

Objektivi 5: Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërmjet institucioneve e përdoruesve për të rritur imazhin dhe performancën e institucioneve pjesë të Sistemit Kombëtar Statistikor. Bashkëpunimi ndërinstitucional ka vijuar edhe gjatë vitit 2021 nëpërmjet zbatimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit që INSTAT-i ka nënshkruar me institucionet prodhuese/ofruese të të dhënave statistikore. Gjatë këtij viti është rinovuar memorandum i bashkëpunimit ndërmjet INSTAT-it dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si dhe është nënshkruar një marrëveshje e re bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë. Marrëveshja e mirëkuptimit ndërmjet INSTAT, BSH dhe MFE-së ka ndikuar pozitivisht në forcimin e statistikave makroekonomike dhe cilësinë e EDP të dërguara në Eurostat. Gjithashtu, në funksion të forcimit të bashkëpunimit të SKS me botën akademike, INSTAT-i ka përgatitur një Webinar ku do të prezantojë numrin e radhës të revistës shkencore, duke formësuar kështu bazat për një bashkëpunim të ardhshëm në përgatitjen e artikujve shkencorë, si dhe për kontribimin e përbashkët në zhvillimin e metodave inovative në funksion të modernizimit të mëtejshëm të procesit të prodhimit statistikor.

Objektivi 6: Zhvillimi i proceseve të shpërndarjes së statistikave. Në sajë të përdorimit të metodave/aplikacioneve moderne në procesin e prodhimit statistikor, gjatë vitit 2021 janë përmirësuar afatet e prodhimit statistikor për 8 aktivitete. Ndërkohë, për sa i përket forcimit të lidhjes me përdoruesit dhe ndërgjegjësimin statistikor kanë vijuar takimet me median dhe grupet e ndryshme të interesit me fokus diskutimet për tema të ndryshme statistikore. Kalendar i përbashkët e publikimeve të të dhënave nga Sistemi Kombëtar Statistikor, i ngritur në zbatim të rekomandimeve të Peer Review, ka lehtësuar orientimin e përdoruesve për tu njohur me statistikatat zyrtare.

*Objektivi 7: Zhvillimi i burimeve njerëzore për të rritur kapacitetet profesionale të statistikienëve. Edhe gjatë vitit 2021 ka vijuar procesi i zhvillimit të trajnimeve të organizuara nga INSTAT-i apo institucione/organizata të huaja statistikore. Fokus i këtyre aktiviteteve ka qenë përvetësimi i njohurive mbi përdorimin e aplikacioneve moderne në procesin e prodhimit statistikor, si dhe marrja e njohurive shtesë për përafrimin gjithnjë e më shumë me *acquis*, dedikuar temave të ndryshme statistikore për përmbushjen e kërkesave të kapitullit 18 "Statistikat". Informacioni dhe tregues të detajuar gjenden në Kapitullin nr. XII "Burimet financiare dhe njerëzore" të këtij raporti.*

Performanca e Sistemit Kombëtar Statistikor

Për matjen e progresit në realizimin e objektivave, referuar raporteve të paraqitura pranë Kuvendit dhe Këshillit të Statistikave, INSTAT ka vendosur disa indikatorë performance që mbulojnë shtyllat kryesore dhe më domethënëse në fushën e metodologjisë, prodhimit statistikor, cilësisë statistikore dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga institucionet kompetente kombëtare apo ndërkombëtare. Në këtë kuadër, vlerat e këtyre

indikatorëve shërbejnë për matjen e progresit ndër vite, pasqyrimin e situatës aktuale, si dhe përbëjnë mekanizmin e duhur vlerësues për ndërmarrjen e aksioneve të nevojshme për përmirësim të mëtejshme.

Tabela nr 1 paraqet vlerat e indikatorëve në harkun kohor 2018-2021, si dhe trendin krahasimor të performancës 2020-2021.

Tabela nr. 1 Vlerat e indikatorëve dhe trendi

Indikatorët e performancës	Vlerat absolute/në përqindje				Trendi 2020-2021
	2018	2019	2020	2021	
Indikatorët e performancës për SKS					
Numri i anketave pranë familjeve	10	14	8	9	↗
Numri i NJEF të intervistuar	59.702	81.870	51.302	54.489	↗
Numri i anketave pranë ndërmarrjeve	16	16	15	15	→
Numri i ndërmarrjeve të intervistuar	21.752	20.370	23.503	23.009	↘
Data points në Eurostat data base për Shqipërinë	1.580.153	1.382.072	2.989.437	3.770.059	↗
Indikatorët e performancës për INSTAT-in					
Numri i aktiviteteve të dokumentuara në GSBPM	48	60	70	70	→
Numri i raporteve të cilësisë	20	30	37	48	↗
Indeksi i Nivelit të përgjithshëm të kënaqësisë së përdoruesve	3,73	3,85	3,87	3,88	↗
Kohëzgjatja e anketës për anketat pranë familjeve mesatarisht (në minuta)	40,47	29,61	38,5	33,7	↘
Kohëzgjatja e anketës për anketat pranë ndërmarrjeve mesatarisht (në minuta)	37,87	37,68	33,9	32,1	↘
Numri i vlerësimeve statistikore të kryera	0	2	2	2	→
Numri i publikimeve	159	160	162	164	↗
Numri i publikimeve të reja	12	9	2	0	↘
Publikime në kohë	82,10 %	78,5 %	95,3 %	95 %	→
Numri i aktiviteteve statistikore që kanë përmirësim në afat	27	9	1	8	↗
Numri i vizitave në website	1.341.928	2.001.281	3.285.976	4.362.864	↗

Nga të dhënat e tabelës vërehet:

- rritje e numrit të publikimeve statistikore si pasojë e shtimit të aktiviteteve statistikore dhe treguesve, në funksion të përmbushjes së kërkesave të brendshme dhe të jashtme për të dhëna statistikore;
- rritje e numrit të të dhënave (*data points*) të transmetuara në Eurostat si pasojë e rritjes së gamës së të dhënave të prodhuara dhe transmetuara sipas kërkesave të Eurostatit, nga agjencitë statistikore
- rritje e vazhdueshme e numrit të raporteve të cilësisë për aktivitetet statistikore;
- rritje e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve që lidhet kryesisht me zgjerimin e gamës së statistikave dhe rritjen e cilësisë së statistikave të prodhuara ndër vite, si dhe me përfshirjen gjithnjë e më shumë të grupeve të interesit në proceset e planifikimit statistikor;
- rritje e numrit të anketave pranë familjeve dhe për pasojë rritje e NJEF-ve të intervistuar;
- rritje e numrit të aktiviteteve që kanë përmirësime në afatet e proceseve të prodhimit statistikor, duke tentuar gjithnjë e më shumë drejt përafrimit të afateve të vendosura në *Compendium*-in e Eurostat;
- rritje e numrit të vizitave në faqen e web-it të INSTAT që ka ardhur si pasojë e pasurimit të faqes me produkte statistikore dhe informacion, në drejtim të plotësimit të nevojave të grupeve të interesit, përdoruesve dhe publikut të gjerë.

Ndërkohë, vërehet një trend konstant për numrin e aktiviteteve statistikore të INSTAT-it, të dokumentuara në GSBPM, pasi tashmë po shkon drejt gjithpërfshirjes numri i aktiviteteve statistikore që i nënshtrohen zbatimit të standardeve në planifikimin e proceseve (fazave dhe nënfazave) të prodhimit statistikor. Gjithashtu, rezulton me trend konstant edhe numri i vlerësimeve statistikore të kryera apo numri i anketave pranë ndërmarrjeve.

Vërehet një ulje e kohëzgjatjes së anketës për anketat pranë familjeve dhe ndërmarrjeve, për llogari të INSTAT-it apo BSH, trend i cili tregon fokusin për të reduktuar ngarkesën e të intervistuarve duke punuar vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e pyetësorëve, programeve të mbledhjes së të dhënave, manualeve dhe trajnimitin e anketuesëve.

Për dy vitet e fundit 2020-2021, rezultojnë me një rënie të lehtë vlerat për indikatorët si: numri i ndërmarrjeve të intervistuar, numri i publikimeve të reja dhe numri i publikimeve në kohë, rënie e cila lidhet me pasojat e Covid-19 dhe qasje të reja metodologjike për nxjerrjen e treguesve në rastet e fatkeqësive natyrore.

Zbatimi i PSZ 2017-2021 dhe aktivitetet përmirësuese për PSZ 2022-2026

PSZ 2017-2021 përmban aktivitete statistikore të realizuara nga tre agjencitë statistikore, për mbulimin me të dhëna të katër fushave kryesore si: Statistikat Sociale dhe Demografike, Statistikat Ekonomike, Statistikat Sektoriale, si dhe Statistikat e Mjedisit dhe *Multidomain*. Me anë të planeve vjetore, të miratuara nga Kuvendi, PSZ është përditësuar çdo vit në drejtim të shtimit të aktiviteteve të reja statistikore dhe përmirësimit metodologjik të atyre tradicionale.

Gjatë harkut kohor 2017-2021 janë realizuar 120 aktivitete statistikore me frekuenca të ndryshme, si dhe janë prodhuar 2171 tregues të temave dhe fushave të ndryshme statistikore. Në këtë kategori aktiviteteve përfshihen dhe aktivitetet mbështetëse të Teknologjisë së Informacionit dhe Gjeoinformacionit që ofrojnë infrastrukturën mbështetëse. Sipas llojit të aktiviteteve dhe burimeve, rezulton të jenë realizuar:

- 40 vrojtime statistikore
- 26 aktivitete me të dhëna administrative
- 26 aktivitete me kombinim vërtetues statistikor dhe burim administrativ
- 28 aktivitete mbështetëse


Numri i aktiviteteve të realizuara sipas fushave statistikore rezulton të jetë:

- 20 aktivitete në fushën e Statistikave Demografike dhe Sociale
- 20 aktivitete në fushën e Statistikave Ekonomike
- 45 aktivitete në fushën e Statistikave Sektoriale
- 8 aktivitete në fushën e Statistikave të Mjedisit dhe *Multidomain*
- 11 aktivitete në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe 3 aktivitete të Gjeoinformacionit

Ndërkohë, në Programin e ri 2022-2026 pritet rritje e numrit të aktiviteteve statistikore kryesisht në fushën e Statistikave Sociale dhe Demografike dhe në fushën e Statistikave të Mjedisit dhe *Multidomain*. Numri i aktiviteteve të parashikuara për tu realizuar respektivisht sipas fushave statistikore është:

- 37 aktivitete në fushën e Statistikave Demografike dhe Sociale (INSTAT)
- 20 aktivitete në fushën e Statistikave Ekonomike (INSTAT, BSH, MFE)
- 46 aktivitete në fushën e Statistikave Sektoriale (INSTAT, BSH)
- 15 aktivitete në fushën e Statistikave të Mjedisit dhe *Multidomain* (INSTAT)


Figura nr. 1 Paraqitja grafike e numrit të aktiviteteve sipas fushave statistikore në nivel krahasimor PSZ 2017-2021 dhe PSZ 2022-2026:



Gjatë zbatimit të PSZ 2017-2021, INSTAT ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe aksionesh jo vetëm për realizimin me sukses të aktiviteteve tradicionale, por edhe në interes të përmirësimit të tyre e, për rrjedhojë, cilësisë së të dhënave të prodhuara. Me Programin e ri statistikor 2022-2026 parashikohet që këto përpjekje të vazhdojnë më tej dhe të substancializohen me produkte statistikore gjithnjë e më në përputhje me nevojat e përdoruesve.

Figurat e mëposhtme paraqesi një qasje krahasimore gjatë zbatimit të PSZ 2017-2021 dhe pritshmërive gjatë zbatimit të ardhshëm PSZ 2022-2026 në drejtim të përmirësimeve metodologjike, metodës së mbledhjes së të dhënave, afateve kohore, si dhe trasmetimit të të dhënave në Eurostat.


Figura nr. 2 Numri i aktiviteteve përmirësuese në fushën "Statistikat Demografike dhe Sociale":



Sipas Figurës nr. 2, në fushën “Statistikat Demografike dhe Sociale” gjatë zbatimit të PSZ 2017-2021 janë realizuar përmirësime në drejtim të afateve kohore të realizimit të fazave të prodhimit statistikor dhe transmetimit të të dhënave në Eurostat. Në Programin e ri, në fokus do të jenë kryesisht përmirësimet në drejtim të metodologjisë, mbledhjes së të dhënave dhe transmetimit të të dhënave në Eurostat.


Në fushën “Statistikat ekonomike” gjatë zbatimit të PSZ 2017-2021 vlen të theksojmë përmirësimet në drejtim të metodave të mbledhjes së të dhënave dhe transmetimit të të dhënave në Eurostat, ndërsa në programin e ri statistikor 2022-2026 është parashikuar të kryhen përmirësime kryesisht në drejtim të metodologjisë së realizimit të aktiviteteve dhe afateve kohore të realizimit të fazave statistikore.

Figura nr. 3: Numri i aktiviteteve përmirësuese për fushën “Statistikat Ekonomike”




Në fushën “Statistikat Sektoriale”, gjatë zbatimit të PSZ 2017-2021 si përmirësime të konsiderueshme vlen të veçojmë përmirësimet metodologjike dhe të transmetimit të të dhënave në Eurostat, ndërsa gjatë zbatimit të programit të ri statistikor 2022-2026 do të rritet në mënyrë të konsiderueshme numri i aktiviteteve për përmirësimet metodologjike, afatet kohore të realizimit të proceseve të prodhimit statistikor, metodave të mbledhjes së të dhënave, si dhe transmetimit të të dhënave në Eurostat.

Figura nr. 4: Numri i aktiviteteve përmirësuese në fushën “Statistikat Sektoriale”



Në fushën “Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain”, gjatë zbatimit të PSZ 2017-2021 janë përmirësuar metodologjitë, metodat e mbledhjes së të dhënave, afatet kohore dhe transmetimi i të dhënave në Eurostat. Gjatë zbatimit të PSZ 2022-2026 priten përmirësime të mëtejshme në drejtim të metodologjisë së realizimit të aktiviteteve dhe transmetimit të të dhënave në Eurostat.

Figura nr. 5: Numri i aktiviteteve përmirësuese në fushën “Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain”



II. Zbatimi i Planit Vjetor 2021 të PSZ

Plani vjetor hartohet bazuar në aktivitetet statistikore të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare. Plani vjetor hartohet nga INSTAT-i në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare dhe pasi diskutohet në Këshillin e Statistikave dhe me grupet e interesit, i përcillet Këshillit të Ministrave e më tej, Kuvendit të Shqipërisë për miratim. Mbështetur në ligjin për statistikën zyrtare, zbatimi i Programit sigurohet nëpërmjet Planit Vjetor.

Në Planin Vjetor të vitit 2021 ishin parashikuar 136 aktivitete statistikore për tu realizuar, nga të cilat 124 mbulohen nga INSTAT, 10 nga Banka e Shqipërisë dhe 2 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjatë vitit 2021, INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë angazhuar për realizimin e plotë të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Programit. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për të dhënat administrative janë kryer aktivitetet statistikore kryesisht:

Në fushën “Statistikat Sociale dhe Demografike” janë realizuar plotësisht temat statistikore, si: Popullsia me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri dhe jashtë saj; Puna dhe kostot e punës; Arsimit; Shëndetësia; Të Ardhurat dhe Konsumi; Mbrojtja sociale; Drejtësia dhe Krimi; Kultura.

Në fushën “Statistikat Ekonomike” janë realizuar plotësisht temat statistikore: Statistikat makroekonomike; Statistikat financiare të Qeverisë, fiskale dhe sektorit publik dhe Statistikat e ndërmarrjeve.

Për fushën “Statistikat Sektoriale” janë realizuar temat statistikore: Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi; Energjia; Transporti; Turizmi; Tregtia e jashtme; Bilanci i Pagesave; Çmimet. Sa i përket temës mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin nga 4 aktivitete të planifikuara janë realizuar 3. Nuk është realizuar aktiviteti mbi kërkimin shkencor.

Përsa i përket fushës së “Statistikave të Mjedisit dhe *Multidomain*”, janë realizuar sipas planit aktivitetet nën temën e statistikave të Mjedisit, si dhe aktivitetet që lidhen me informacionin statistikor gjeohapësinor.

Informacioni në vijim paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetet kryesore të realizuara sipas fushave përkatëse statistikore.

Fusha “Statistikat Demografike dhe Sociale”

Gjatë vitit 2021, INSTAT ka prodhuar tregues mbi popullsinë, tregues mbi të huajt me leje qëndrimi dhe azil-kërkuesve; tregues gjinorë; tregues të punësimit dhe papunësisë; treguesit kryesorë të konsumit të Njësive ekonomike familjare (NjEF); tregues mbi nivelin e jetesës; tregues të arsimit; tregues të shëndetësisë; mbrojtjes sociale; tregues të krimeve dhe tregues të kulturës. Për prodhimin cilësor të treguesve të kësaj fushe janë kryer anketa mbi: Buxhetin e Familjes, të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës, Forcat e Punës, si dhe mbi Strukturën e të Ardhurave nga Puna.

Më poshtë paraqiten në mënyrë të detajuar aktivitetet kryesore të realizuara për këtë fushë:

Nga INSTAT:

- ✓ Statistikat e Popullsisë;
- ✓ Statistikat e Migracionit Ndërkombëtar;
- ✓ Statistikat Vitale;
- ✓ Aktivitetet mbështetëse për Censin e Popullsisë dhe Banesave;
- ✓ Piloti i Censit 2021;
- ✓ Përditësimi i aplikacioneve për grumbullimin e të dhënave dhe monitorimin;
- ✓ Përgatitja e informacionit gjeohapësinor për aktivitetet e para numërimit;
- ✓ Planifikimi logjistik dhe materialet mbështetëse;

- ✓ Përditësimi, zbatimi dhe monitorimi i strategjisë së komunikimit;
- ✓ Statistikat e azilit dhe të huajve;
- ✓ Statistikat gjinore;
- ✓ Statistikat nga Anketa Tremujore e Forcave të Punës;
- ✓ Statistikat nga të dhënat administrative të Tregut të Punës;
- ✓ Statistikat nga Anketa e Strukturës së të Ardhurave nga Puna;
- ✓ Statistikat nga të dhënat administrative mbi pagat;
- ✓ Statistika të regjistrimeve në arsim;
- ✓ Statistika të diplomimeve në arsim;
- ✓ Statistika të shpenzimeve të buxhetit të shtetit mbi arsimin publik;
- ✓ Statistika mbi shkaqet e vdekjeve;
- ✓ Statistikat mbi shëndetin publik
- ✓ Statistika nga Anketa e Nivelit të Jetesës;
- ✓ Statistika nga Anketa e Buxhetit të Familjes;
- ✓ Statistika nga të dhënat administrative mbi mbrojtjen sociale;
- ✓ Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave sociale për sistemin ESSPROS;
- ✓ Statistika mbi veprat penale dhe autorë; procedimet penale dhe të pandehurit; të burgosurit;
- ✓ Statistika mbi të dënuarit;
- ✓ Statistika mbi kulturën.

Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk kanë aktivitete në këtë fushë.

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparashikuara në Planin Vjetor:

- ✓ Vdekjet javore;
- ✓ Kryerja e Anketës së të Moshuarve dhe Vetmisë;
- ✓ Aktivitete statistikore lidhur me Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve për qëllime Statistikore;
- Zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të IPA 2017:
 - ✓ Anketa e Nivelit të Jetesës-EU SILC;
 - ✓ Anketa Evropiane e Shëndetit.

Aktivitete të reja statistikore për vitin 2022

- Indeksi i Barazisë Gjinore
- Zbatimi i Klasifikimit ndërkombëtar të krimeve për qëllime statistikore (ICCS)

Fusha “Statistikat Ekonomike”

Në fushën e statistikave ekonomike, agjencitë brenda Sistemit Kombëtar Statistikor, gjatë vitit 2021, kanë prodhuar treguesit e llogarive kombëtare në frekuencë vjetore dhe tre-mujore, tregues strukturorë dhe afatshkurtër për ndërmarrjet; statistika monetare dhe financiare, të borxhit etj. Për prodhimin cilësorë të treguesve të kësaj fushe janë kryer: Anketa mbi statistikën strukturorë të ndërmarrjeve, Anketa mbi listën e mallrave industrialë pranë ndërmarrjeve ekonomike, Anketa mbi çmimet e produkteve industriale dhe ndërtimit.

Në vijim, aktivitetet statistikore të realizuara gjatë vitit 2021 për këtë fushë:

Nga INSTAT:

- ✓ Statistika mbi llogaritë vjetore sipas sektorëve institucionalë;
- ✓ Statistika vjetore dhe tremujore të PBB me metodën e prodhimit dhe me metodën e shpenzimeve;
- ✓ Statistika mbi tabelat burime, përdorime dhe tabelat input-output;

- ✓ Statistika mbi llogaritë rajonale;
- ✓ Statistika nga anketa vjetore për listën e mallrave industrialë pranë ndërmarrjeve ekonomike;
- ✓ Statistika strukturore të ndërmarrjeve;
- ✓ Statistika strukturore në nivel rajonal;
- ✓ Statistika afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike;
- ✓ Statistika nga anketa tremujore e çmimeve në ndërmarrjet ekonomike;
- ✓ Statistika mbi lejet e ndërtimit të miratuara në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ✓ Regjistri statistikor i ndërmarrjeve;
- ✓ Regjistri i njësisve lokale ekonomike.

Nga Banka e Shqipërisë:

- ✓ Statistika mbi llogaritë financiare;
- ✓ Statistika mbi bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera depozituese;
- ✓ Agregatët monetare;
- ✓ Depozitat dhe kreditë;
- ✓ Statistikat mbi normat e interesit të aplikuara per sasitë e reja dhe sasitë gjendje;
- ✓ Statistika mbi bilancin sektorial dhe paraqitjen monetare të korporatave të tjera financiare.

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- ✓ Statistikat financiare të Qeverisë sipas GFSM2014 dhe pasqyrat financiare të konsoliduara të Qeverisë;
- ✓ Statistikat mbi borxhin e sektorit buxhetor të qeverisë dhe borxhin e garantuar;

Aktivitetet statistikore të realizuara nga INSTAT-i, të paparashikuara në Planin Vjetor:

- Zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të IPA 2017 mbi:
- ✓ Statistikat financiare të Qeverisë dhe procedura e defiçitit të tejkaluar;
- ✓ Metodologjinë e llogarive kombëtare;
- ✓ Programin e transmetimit ESA 2010;
- ✓ Llogaritë rajonale;
- ✓ Sektorët institucionalë;
- ✓ Tabelat burim-përdorime dhe *input-output*;
- ✓ Treguesit e disbalancës makroekonomike;
- ✓ Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve;
- ✓ Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve;
- ✓ Statistikat strukturore të ndërmarrjeve;
- ✓ Statistikat e produkteve industriale (PRODCOM)

Fusha “Statistikat Sektoriale”

Në fushën e statistikave sektoriale janë prodhuar tregues të bujqësisë, energjisë, transportit, turizmit, tregtisë së jashtme, çmimeve, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit, nga realizimi i aktiviteteve, në vazhdim:

Nga INSTAT:

Anketa vjetore në bujqësi;

- ✓ Anketa mbi sipërfaqen e mbjellë;
- ✓ Anketa mujore mbi thertoret për gjedhë, derra dhe të imta;
- ✓ Anketa mujore mbi thertoret e shpendëve;

- ✓ Anketa mujore në pularitë për prodhimin e vezëve;
- ✓ Anketa vjetore mbi qumështin;
- ✓ Anketa mujore mbi qumështit e Lopës;
- ✓ Anketa mujore e çmimeve të prodhimeve bujqësore;
- ✓ Anketa tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim;
- ✓ Anketa mujore e turizmit në strukturat akomoduese;
- ✓ Anketa e turizmit në familje;
- ✓ Anketa e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje;
- ✓ Anketa e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në familje.

Në vijim, nga aktivitetet statistikore të realizuara janë prodhuar këto statistika:

Nga INSTAT:

- ✓ Statistika mbi pyjet dhe biodiversitetin;
- ✓ Statistika vjetore bujqësore;
- ✓ Statistika mbi produktet bimore;
- ✓ Statistika mbi sipërfaqen e mbjellë;
- ✓ Statistika mbi blegtorinë, mishin dhe vezët;
- ✓ Statistika mujore mbi monitorimin e aktivitetit të thertoreve për gjedhë, derra dhe të imta dhe thertoreve të shpendëve;
- ✓ Statistika mujore për prodhimin e vezëve;
- ✓ Statistika mujore dhe vjetore mbi grumbullimin dhe përpunimin e qumështit;
- ✓ Statistika mbi qumështin dhe nënproduktet e tij;
- ✓ Statistika tremujore dhe vjetore mbi llogaritë ekonomike në bujqësi;
- ✓ Statistika mujore për çmimet e prodhimeve bujqësore;
- ✓ Statistika tremujore e çmimeve të inputeve në bujqësi dhe i kafshëve për mbarështim;
- ✓ Statistika tremujore dhe vjetore mbi peshkimin;
- ✓ Statistika mbi akuakulturën;
- ✓ Statistika mbi prodhimet organike në bujqësi;
- ✓ Statistika mbi agromjedisin;
- ✓ Statistika të bilancit tremujor dhe të përgjithshëm të energjisë elektrike;
- ✓ Statistika mbi transportin ajror, detar, ujor të brendshëm dhe hekurudhor të mallrave dhe pasagjerëve;
- ✓ Statistika mbi karakteristikat e mjeteve të transportit rrugor;
- ✓ Statistika mbi aksidentet;
- ✓ Statistika mbi lëvizjet (hyrje/daljet) e shtetasve të huaj dhe shqiptarë;
- ✓ Statistika mujore në strukturat akomoduese;
- ✓ Statistika nga anketa e turizmit në familje "Pushime dhe Udhëtime";
- ✓ Statistika mbi investimet direkte mjete dhe detyrime;
- ✓ Statistika mbi tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve;
- ✓ Statistika mbi eksportet/importet e mallrave dhe sipas karakteristikave të ndërmarrjeve;
- ✓ Statistika për indeksin e çmimeve të konsumit (IÇK);
- ✓ Statistika për indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (IHÇK);
- ✓ Statistika të matjes së fuqisë blerëse (MFB);
- ✓ Statistikat e inovacionit pranë ndërmarrjeve ekonomike;
- ✓ Statistikat vjetore mbi teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në ndërmarrje;

Nga Banka e Shqipërisë:

- ✓ Statistika të bilancit mujor dhe tremujor të pagesave;
- ✓ Statistika mbi pozicionin e investimeve ndërkombëtare;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka aktivitete në këtë fushë.

Gjithashtu, në interes të përmirësimit të cilësisë dhe infrastrukturës së prodhimit statistikor, janë kryer aktivitete ku janë përfshirë të tre agjensitë statistikore, si:

- ✓ Koordinimi për konfidencialitetin statistikor dhe aksesin në mikrodata;
- ✓ Trasferimi në Eurostat i metadatës në përputhje me standardin evropian për të gjitha fushat e prodhimit statistikor;
- ✓ Rritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e metadatave për agjencitë e tjera statistikore;
- ✓ Zhvillimi i trajnimeve të statisticienëve për aplikimin e standardit GSBPM, versioni 5.1;
- ✓ Publikimi në faqen elektronike zyrtare të INSTAT-it i raporteve të metadatave, sipas fushave të prodhimit statistikor;
- ✓ Përfshirja e disa pyetjeve dedikuar matjes së treguesve të cilësisë, të cilat duhet të përfshihen në anketat ekzistuese apo të reja që ka kryer INSTAT-i;
- ✓ Matja e kënaqësisë së përdoruesve;
- ✓ Matja e kënaqësisë së punonjësve të INSTAT-it;
- ✓ Pyetëtori i vetëvlerësimit për dy aktivitete statistikore;
- ✓ Auditë statistikor për një aktivitet statistikor;
- ✓ Përmirësimi dhe përditësimi i vazhdueshëm i teknologjisë në nivel hardware dhe software në mbledhjen e të dhënave, duke ruajtur konfidencialitetin dhe privatësinë;
- ✓ Përmirësimi i rregullave të mbrojtjes së të dhënave dhe dokumentimi i plotë i procedurave.

Aktivitete statistikore të parealizuara gjatë vitit 2021:

- Statistikat mbi kërkimin shkencor. Publikimi nuk është kryer për shkak të mungesës së të dhënave nga universitetet publike dhe private, si dhe për shkak të cilësisë së dobët të të dhënave për sektorin e ndërmarrjeve dhe organizatave jo-fitimprurëse.

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparashikuara në Planin Vjetor:

- Prodhimi i të dhënave mbi rasatet e peshkut sipas specieve;
- Zbatimi i projekteve statistikore në kuadër të IPA 2017 mbi:
 - ✓ Statistikat e kërkim-zhvillimit dhe buxhetit të shtetit të alokuar për kërkim-zhvillimin;
 - ✓ Statistikat e bujqësisë;
 - ✓ Indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit dhe çmimet e banesave;
 - ✓ Statistikat e matjes së fuqisë blerëse;
 - ✓ Menaxhimi i cilësisë;
 - ✓ Zbatimin e standardeve për metadatat dhe shkëmbimin e të dhënave.

Fusha e Statistikave të Mjedisit dhe *Multidomain*

Ndër treguesit kryesorë të kësaj fushe, të prodhuar gjatë vitit 2021, mund të përmendim treguesit mbi llogaritë fizike dhe monetare në mjedis, treguesit e ujit, tregues të zhurmave, tregues mbi mbetjet, ku për prodhimin cilësorë të këtyre të fundit është kryer anketë mbi mbetjet e ngurta urbane. Ndërsa, për temën e Informacionit statistikor rajonal dhe gjeohapësinor, ka vijuar procesi i përditësimit të vazhdueshëm të Njësisve Statistikore

(zonave të censit) në zona të veçanta me densitet urban, si dhe përpjekjet dhe bashkëpunimi INSTAT-ASIG për Standardizimin e informacionit Gjeohapsinor.

Në vijim, aktivitetet kryesore statistikore të realizuara gjatë vitit 2021, për këtë fushë:

Aktivitete të kryera nga INSTAT:

- ✓ Statistika mbi llogaritë monetare në mjedis;
- ✓ Statistika mbi llogaritë fizike në mjedis;
- ✓ Statistika mbi mbetjet;
- ✓ Statistika nga anketa vjetore mbi mbetjet e ngurta urbane;
- ✓ Statistika mbi mbetjet industriale;
- ✓ Statistika mbi ujin;
- ✓ Statistika mbi zhurmat;
- ✓ Përditësimi i vazhdueshëm të zonave të censit në zona të veçanta me densitet urban:
 - Përditësimi i gjeodatabazës;
 - Përgatitja e hartave në mbështetje të Censit të Popullsisë dhe Banesave.

Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk kanë aktivitete në këtë fushë.

Aktivitetet statistikore të realizuara, të paparashikuara në Planin Vjetor:

- Llogarite e Emetimeve në Ajër (pjesë e Llogarive Fizike Mjedisore).

III. Censet

Aktivitetet mbi Censet kryhen nga Instituti i Statistikave.

Censi i Popullsisë dhe Banesave

Aktivitetet e Censit ndahen në tre faza kryesore:

1. Faza përgatitore ose para-numërimi
2. Faza e numërimit
3. Faza e pas-numërimit

Gjatë vitit 2021 u realizuan një sërë aktivitetesh përgatitore të Censit. Pas miratimit të ligjit Nr. 140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe të Banesave”, u ngrit Komisioni Qendror i Censit dhe Komisionet e Censit në nivel Bashkie.

Me qëllim kryesor testimin e metodologjisë, pyetësorit, manualeve si edhe aplikacioneve për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin, u organizuan 3 teste paraprake, si edhe u krye pilot i dytë i Censit, ku u testuan të gjitha fazat e tij. Testet u kryen gjatë muajve Mars, Maj dhe Korrik 2021. Testi më i madh gjithëpërfshirës i të gjitha procedurave të censit ishte Pilot Cens. Qëllimi kryesor i tij ishte mbulimi i disa ndarjeve administrative dhe ekzekutimi i fazave përgatitore, me anë të të cilave u testua përshtatshmëria e gjithë planit të Censit dhe organizimit të tij; si dhe testimi në kushte reale i hartografisë, metodologjisë, strukturës organizative, sistemit CAPI, planifikimit logjistik dhe ndërveprimit midis të gjitha burimeve të planifikuara për tu angazhuar në Cens. Pilot Censi i dytë filloi më 4 Tetor 2021 dhe zgjati 6 javë në terren. Pilot Censi u krye në 50 zona të ndryshme (me karakteristika specifike) të shpërndara në nëntë bashki: Tiranë, Fushë Arrëz, Dibër, Korçë, Kamëz, Durrës, Selenicë, Dropull dhe Pustec. Këto zona kanë tipologji të ndryshme dhe mbulojnë disa grupe të popullsisë, si: minoritete të ndryshme, grupe fetare, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara etj.

Pyetësori është hartuar bazuar në rekomandimet e OKB-së dhe Eurostat-it për raundin e Censit të vitit 2020 dhe pasqyron të gjitha kërkesat e Rregullores së Censit (EC) Nr. 763/2008 - të gjitha temat thelbësore. Përveç të gjitha temave thelbësore, pyetësori përmban një numër të përzgjedhur temash jothelbësore që janë të përshtatshme për nevojat tona specifike dhe sigurojnë krahasueshmëri me Censet e mëparshme. Siç përcaktohet në nenin 4 dhe nenin 21 të ligjit nr. 140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe Banesave”, pyetësori përmban pyetje për identitetin etnik, gjuhën dhe besimin fetar, të cilat janë në përputhje me rekomandimet dhe përgjigjet bazohen në vetë-deklarim/deklarimin e lirë jo të detyruar të individëve. Gjithashtu, pyetësori përmban kërkesat e përdoruesve, të mbledhura përmes tryezave konsultative dhe siguron krahasueshmëri me pyetësorin e mëparshëm të Censit. Të tre pyetësorët e Censit si pyetësorët për Njësitë Ekonomike Familjare private, banesat kolektive dhe personat e pastrehë u përditësuan në bazë të rezultateve të testeve paraprake të Censit në terren dhe rishikimit të aplikacioneve përkatëse CAPI. U përgatitën manualët për anketuesit, kontrollorët dhe mbikëqyrësit, materialet e trajnimit dhe testet e vlerësimit.

Komunikimi në lidhje me Censin është thelbësor për të siguruar pjesëmarrjen e popullatës në procesin e numërimit. Fushata informuese lidhur me Pilotin e dytë të Censit përdori mjetet e medias audiovizuale, si dhe u zhvilluan takime me palët e interesuara (bashkitë, donatorët, grupet e interesit, etj.)

Për më tepër INSTAT në periudhën Nëntor – Dhjetor 2021, ka organizuar pilotin për Anketën Pas Cens (APC), si dhe Anketën e Mbimbulimit (AMM). Këto dy aktivitete shumë të rëndësishme shërbejnë për matjen e cilësisë së të dhënave në përmbajtje të Pilot Censit dhe japin një panoramë të plotë të mbulimit të Censit. INSTAT po punon për tabulimin e rezultateve të Pilot Cens, për përdorim të brendshëm dhe për gjetjet në të gjitha proceset e Pilot Censit.

Aktivitetet gjeohapësinore luajnë një rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e Cens. Gjatë 2021, vazhdoi puna për fazën e para-numërimit si: kontrollet e cilësisë së ndërtesave dhe banesave të përditësuara në terren gjatë 2020; përditësimi i kufijve të zonave të numërimit sipas numrit të banesave të identifikuar gjatë përditësimit të hartës në terren në vitet e mëparshme; përditësimi i zonave specifike në terren të censit (ZC), kryesisht në zona urbane. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, njësia e Gjeoinformacionit kontribuoi në përgatitjen e informacionit gjeohapësinor, (ndarja e kufijve të ZC-së, kodifikimi i të gjithë informacionit gjeohapësinor, përgatitja e hartave dixhitale për tu aksesuar në aplikacionin e pyetësorëve të censit, etj.) për të mbështetur aktivitetet e testeve, pilotit të dytë të Cens si dhe APC.

Logjistika, përveç angazhimit që pati për të realizuar me sukses dhe në kohë pilotin, punoi për të vënë në zbatim dhe monitoruar të gjitha procedurat që parashikohen të zhvillohen në Cens (përgatitje materialesh, organizim trajnimesh, shpërndarje dhe grumbullim materialesh, etj).

Teknologjia e informacionit përbën një element të rëndësishëm në procesin e Cens, jo vetëm në kuadër të automatizimit të proceseve, por sidomos për faktin që të dhënat do të mblidhen me pyetësorë elektronikë. Gjatë vitit 2021 vazhdoi puna në lidhje me zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të Cens. U zhvilluan dhe testuan sistemet e Teknologjisë së Informacionit për pyetësorin elektronik, si edhe sistemin e monitorimit të procesit në terren. Një hap i rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës është edhe trajnimi i përdoruesve të këtyre sistemeve. Piloti i dytë ishte një test i rëndësishëm në lidhje me aplikacionet e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave, pasi është një moment kyç për testimin e sistemeve në tërësi.

Aktivitetet e planifikuara në 2022

Në kuadër të menaxhimit dhe organizimit të Censit gjatë vitit 2022 vëmendje e veçantë do t'i kushtohet menaxhimit të cilësisë së proceseve dhe cilësisë së të dhënave, duke mbajtur në vëmendje minimizimin e risqeve që mund të ndikojnë në secilin nga proceset e prodhimit statistikor. Censi, si aktiviteti më i madh që INSTAT kryen, do të mbështetet me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.

Gjatë muajve Dhjetor 2021 – Janar 2022 do të analizohen gjetjet e pilotit të dytë të realizuar në 2021, të cilat do të shërbejnë si bazë për përmirësimet e nevojshme në të gjitha fazat e Censit.

Gjatë vitit 2022 do të finalizohen të gjithë materialet e nevojshme për realizimin e Censit në Tetor 2022, si dhe do të vijojë puna me reflektimin e përmirësimeve të mundshme të rezultuara nga gjetjet e Pilot Censit dhe më pas konsolidimi i të gjithë aplikacioneve, manualeve, materialeve të trajnimit dhe materialeve të tjera mbështetëse.

Aktivitetet do të vazhdojnë me përditësimin e zonave specifike në terren të censit (ZC), objekte në ndërtim, të identifikuar gjatë përditësimit të hartave të kyer gjatë vitit 2021. Gjithashtu, aktivitetet e hartave të cens në fazën e para-numërimit, gjatë dhe pas Censit do të vazhdojnë me kontrollet e cilësisë së të dhënave të ardhura nga terreni dhe përditësimin e gjeodatabazës, përditësimin e kufijve të Zonave të Censit, gjeokodifikimin e njësive gjeografike, përgatitjen e hartave dixhitale të Zonave të Censit për të gjithë zinxhirin e stafit të terrenit - anketues, kontrollorë dhe mbikqyrës, krijimin e hartave "smart" (geodatabase/map format) sipas kërkesave të Njësive të Teknologjisë së Informacionit për tu testuar/aksesuar/integruar në aplikacionin e pyetësorëve të Censit.

Logjistika do të synojë që të vërë në zbatim dhe përditësojë planin logjistik duke marrë parasysh gjetjet e Pilot Censit, si dhe të përmirësojë të gjithë materialet e nevojshme lidhur me organizimin e trajnimeve, shpërndarjen e materialeve dhe grumbullimin e tyre. Gjatë vitit 2022 do të vazhdojnë takimet me pushtetin vendor për një identifikim të saktë të mundësive dhe elementëve që do të mund të sigurohen nga këto struktura, por njëkohësisht edhe duke mbledhur informacion dhe duke vlerësuar nevojat për rastet kur njësitë vendore nuk mund ta mbështesin Censin sipas kërkesave të tij.

Bazuar edhe në gjetjet e Pilotit do të vazhdojë puna në lidhje me zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në mbështetje të Censit. Do të përmirësohen aplikacionet e pyetësorëve dhe sistemet e monitorimit për kontrollorët dhe supervizorët. Aplikacione të përshtatshme do të zhvillohen edhe për menaxhimin e të dhënave, duke përfshirë burimet logjistike dhe ato njerëzore për të përmirësuar operacionet logjistike dhe administrative, duke optimizuar kështu kohën dhe duke rritur cilësinë.

Suksesi i Censit varet në masë të madhe nga angazhimi pozitiv dhe pjesëmarrja e popullatës. Prandaj, gjatë vitit 2022 do të kushtohet një vëmendje e veçantë implementimit dhe monitorimit të strategjisë së komunikimit, elemente bazë të të cilit janë komunikimi me palët e interesuara dhe publikun në përgjithësi. Fushata e komunikimit e cila do të zhvillohet gjatë këtij viti do të promovojë Censin e Popullsisë dhe Banesave do të informojë për qëllimin dhe rezultatet e Censit, si dhe do të ndihmojë në forcimin e besimit në vetë procesin e Censit dhe në institucionet përgjegjëse. Fushata do të arrijë tek publiku dhe palët e interesuara specifike, duke përdorur një shumëllojshmëri të mediave, kanaleve dhe teknikave të komunikimit.

Numërimi i Popullsisë dhe Banesave do të fillojë me datë 1 Tetor 2022 dhe do të vazhdojë për një periudhë gjashtë javore.

Pas numërimit në terren INSTAT do të organizojë anketën pas Censit, për të llogaritur nivelin e besueshmërisë dhe cilësinë e të dhënave të mbledhura, duke përdorur modele statistikore të rekomanduara nga organizatat ndërkombëtare.

Censi i Bujqësisë

Censi i ardhshëm i Bujqësisë është planifikuar të kryhet në vitin 2024, duke ndjekur rekomandimet e Programit Botëror për Censin e Bujqësisë 2020 .

Faza përgatitore për Censin e Bujqësisë ndikohet në terma kohorë dhe logjistik nga Censi i Popullsisë dhe Banesave. Mbi këto baza, INSTAT, në mënyrë që të angazhohet plotësisht për të gjitha aspektet teknike dhe operacionale, nevojitet të shtyjë Censin e Bujqësisë në vitin 2024. INSTAT, gjatë vitit 2021, ka përgatitur një modul pyetjesh, të cilat janë testuar fillimisht në Pilotin e Cens-it të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2021, si dhe do të përfshihen në pyetësorin e Cens-it 2022, me qëllim përditësimin e listës së fermave bujqësore, e cila do të shërbejë si bazë zgjedhje për Cens-in e ardhshëm të njësive ekonomike bujqësore. Për këtë arsye Cens-i i rradhës i Bujqësisë është planifikuar të kryhet pas analizimit dhe përditësimit të bazës së zgjedhjes së të dhënave të gjeneruara nga Censi i Popullsisë dhe Banesave.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, në zbatim të rekomandimit Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e INSTAT-it dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Cens-it të Bujqësisë, INSTAT nisi fazën përgatitore për realizimin e Censit të Bujqësisë. Fillimisht, INSTAT hartoi draft-strategjinë dhe Planin e Veprimit të Cens-it të Bujqësisë me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO). Strategjia përshkruan kërkesat ligjore, teknologjike, operacionale dhe buxhetore për aktivitetin. Kjo do të ndihmojë qeverinë dhe parlamentin Shqiptar, si dhe bashkësinë ndërkombëtare të donatorëve për të propozuar dhe vendosur mbi angazhimet e tyre për të mbështetur dhe zbatuar Censin.

Në aspektin e përcaktimit të kuadrit ligjor për kryerjen e Censit, brenda vitit 2022 INSTAT do të hartojë projektligjin e ri "Për censin e bujqësisë dhe fermave bujqësore", i cili do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Projektakti do të mundësojë përafrimin e standardeve të reja, duke ndjekur rekomandimet e Programit Botëror për Censin e Bujqësisë 2020, si dhe do të shërbejë si akti bazë për nxjerrjen e akteve të tjera të karakterit operacional, duke patur parasysh ndarjen e re administrative të Republikës së Shqipërisë, statusin e INSTAT si organi përgjegjës për mbarëvajtjen e Censit dhe rolin e organeve të vetëqeverisjes vendore.

Bazuar në përcaktimin e qartë të vizionit dhe objektivave strategjike për kryerjen e censit, si dhe në planin përkatës të veprimeve sa më të detajuara, do të bëhet e mundur edhe tërheqja e fondeve nga donatorët, të cilët kanë mbështetur vazhdimisht veprimtarinë statistikore në vend.

IV. Veprimtaria e Institutit të Statistikave – INSTAT

INSTAT është institucioni prodhues kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë, i themeluar në vitin 1993 në zbatim të ligjit nr. 7687, datë 16.03.1993 “Për statistikën”. Në atë kohë, Instituti i Statistikës ishte institucion qendror në varësi të Këshillit të Ministrave, i cili kishte për kompetencë të miratonte numrin e punonjësve të drejtorive apo sektorëve të statistikës në ministri e institucione qendrore si dhe drejtorive të statistikës në rrethe. Në varësi të drejtpërdrejtë të Institutit të Statistikës u krijuan drejtoritë e statistikës në rrethe ndërkohë që drejtori i Institutit të Statistikës miratonte drejtorët ose përgjegjësat dhe punonjësit e statistikës në ministri apo institucionet e tjera qendrore, me propozim të titullarit përkatës.¹ Këshilli i Statistikës ishte organ konsultativ, drejtohej nga drejtori i Institutit të Statistikës i cili miratonte edhe përbërjen e këtij Këshilli.

Në vitin 2004, në zbatim të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, për herë të parë në legjisllacionin e statistikave zyrtare u përfshinë detyrimet e prodhuesve të statistikave zyrtare për zbatimin e parimeve të statistikave zyrtare sipas *acquis communautaire*. Instituti i Statistikës u quajt “Institut i Statistikave” dhe mori akronimin “INSTAT”. Me ndryshimet që pësoi ligji në vitet 2010-2013, u formalizua për herë të parë “Sistemi Kombëtar Statistikor” dhe INSTAT u ngarkua me detyrën e koordinatorit të këtij sistemi. INSTAT u pozicionua në varësi të Kryeministrit dhe punonjësit u bënë pjesë e shërbimit civil. Këshilli i Statistikave mori kompetenca vendimmarrëse, ku vlen të përmendet detyrimi për kryerjen e një procedure publike rekrutimi për titullarin e INSTAT-it dhe propozimin e kandidatëve Kryeministrit për emërim. Për herë të parë Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it emërohej për një kohë të caktuar prej 5 vjetëve, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.²

Sipas ligjit të vitit 2004, për herë të parë prodhuesit e statistikave u detyruan të operonin sipas një programi pesëvjeçar të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili përkon me periudhën 2007-2011.

Në vitin 2018, legjisllacioni për statistikat zyrtare u rishikua në tërësinë e tij me qëllim përafrimin e plotë me kërkesat e Rregullores (KE) 223/2009 “Për statistikat evropiane”. Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” përafroi jo vetëm standardet e kësaj rregullore, por edhe parimet e statistikave zyrtare të parashikuara në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Për të garantuar pavarësinë profesionale dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në statistika, INSTAT u krijua si institucion i pavarur i cili i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it u ngarkua të përfaqësonte Sistemin Kombëtar Statistikor, si dhe të nxirrte udhëzime e standarde për prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare, me qëllim që të sigurohej zbatimi i parimeve të statistikave zyrtare sipas neneve 4 dhe 5 të ligjit të lartpërmendur. Këshilli i Statistikave rimori kompetencën e një organi këshillues. Kuvendi i Shqipërisë emëron Drejtorin e Përgjithshëm në vijim të një procedure publike transparente përzgjedhje. Programi pesëvjeçar zbatohet sipas një Plani Vjetor i cili gjithashtu miratohet nga Kuvendi.

Sipas raporteve të tyre periodike të progresit, reforma legjisllative për prodhimin e statistikave zyrtare në vend është mirëpritur nga Eurostat dhe Komisioni Evropian.

Misioni, Vizioni, Vlerat

Misioni

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit.

Vizioni

¹Neni 7 i Ligjit nr.7687, datë 16.03.1993 “Për statistikën”

²Neni 9 i Ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar

INSTAT, si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare dhe koordinatori i sistemit kombëtar statistikor, synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

Vlerat

Profesionalizmi:

- Besueshmëria
- Objektiviteti
- Bashkëpunimi dhe Komunikimi
- Identifikimi me INSTAT
- Të qënurit i orientuar ndaj përdoruesve
- Të qënurit i orientuar ndaj cilësisë
- Orientimi ndaj zgjidhjeve
- Iniciativa
- Përgjegjshmëria

Integriteti:

- Respekti ndaj njëri tjetrit
- Dinjiteti
- Barazia
- Respektimi i mendimit ndryshe
- Mbështetja ndaj njëri tjetrit
- Shkëmbimi i njohurive

Motivimi:

- Përfshirja në procese
- Fleksibiliteti
- Dhënia e feedback
- Qëndrueshmëria

Objektivat e Zhvillimit të INSTAT-it

Strategjia e zhvillimit të INSTAT 2017-2030, është hartuar duke marrë në konsideratë objektivat strategjike kombëtarë dhe sektorialë zhvillimorë për periudhën afatmesme dhe afatgjatë, për të përmbushur kërkesat gjithnjë e në rritje të përdoruesve për statistika cilësore. Strategjia përmban 4 objektiva zhvillimorë:

1. Zhvillimi i cilësisë statistikore;
2. Përdorimi i burimeve të informacionit;
3. Përmirësimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve profesionale të SKS;
4. Zhvillimi i infrastrukturës së prodhimit statistikor.

INSTAT-i ka hartuar gjithashtu edhe një plan veprimi afatmesëm (2020-2023), i cili përmban një sërë nënobjektivash dhe aktiviteteve konkrete, përcakton përgjegjësitë e njësive strukturore të institucionit për

përmbushjen e tyre, si dhe indikatorët për matjen e performancës së këtyre aktiviteteve. Aktivitetet me frekuencë vjetore përfaqësohen në Planin Operacional të INSTAT-it.

Në vijim paraqitet informacioni mbi veprimtarinë e INSTAT-it, gjatë vitit 2021 dhe synimet për vitin 2022, në funksion të përmbushjes së 4 objektivave të lartpërmendur:

Objektivi 1: Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.

Ky objektivi ndikon drejtpërdrejt në plotësimin e pritshmërive të përdoruesve për statistika zyrtare për qëllime vendimmarrje, politikëbërje, kërkimore-shkencore apo orientuese, si dhe në besueshmërinë e publikut në cilësinë e statistikave të prodhuara.

Gjatë vitit 2021, INSTAT realizoi:

- 164 publikime statistikore nga të cilët 2 ishin publikime të reja;
- 2171 tregues statistikor sipas Planit vjetor të PSZ, nga të cilët 18 të rinj;
- 89 tregues statistikorë nga aktivitete që nuk ishin parashikuar në Planin Vjetor 2021.

INSTAT-i, gjatë këtij viti, ka shtuar prezencën në media lidhur me transmetimin e të dhënave të prodhuara dhe kuptueshmërinë e aktiviteteve statistikore. Për të qenë më afër përdoruesit, në kuadër të zbatimit të strategjisë së edukimit statistikor, seksioni "Statistika në Shkolla" është zgjeruar me 2 tema statistikore krahasuar me vitin e kaluar duke e cuar në 8 numrin e temave të publikuara. Niveli i kënaqësisë së përdoruesve gjatë vitit 2021 u vlerësua me 3,88 pikë nga 5 që është vlera maksimale, duke pësuar një rritje me 0.3 pikë përqindje, në krahasim me vitin e kaluar. Për lehtësimin e komunikimit dhe punës së agjencive statistikore në procesin e ndërtimit dhe monitorimit të PSZ, si dhe për modernizimin e këtyre proceseve, me mbështetjen e qeverisë suedeze, është punuar për ndërtimin e një sistemi IT.

Për vitin 2022, INSTAT-i do të fokusohet në përmbushjen e këtij objektivi nëpërmjet mbulimit më të mirë me informacion statistikor dhe në shtimin e numrit të treguesve në fusha të ndryshme statistikore si dhe në rritjen e përputhshmërisë së këtyre treguesve me BE, bazuar në monitorimin e Eurostat nëpërmjet platformës së vetvlerësimit (Smis+). Për rritjen e përdorimit dhe njohurisë mbi prodhimet statistikore, synohet të rritet numri i mikrodatave të anonimizuara për përdoruesit, si dhe ruajtja e komunikimit të vazhdueshëm me përdoruesit nëpërmjet zhvillimit të takimeve, konferencave të përbashkëta dhe zhvillimit të takimeve formale dhe informale me mediat. Po në këtë kuadër, do të vijojë puna për pasurimin e mëtejshëm me tema statistikore të seksionit "Statistika në Shkolla" në faqen zyrtare elektronike të INSTAT-it.

Objektivi 2: Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.

Rritja e burimeve të të dhënave administrative ndikon drejtpërdrejtë jo vetëm në koherencën dhe cilësinë e aktivitetit statistikor, por edhe në reduktimin e kostove për sigurimin e këtyre të dhënave. Agjencitë statistikore dhe institucionet e tjera publike, për ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e natyrës së punës që kanë, mbledhin të dhëna të cilat mund të përdoren edhe për qëllime statistikore zyrtare. Gjatë punës përgatitore të Programit të ri të Statistikave Zyrtare 2022-2026, INSTAT-i ka arritur të hartojë një listë të institucioneve që disponojnë të dhëna administrative, të dhëna të cilat i shërbejnë realizimit të aktiviteteve statistikore që INSTAT-i planifikon në Program apo Planin Vjetor.

Nga ana tjetër, INSTAT-i ka nënshkruar dhe 2 marrëveshje të reja mirëkuptimi me 2 institucione publike: Autoriteti për Mbikëqyrjen Financiare dhe Ministria e Drejtësisë. Lidhur me përdorimin e sistemeve dhe instrumentave të duhur IT për mbledhjen e të dhënave mund të themi që edhe gjatë vitit 2021, për shkak të vazhimit të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, sistemet dhe metodat IT janë përdorur gjerësisht në këto faza të prodhimit statistikor. Me anë të sistemit ISTI janë hedhur të dhënat për 21 aktivitete statistikore, ndërsa gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave është aplikuar metoda CAWI për 3 anketa statistikore dhe është përditësuar aplikacioni për 5 të tillë, ndërsa metoda CAPI është përdorur për 6 anketa statistikore, dhe përditësuar për 24 të tillë.

Për vitin 2022, INSTAT-i do të vazhdojë punën për implementimin e metodave moderne dhe instrumentave sa më eficientë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së treguesve të prodhuar.

Objektivi 3: Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.

Gjatë vitit 2021, INSTAT-i ka vijuar përpjekjet për ngritje kapacitetesh me anë të zhvillimit të trajnimeve dhe krijimit të një ambjenti motivues pune. Në trajnimet e parashikuara në planin vjetor janë trajnuar 59 punonjës, ndërsa nëpërmjet trajnimeve *ad-hoc* janë trajnuar 24 persona.

Forcimi i bashkëpunimit me institucionet furnizuese me të dhëna administrative është burimi kryesor i cili ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë statistikore dhe gamën e statistikave zyrtare. Në kuadër të fuqizimit të rolit të INSTAT-it në arenën ndërkombëtare, vlen të përmendet pjesëmarrja në 7 grupe ndërkombëtare pune, ku INSTAT kontribuon në fushën e statistikave dhe modernizimit të proceseve.

Gjatë vitit 2022 do të vijohet me zhvillimin e trajnimeve për ngritje kapacitetesh. Për forcimin e bashkëpunimit me ofruesit e të dhënave administrative INSTAT ka bërë kërkesë për nënshkrimin e 8 memorandumeve të reja, përkatësisht me institucionet si: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Autoritetet Portuale dhe Portet në Shqipëri. Në drejtim të ngritjes profesionale dhe përmirësimit të performancës së sistemit, gjatë vitit 2022 do të vijojë forcimi i bashkëpunimit me botën akademike, si faktor i rëndësishëm që ndihmon në përmirësimin e standardeve të prodhimit e përdorimit të statistikave zyrtare në fushën kërkimore-shkencore, në drejtim të përcaktimit të hapave konkret për arritjen e këtij qëllimi.

Objektivi 4: Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Në kuadër të automatizimit dhe standardizimit të proceseve të prodhimit statistikor dhe përpunimit të të dhënave, gjatë vitit 2021 janë ndërtuar 6 aplikacione CAPI dhe përditësuar 24 të tillë, si dhe janë ndërtuar 3 aplikacione CAWI dhe janë përditësuar 3 të tillë. Sa i përket përdorimit të sistemit SIMONA për aksesimin e të dhënave nga jashtë, gjatë vitit 2021 janë 9 projekte për të cilat kanë shprehur interes 14 përdorues. Duke qenë se ndikimi i situatës së krijuar nga Covid-19 ishte prezent dhe gjatë vitit 2021, INSTAT-i ka implementuar planet e vazhdimësisë së aktiviteteve statistikore në funksion të respektimit të kalendarit të publikimeve. Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi, INSTAT-i do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2022 angazhimin e tij në lidhje me modernizimin e mëtejshëm të mbledhjes së të dhënave dhe proceseve të tjera të prodhimit statistikor.

Sfidat për 2022

Për arritjen e objektivave strategjike dhe zbatimin me sukses të aktiviteteve statistikore në tërësi, sfidat kryesore për vitin 2022 parashikohet të jenë:

1. Sigurimi i Vazhdueshmërisë: Pandemia Covid-19 që shoqëroi dhe vitin 2021, ndonëse menjë shkallë më të ulët se në vitin 2020, ka impaktuar vazhdueshmërinë e punës gjatë fazave të prodhimit statistikor. Për këtë arsye, gjatë vitit 2022, INSTAT do të vijojë me zbatimin e planeve të vazhdimësisë për aktivitetet statistikore, nëse këto të fundit do të riskohen nga vazhdimësia e situatës pandemike. Për treguesit që tërheqin interes më të gjerë tek

përdoruesit, INSTAT planifikon veprimtari shtesë në mënyrë që të prodhohen statistika orientuese eksperimentale (edhe pse jozyrtare për shkak të metodologjive të ndryshme të aplikuara).

2. Kultura e ndryshimit dhe e zhvillimit: INSTAT do të përdorë instrumente komunikimi dhe motivimi tek punonjësit në mënyrë që të rritet ndërgjegjja për zhvillim dhe inovacion, e cila synon të arrihet nëpërmjet angazhimit të INSTAT me artikuj shkencorë cilësorë në revistën Shkencore Kërkimi, revistën informative si edhe rritjen e edukimit statistikor nëpërmjet zhvillimit të takimeve formale dhe informale me median, zhvillimit të takimeve shpjeguese e informuese me studentët si dhe pasurimit me tema statistikore të seksionit “Statistika në Shkolla”.

3. Politika dhe strategji efikase: INSTAT do të ndërtojë standarde duke aplikuar rregullore, udhëzime, manuale dhe stimuj të tjerë formalë që të drejtojnë institucionin drejt arritjes së objektivave strategjike, e cila synon të arrihet nëpërmjet zbatimit të rregulloreve, udhëzimeve dhe manualeve të BE-së.

4. Niveli organizativ e institucional: INSTAT do të punojë për ndërtimin e sistemeve menaxheriale adekuata, ndërveprimin vertikal dhe horizontal ndërmjet sektorëve për arritjen e qëllimeve afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata duke përdorur në mënyrën më të mundshme burimet që disponon institucioni, nëpërmjet prodhimit dhe monitorimit të indikatorëve që shërbejnë për matjen e Performancës.

5. Komunikimi me përdoruesit: Përdoruesit e statistikave zyrtare janë klientela e produkteve të siguruara nga INSTAT. Institucioni do të punojë për t’iu përafuar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare, e cila synon të arrihet nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor dhe organizimit të takimeve formale e informale me përfaqësuesit e medias.

V. Cilësia e të dhënave të prodhuara nga INSTAT-i

INSTAT-i synon të ofrojë produkte dhe shërbime statistikore në përputhje me nevojat statistikore të informacionit të grupeve të ndryshme të përdoruesve. Përmirësimi i cilësisë së informacionit statistikor kryhet vazhdimisht duke kërkuar kostot më të ulëta të mundshme dhe duke zvogëluar barrën e përgjigjes. Në përputhje me ligjin për statistikën zyrtare, INSTAT-i përdor metoda dhe procese statistikore në linjë me parimet dhe standardet shkencore të njohura ndërkombëtarisht, kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe siguron që statistikën të jenë sa më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT-i ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane (*European Statistics Code of Practice*).

Gjatë vitit 2021, në kuadër të sigurimit të cilësisë statistikore, puna është fokusuar në hartimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Statistikor Evropian. Në përputhje me nenin 5 të ligjit për statistikën zyrtare, INSTAT-i ka ndërmarrë disa iniciativa, si: dokumentimi i proceseve statistikore sipas GSBPM, matja e kostos së aktiviteteve statistikore, si edhe kryerja e Auditit Statistikor. Në përputhje me parimin 9 “Ngarkesa ndaj të intervistuarve”, të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, INSTAT monitoron përmes dy treguesve bazë: numri i pyetësorëve që ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen, si dhe kohëzgjatja e intervistës. Në përputhje me parimin nr. 10 “Kosto dhe Efektiviteti”, të Kodit të Praktikave Evropiane, si dhe në përmbushje të rekomandimit nr. 19 të Peer Review 2018, për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës që mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore për qëllime menaxhimi duke përfshirë edhe krahasimin e efikasitetit dhe kosto-efektivitetit, INSTAT ka punuar për të ndërtuar një sistem i cili mundëson vlerësimin e kostove të proceseve dhe aktiviteteve statistikore.

INSTAT-i, gjatë vitit 2022, do të punojë për hartimin/përditësimin dhe publikimin e raporteve të cilësisë për përdoruesit, mbështetur në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. Për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara, do të trajnohet stafi i INSTAT-it dhe i agjencive statistikore, në lidhje me adaptimin e GSBPM, sistem i cili aplikohet në shumë shtete të Evropës dhe më tej.

Me qëllim rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikën zyrtare, për vitin 2022, parashikohet të publikohen 50 raporte të cilësisë, të kryhen 2 vetëvlerësime dhe 1 audit statistikor. Në fund të procesit të auditimit statistikor do të vlerësohen situatat problematike dhe do të sugjerohet gjetja e rrugëve për përmirësimin e tyre.

Sfidë për vitin 2022 do të jetë dhe publikimi i raporteve të cilësisë për aktivitetet që kryhen nga agjencitë statistikore, si dhe zbatimi i pyetësorëve të vetvlerësimit dhe auditit statistikor.

Dokumentimi i proceseve statistikore

Për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet statistikore të planifikuara për tu kryer gjatë vitit 2021, INSTAT-i zbatoi sistemin GSBPM. Në vetvete, ky model përshkruan dhe përcakton të gjithë bashkësinë e proceseve të nevojshme për t’u ndjekur për prodhimin e statistikave zyrtare, duke siguruar një kornizë standarde dhe terminologji të harmonizuar.

Në vitin 2021, INSTAT-i ka përditësuar versionin më të ri të modelit GSBPM (Versioni 5.1). Ky version thekson më shumë rëndësinë e procesit të integritetit të të dhënave statistikore në të gjitha të dhënat në dispozicion. Gjatë këtij viti, janë dokumentuar për herë të parë ose përditësuar 27 aktivitete statistikore të cilat ndjekin këtë model. Për SKS u organizua një ëorkshop me temën “Cilësia, Raportet e Cilësisë/Metadatat dhe përdorimi i GSBPM” ku theks i veçantë iu kushtua parimevetë përgjithshme të menaxhimit të cilësisë të parashikuara në nenet 4 dhe 5 të ligjit për statistikën zyrtare dhe nga Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane.

Auditi Statistikor

Mbështetur në pikën 3 të nenit 17 të ligjit për Statistikat Zyrtare, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT mund të kryejë auditime statistikore tek prodhuesit e statistikave zyrtare, kur e gjykon të arsyeshme. Auditimi statistikor është rruga konkrete për përmirësimin e cilësisë së një procesi apo aktiviteti statistikor, nëpërmjet të cilit identifikohen pikat e forta dhe përmirësohen pikat e dobëta të komponentëve të tij. Auditimi kryhet nëpërmjet një procesi sistematik, të programuar, të pavarur dhe të dokumentuar, ku bëhet një vlerësim objektiv i hapave të ndjekur gjatë një procesi statistikor. Me synimin kryesor rritjen dhe përmirësimin e cilësisë së proceseve statistikore, për vitin 2021, është ndjekur plotësimi i pyetësorëve të vetëvlerësimit për 2 aktivite statistikore: “Përdorimi i TIK në familje” dhe “Statistikat administrative të Blegtorisë”, si edhe është hartuar raporti i auditit statistikor për Anketën e Buxhetit të Familjeve.

Raportet e Cilësisë

INSTAT ka publikuar për përdoruesit Raportet e Cilësisë në nivelin e aktiviteteve statistikore. Në vitin 2021 janë publikuar 48 raporte në faqen elektronike të INSTAT-it, me një rritje prej rreth 29,7% krahasuar me vitin 2020. Raportet e cilësisë përshkruajnë konceptet dhe metodologjitë statistikore të përdorura për mbledhjen dhe gjenerimin e statistikave zyrtare. Nëpërmjet tyre, përdoruesve u sigurohet informacion mbi format dhe standardet që INSTAT përdor në metodat dhe përkufizimet e aplikuara si dhe në cilësinë e rezultateve statistikore. Struktura e Raporteve të Cilësisë bazohet në konceptin e cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave (ESS) dhe në parimet lidhur me cilësinë e aktiviteteve statistikore sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

Ngarkesa e të Intervistuarve

Ngarkesa e të intervistuarve është koha dhe përpjekjet e të anketuarve për t’ju përgjigjur pyetësorëve të INSTAT-it në mënyrë të kënaqshme për një aktivitet statistikor. Në vitin 2021, në 15 vrojtimitet e kryera pranë ndërmarrjeve janë anketuar rreth 23,009 ndërmarrje. Në 9 vrojtimitet të kryera pranë familjeve janë anketuar rreth 54,489 Njësi Ekonomike Familjare.

Anketat pranë ndërmarrjeve

Statistikat pranë ndërmarrjeve dhe familjeve përdorin dy tregues për të vlerësuar ngarkesën e të intervistuarve (*Response burden*): numrin e pyetësorëve për të cilët ndërmarrjet/familjet duhet të përgjigjen, si dhe kohëzgjatjen e intervistës.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes për vitin 2021, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimitet pranë ndërmarrjeve ekonomike që INSTAT-i realizon, jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1_9 të punësuar	141930	14168	273	984
10_19 të punësuar	459	2865	607	374
20_49 të punësuar	486	1169	747	345
50+ të punësuar	502	291	357	829

Në vitin 2021, janë anketuar rreth 13.8 %(23,009 ndërmarrje) e ndërmarrjeve të regjistruara në vitin 2021 (166,386 ndërmarrje), nga të cilat 97.3 % e tyre kanë marrë pjesë vetëm në pesë ose më pak vrojttime, ndërsa 2.7 % e tyre kanë marrë pjesë në më shumë se 5 vrojttime pranë ndërmarrjeve të realizuar nga INSTAT-i gjatë vitit 2021.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2019-2021, duke marrë në konsideratë gjithë vërtetimet pranë ndërmarrjeve ekonomike që realizon INSTAT-i.

Tabela nr. 3: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve

Numri i ndërmarrjeve	2021	2020	2019	2018	2017
Intervistuar të paktën një herë	23,009	23,053	20,370	21,752	24,025
0 pyetësorë	142,257	139,289	142,257	140,700	136,748
Gjithsej	166,386	162,342	162,627	162,452	160,773


Në lidhje me “Ngarkesën e të intervistuarve”, për indikatorin “Numri i pyetësorëve që INSTAT-i i dërgon ndërmarrjeve për tu përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme, pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Megjithatë, mund të përmendim se gjatë vitit 2021, INSTAT-i ka realizuar 15 vërtetimet pranë ndërmarrjeve, njësoj sa vitin e kaluar dhe treguesi i përqindjes së numrit të ndërmarrjeve që kanë marrë të paktën një anketë rezulton me ulje të lehtë.

Në grupin e ndërmarrjeve të vogla (1-9 të punësuar), ku është përqendruar dhe numri më i madh i ndërmarrjeve të vendit, pjesa më e madhe e tyre (rreth 90.2%) nuk kanë për të plotësuar asnjë pyetësor, 9 % kanë për të plotësuar nga 1 deri në 5 pyetësorë dhe 0.2% e tyre ngarkohen me mbi 5 pyetësorë. Siç shikohet nga Figura nr. 6, në grupin e ndërmarrjeve me 20 deri 49 të punësuar, 87.4 % e tyre ngarkohen deri në maksimumi 10 pyetësorë për t’u përgjigjur dhe vetëm 12.6% e tyre ngarkohen me mbi 10 pyetësorë. Ngarkesa e përgjigjes është relativisht e lartë në grupin e ndërmarrjeve me 50 të punësuar e lart ku rreth 74,6% e tyre duhet t’i përgjigjen të paktën 1 pyetësori.

Tabela nr. 4: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes

Madhësia e ndërmarrjes	0 pyetësorë	1_5 pyetësorë	6_10 pyetësorë	11+ pyetësorë
1_9 të punësuar	90.2%	9.0%	0.2%	0.6%
10_19 të punësuar	10.7%	66.6%	14.1%	8.7%
20_49 të punësuar	17.7%	42.6%	27.2%	12.6%
50+ të punësuar	25.4%	14.7%	18.0%	41.9%

Figura nr. 6: Përqindja e shpërndarjes së pyetësorëve sipas madhësisë së ndërmarrjes



Anketat pranë familjeve

Të gjitha anketat pranë familjeve, të realizuara nga INSTAT-i gjatë vitit 2021, kanë si bazën e tyre të zgjedhjes rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011. Në vitin 2021 janë anketuar rreth 7.54 % Njësi Ekonomike Familjare (NjEF) nga 722.262 të regjistruara në Cens. Janë intervistuar gjithsej 54,489 NjEF, nga të cilat 78.44 % (42,739) e tyre kanë marrë pjesë vetëm në një vrojtim, ndërsa 21.56 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtime pranë familjeve. Në tabelën nr. 5 paraqitet shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve për vitin 2021, duke marrë në konsideratë të gjitha vrojtimit pranë familjeve që realizon INSTAT-i.

Gjatë vitit 2021, në qarkun e Tiranës janë intervistuar gjithsej 12850 NjEF ose 6.55 % e tyre. Rreth 93.45 % e familjeve të qarkut Tiranë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë vrojtim, 5.32 % e tyre kanë marrë pjesë në 1 vrojtim dhe vetëm 1.23 % e tyre kanë marrë pjesë në 2 ose më shumë vrojtime të realizuara nga INSTAT-i.

Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve nga 2021-2015, duke marrë në konsideratë gjithë vrojtimit pranë njësisive ekonomike familjare, të realizuara nga INSTAT-i, jepet në tabelën nr. 6.

Tabela nr. 5: Shpërndarja e numrit të vrojtimeve sipas qarqeve

Qarku	Asnjë vrojtim	Një vrojtim	Dy e më shumë vrojtime	Numri i NjEF për Qark
Berat	35597	2259	637	38493
Dibër	27225	1814	534	29573
Durrës	61434	4056	1160	66650
Elbasan	67438	4391	1215	73044
Fier	75581	5168	1325	82074
Gjirokastrë	19383	1440	464	21287
Korçë	55426	3730	1015	60171
Kukës	15506	1245	375	17126
Lezhë	29630	1927	679	32236
Shkodër	50042	3345	1042	54429
Tiranë	183368	10434	2416	196218
Vlorë	47143	2930	888	50961

Gjithsej	667773	42739	11750	722262
-----------------	---------------	--------------	--------------	---------------


Tabela nr. 6: Shpërndarja e numrit të pyetësorëve sipas viteve

Numri i NjEF	2021	2020	2019	2018	2017
Intervistuar të paktën një herë	54489	51302	81,870	59,702	46,940
0 pyetësorë	667773	670 960	640,392	662,560	675,322
Gjithsej	722 262	722262	722,262	722,262	722,262

Indikatori “Numri i pyetësorëve që INSTAT-i i dërgon familjeve për tu përgjigjur” nuk mund të krahasohet me vitet e mëparshme pasi ndryshon numri i aktiviteteve dhe frekuenca e tyre. Megjithatë, mund të përmendet se gjatë vitit 2021, INSTAT-i ka realizuar 9 vrojtme pranë familjeve, ndër të cilat 2 ishin vrojtme të reja me frekuencë vjetore. Figura nr. 7 paraqet ngarkesën e përgjigjes për NjEF që janë përzgjedhur për tu intervistuar gjatë vitit.

Anketat e kryera pranë familjeve në Shqipëri kanë si karakteristikë faktin që mbledhin informacion mbi karakteristika të familjeve dhe individëve, që nuk gjenden në regjistra apo rekorde administrativë. Si rrjedhim, përpjekjet për të ulur shkallën e ngarkesës janë fokusuar në lehtësitë që mund t’i krijohen familjeve, përsa i përket kuptueshmërisë dhe rëndësisë së informacionit, aplikimit të formave elektronike që shkurtojnë kohën dhe automatizojnë administrimin e intervistimit si dhe përpjekjeve për të regjistruar dhe para-printuar atë pjesë të informacionit, që mund të jetë i disponueshëm.


Figura nr. 7: Ngarkesa e përgjigjes për NjEF që janë përzgjedhur për t’u intervistuar gjatë vitit 2020



Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta

Në lidhje me indikatorin e dytë kohëzgjatjen mesatare të intervistës për anketat pranë familjeve dhe ndërmarrjeve për vitin 2021, të dhënat jepen në figurën e mëposhtme.

Figura nr. 8: Kohëzgjatja e intervistës mesatare në minuta / Pyetësorë



Kohëzgjatja e intervistës gjatë vitit 2021 për anketat pranë familjeve është mesatarisht rreth 33.7 minuta krahasuar me 33.9 minuta në vitin 2020. Ndërsa për ato pranë ndërmarrjeve është 32.1 minuta krahasuar me 38.5 minuta në vitin 2020.

INSTAT për të reduktuar ngarkesën e të intervistuarve punon vazhdimisht për të përmirësuar cilësinë e pyetësorëve, programeve të mbledhjes së të dhënave, manualeve dhe trajnimin e anketueseve.

Planet e vazhdimësisë së Aktiviteteve Statistikore

Situata e krijuar nga pandemia Covid-19 gjatë viteve 2020-2021 pati një ndikim të rëndësishëm si aspektet e jetës ashtu edhe në mbarëvajtjen e punës në institucion. Në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia, INSTAT-i u përqendrua maksimalisht për të siguruar vazhdimësinë dhe cilësinë e produkteve statistikore.

Në vitin 2020, në kuadër të menaxhimit të veprimtarisë me risqet e shtuara nga pandemia, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së prodhimit statistikor, INSTAT-i punoi në lidhje me përcaktimin e formatit. Bazuar në formatin e aprovuar u përgatitën 72 Plane të Vazhdimësisë së Aktiviteteve Statistikore. Ndërsa gjatë vitit 2021, u punua për standardizimin e informacionit të plotësuar.

Sistemi online - SIMONA

INSTAT gjatë vitit 2020 ka zhvilluar një sistem të veçantë, i quajtur "Simona" i cili është vënë në dispozicion kërkuesve shkencorë për të aksesuar informacionin statistikor në distancë, por edhe për t'iu përgjigjur të interesuarve sa më shpejt dhe në formën e duhur. Ky sistem mundëson aksesin e të dhënave mikro në interes të proceseve kërkimore-shkencore nga të gjithë përdoruesit brenda dhe jashtë vendit si edhe të stafit të INSTAT.

Nëpërmjet sistemit SIMONA gjatë vitit 2021 kanë patur akses 9 projekte dhe 14 përdorues, ndërsa gjatë vitit 2020 kanë patur akses 4 projekte dhe 5 përdorues.


Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të Statistikave

Anketa mbi Kënaqësinë e Përdoruesve të Statistikave që prodhon INSTAT-i është një mjet i rëndësishëm për të identifikuar nevojat e përdoruesve dhe adresuar reagimet e tyre, aty ku është e mundur, në procesin e planifikimit të statistikave zyrtare. Anketa është realizuar mbi të dhënat e përdoruesve që kanë kërkuar statistika pranë INSTAT duke u kombinuar edhe me pyetësonin online. Kampioni përbëhej nga përdoruesit që kanë kërkuar të dhëna statistikore në periudhën nga fillimi i vitit 2009 deri në muajt e parë të vitit 2021. Pyetësoni u dërgua me e-mail tek 2,800 përdorues. Linqet për plotësimin e pyetësonit u vendosën në faqen zyrtare të INSTAT si dhe në faqen zyrtare të Facebook, kështu që çdo përdorues i interesuar të mund të merrte pjesë në këtë anketë.

Në Tetor të vitit 2021, INSTAT-i zhvilloi raundin e pestë të Anketës së Kënaqësisë së Përdoruesve. Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë në vitin 2021 arriti vlerën 3.88 nga 5 pikë të plota, duke shënuar një rritje me 0,3 përqind krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2021, ka pësuar gjithashtu rritje kënaqësia me faqen elektronike të INSTAT-it me 0,02 përqind dhe indikatorin e besimit se INSTAT-i ka të dhëna të besueshme ka pësuar një rritje me 0,96 përqind.

Dy nga pesë dimensionet (Kënaqësia me punonjësit, Kënaqësia me të dhënat, Kënaqësia me faqen e internetit, Kënaqësia me cilësinë e të dhënave dhe shërbimet dhe Besimi INSTAT ka të dhëna të besueshme) kanë shënuar rritje krahasuar me një vit më parë, Besimi - INSTAT ka të dhëna të besueshme, i cili ka pësuar një rritje me 0.96 % dhe Kënaqësia me cilësinë e të dhënave dhe shërbimet është vlerësuar me një rritje prej 0.21%. Grafiku i mëposhtëm përshkruan krahasimin e nivelit të kënaqësisë së përdoruesve përgjatë viteve 2017-2021.

Figura nr. 9: Niveli i përgjithshëm i kënaqësisë së përdoruesve sipas viteve 2017-2021




Komunikimi dhe Publikimet

Duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në rëndësinë e statistikave zyrtare, INSTAT-i ka ndërtuar një strategji të veçantë drejtuar të gjithë grupeve të përdoruesve. Gjatë vitit 2021, është publikuar numri i 5-të i revistës shkencore "Kërkimi" dhe numri i 2-të i revistës informative "Infostat".

Viti 2021 shënoi një rritje të vizibilitetit të INSTAT në publik. Më poshtë paraqiten disa tregues të rritjes së vizibilitetit të INSTAT gjatë vitit 2021:

- **Publikimet:** Gjatë vitit 2021, numri i publikimeve të INSTAT shkoi në 164, nga 162 që ishte në vitin 2020.
- **Kërkesat e përdoruesve:** Sa i takon kërkesave të përdoruesve, duke iu referuar databazës së kërkesave të përdoruesve, e cila është krijuar për herë të parë në vitin 2009, numri i kërkesave të përdoruesve për të dhëna statistikore ka ardhur në zbritje. Në vitin 2021, numri i kërkesave të përdoruesve është 829, prej të cilave 12 kanë qenë kërkesa për mikrodata. Kjo vlerë është ulur me 32 kërkesa, krahasuar me vitin 2020, ku numri i kërkesave ishte 861.
- **Edukimi statistikor:** Projekti “Statistika në shkolla” është krijuar për t’i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve si dhe atyre që kanë interes për statistikat, për të qenë në gjendje të kuptojnë më mirë statistikat dhe disa nga konceptet themelore të tyre. Gjatë vitit 2021 janë përditësuar të gjitha temat e publikuara në seksionin e Edukimit Statistikor me të dhënat e reja të publikuara nga INSTAT.
- **Rrjeti social facebook:** Gjatë vitit 2021, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 6.239 nga 5.899 në 2020.
- **Vizibiliteti në media:** Në këtë vit INSTAT ka publikuar 1 reagim në Seksionin e Reagimeve në faqen zyrtare INSTAT, ku disa të dhëna në databazën statistikore ishin keqinterpretuar.
- **Statistikat e ëëbsite:** Për vitin 2021 faqja ëëb e INSTAT ka arritur 4,362,864 page views³, me një rritje prej 1,076,888 ose 32,77 %, krahasuar me vitin 2020 ku kjo vlerë ka qenë 3.285.976.

Figura nr.10: Gjatë vitit 2021, janë publikuar 164 publikime



Librat



- Vjetari Statistikor Rajonal, 2021
- Tregtia e Jashtme e Mallrave dhe Ndërmarrjet, 2021
- Burra dhe Gra në Shqipëri, 2021
- Tregu i Punës, 2020
- Regjistri i Ndërmarrjeve, 2020
- Ndërmarrjet e Huaja dhe të Përbashkëta, 2018-2020
- Turizmi në Shifra, 2020
- Shqipëria në Shifra, 2020

³Pageviews – Shikimi i faqeve është numri i përgjithshëm i faqeve të shikuara, këtu numërohen gjithashtu shikime

- Diaspora e Shqipërisë në Shifra, 2020
- Sustainable Development Goals – SDG
- Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri
- Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adolehentëve dhe të Rinjve në Shqipëri, 2016-2019

	<p>Vjetari Statistikor Rajonal</p> <p>Treguesit rajonale ofrojnë krahasime të treguesve statistikorë më të rëndësishëm të vendit në nivel rajoni/qarku/bashkie. Zakonisht rajonet janë të krahasueshme ndërmjet tyre nga pikëpamja statistikore, por në realitet është vështirë të krahasohet një rajon i vogël me një rajon të madh për nga popullsia. Vjetari Statistikor Rajonal synon të sigurojë një perceptim më të gjerë të statistikave që janë grumbulluar në nivel qarku nga subjektet nëpërmjet vrojtimeve statistikore apo burimeve administrative. Nëpërmjet këtij botimi, jepet informacion i vlefshëm statistikor, i cili shërben për krahasimin e treguesve ekonomikë, socialë, mjedisorë, etj, ndërmjet rajoneve</p>
	<p>Regjistri i ndërmarrjeve</p> <p>Statistikat e Regjistrit të Ndërmarrjeve janë pjesë esenciale e infrastrukturës statistikore të një vendi për prodhimin e statistikave ekonomike zyrtare. Gjatë viteve të fundit, kërkesa në rritje për statistika më të mira dhe më të hollësishme ekonomike ka vënë në qendër të vëmendjes Regjistrin e Ndërmarrjeve duke theksuar rolin e tij si shtylla kryesore në prodhimin e statistikave ekonomike.</p>
	<p>Shqipëria në Shifra</p> <p>Shqipëria në Shifra paraqet në mënyre sintetike të dhëna statistikore për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Shqipërisë. Botimi përmban 37 kapituj: Demografia, Statistika Juridike, Statistika te Shëndetësisë, Statistika të Kushteve Sociale, Arsimimi, Kultura, Papunësia, Punësimi, Çmimet, Tregtia e Jashtme, Transporti, Turizmi, Llogaritë Kombëtare, Regjistri i Ndërmarrjeve, Inovacioni etj.</p>


	<p>Burrat dhe Gratë në Shqipëri</p> <p>Kapitujt e përfshirë në këtë botim, pasqyrojnë fusha të ndryshme të të dhënave me bazë gjinore, të cilat janë përpunuar dhe vendosur në kontekst nga stafi i INSTAT duke i bërë ato më të lehta dhe të kuptueshme për publikun e gjerë. Statistikat dhe treguesit e prezantuar në këtë publikim do t'i shërbejnë politikëbërësve, botës akademike, shoqërisë civile dhe përdoruesve të ndryshëm për të analizuar në një kontekst të gjerë zhvillimet gjinore në Shqipëri.</p>
	<p>Tregtia e Jashtme e mallrave dhe ndërmarrjet Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave realitetin ekonomik në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencorë dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar falë bashkëpunimit dhe të dhënave administrative të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.</p>
	<p>Tregu i Punës</p> <p>Botimi mbi Tregun e Punës është një burim i rëndësishëm informacioni mbi situatën dhe tendencat e tregjeve kombëtare të punës. Ai ndihmon për të monitoruar politikat dhe strategjitë kryesore për punësimin dhe pagat, sipas gjinisë dhe strukturës gjinore dhe moshore, shkallës arsimore, aktivitetit ekonomik dhe profesioneve. Botimi i dedikuar “Tregu i punës” përmban një analizë të zgjeruar të publikimeve periodike tremujore, bazuar në burime administrative dhe Anketën e Forcave të Punës.</p>
	<p>Ndërmarrjet e Huaja Në Shqipëri</p> <p>Publikimi “Ndërmarrjet e huaja në Shqipëri”, përfshin të dhëna për vitet referencë 2018-2020. Botimi përbëhet nga katër kapituj. Kapitulli i parë jep informacion mbi numrin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta që operojnë në Shqipëri, të ndara sipas llojit të pronësisë, vendit të investitorit, aktivitetit kryesor ekonomik dhe madhësisë së ndërmarrjes. Kapitulli i dytë shpreh ndikimin e ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta në treguesit e punësimit, shitjet neto dhe investimeve.</p>

	<p>Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri</p> <p>Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin, kryen për herë të parë Anketën e Migracionit në familjet shqiptare për periudhën 2011-2019. Anketa e Migracionit në Familje do të kontribuojë për të mbledhur të dhëna të besueshme lidhur me përcaktuesit dhe ndikimet e migracionit në Shqipëri, si dhe do të ndihmojë INSTAT-in të zhvillojë njohuri mbi zgjerimin e gamës së indikatorëve që matin këtë fenomen.</p>
	<p>Treguesit e Mirëqenies së Fëmijëve, Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri</p> <p>Ky botim rikthen në vëmendje statistikave zyrtare me në fokus fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë në Shqipëri. 'Menyja' e treguesve të botuar është e zgjeruar dhe përfshin 104 të fillë, duke siguruar një panoramë të larmishme nga fusha të ndryshme të të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve. Treguesit janë përpunuar bazuar tek të dhënat e mbledhura përmes anketave të ndërmarra nga INSTAT-i, si edhe nga sistemet e menaxhimit të informacionit të institucioneve shtetërore (të dhënat administrative).</p>

Kërkesat e përdoruesve


INSTAT regjistron çdo kërkesë të përdoruesve për informacion statistikor në Databazën e përdoruesve dhe nëpërmjet saj INSTAT përcakton dhe njihet më mirë me kërkesat dhe nevojat që kanë përdoruesit për statistika. Nëse i referohemi historikut të kësaj databaze, nga krijimi në vitin 2009, mund të themi që kërkesat e përdoruesve kanë pësuar një rritje të ndjeshme, ku në vitin 2021 numri i kërkesave të përdoruesve është 829 kërkesa, nga 776 që ishin në vitin 2017.

Figura nr. 11: Numri i kërkesave të përdoruesve 2017 – 2021



Duke e thelluar analizën e statistikave të plotësimit të kërkesave të përdoruesve, vërehet që numri i kërkesave të përdoruesve, në vitin 2021 është ulur me 3,7% duke arritur shifrën 829 kërkesa, nga 861 kërkesa që ishin në vitin 2020. Nëse do të bënim specifikimin e mëtejshëm të këtyre kërkesave mund të themi që numrin më të madh të tyre e zënë kërkesat e statistikave të çmimeve me 44,8%, pasuar nga statistikat sociale për popullsinë me 14,8%, si dhe statistikat e turizmit me 8%, etj.

Figura nr. 12: Klasifikimi i numrit të kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore



Numrin më të madh të kërkesave të plotësuar në vitin 2021 e zënë statistikat e çmimeve me 371 kërkesa, pasuar nga statistikat sociale për popullsinë me 123 kërkesa, si dhe statistikat e turizmit, transportit dhe aksidenteve me 66 kërkesa, etj. Një pasqyrë më e hollësishme paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.7: Numri i kërkesave të përdoruesve sipas fushave specifike statistikore

Lënda e Kërkesës	Numri i kërkesave 2020	Numri i kërkesave 2021	Ndryshimi në përqindje 2020 - 2021	Përqindja ndaj totalit 2021
Çmimet	309	371	20,1	44,8
Bujqësia dhe Blegtoaria	23	46	100	5,5
Tregtia e jashtme	59	40	-32,2	4,8
ASN	23	9	-60,8	1,1
Ndërmarrjet	38	6	-84,2	0,7
Llogaritë kombëtare	46	16	-65,2	1,9
Popullsia/lindjet-vdekjet/martësat/divorçet/emigracioni	90	123	36,6	14,8
Ndërtimi	3	3	0	0,4
Shkaqet e vdekjeve /shëndetësia	47	17	-63,8	2,0

Punësimi/papunësia/pagat	57	59	3,5	7,1
Turizmi/transporti/aksidentet	43	66	53,5	8,0
Konsumi i familjeve /niveli i jetesës / shpenzimet e familjes	76	39	-48,7	4,7
Të tjera/të ndryshme/Të dhëna të 2 ose më shumë fushave statistikore/Pyetësorë të ndryshëm	47	22	-53,2	2,7
Mikrodata		12	-	-
Totali	861	829	Rënie me 32 kërkesa	100

Edukimi statistikor

Projekti “Statistika në shkolla” është krijuar për t’i ardhur në ndihmë të gjithë nxënësve, studentëve, si dhe atyre që kanë interes për statistikat, për të rritur kuptueshmërinë e statistikës dhe të disakoncepteve themelore të saj. Gjatë vitit 2021 janë përditësuar të gjitha temat e publikuara në seksionin e Edukimit Statistikor me të dhënat e reja të publikuara nga INSTAT.

Edukimi statistikor është njohja e publikut të gjerë me informacione dhe njohuri statistikore, të cilat nevojiten për të kuptuar apo për të qenë në gjendje të gjykojmë nëse një njoftim, një shifër, një çmim apo një reklamë është e arsyeshme apo jo.

Qëllimi i edukimit statistikor është forcimi i sistemit statistikor dhe statistikave zyrtare përmes literaturës statistikore për përdoruesit e rinj dhe jo-ekspertë të statistikave. Nëpërmjet këtij aksioni synohet ndërgjegjësimi i të rinjve për rëndësinë e statistikave zyrtare dhe përdorimin e tyre. Në kuadër të këtij projekti INSTAT ka përgatitur dhe publikuar disa artikuj statistikorë të trajtuar në mënyrë të tillë që të nxisin interes për të rinjtë dhe personat e interesuar që të mësojnë rreth statistikave.

Temat janë:

- Popullsia e Shqipërisë
- Shpenzimet e konsumit në Shqipëri
- Piramida e popullsisë
- Çmimet e konsumit në Shqipëri
- Arsimi në Shqipëri
- Dhuna nga grave dhe vajzave në Shqipëri
- Produkti i Brendshëm Bruto
- Regjistri i ndërmarrjeve në Shqipëri

Është planifikuar që në vitin 2022 të shtohen edhe tre tema të reja si Punësimi, Papunësia dhe Migracioni për ta zgjeruar dhe bërë më të plotë këtë seksion.

Rrjeti Social Facebook dhe INSTAGRAM

Gjatë vitit 2021, pëlqimet në faqen e Institutit të Statistikave arritën në 6.239 nga 5.899 në 2020.


Figura nr.13: Numri total i pëlqimeve sipas gjinisë dhe grup-moshave, 2021

Audience

6,239 Facebook followers

Age and gender

Men 43.20%
Women 56.80%



Postimet në facebook

1-GËZUAR 8 MARSIN 🇸🇰 #8march #ëomenday #instat #statistika #shqiperi #8mars- 2,890 postime

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=3662136500536402&id=590804097669673

2-Vizitë studimore e delegacionit të Autoritetit Grek të Statistikave (ELSTAT)- 3,850 postime

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=4026993310717384&id=590804097669673

3- Censi i rradhës pritet të kryhet në Tetor 2022 - 3,246 postime

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=4184674434949270&id=590804097669673

4-A e dini se ? (VIDEO PILOT CENS) - 3,000 postime

<https://www.facebook.com/institutistatistikave/videos/4507185319304218>

5-Instituti i Statistikave ka nisur, më 30 Shtator 2021 - 4,267

<https://www.facebook.com/institutistatistikave/posts/225924389566645>

Në rrjetin social Instagram gjatë vitit 2021 janë bërë 55 postime nga të cilat 11 janë video informuese.

Mbulimi mediatik

Nga monitorimi i shtypit dhe medias online gjatë muajve Janar-Dhjetor 2021, INSTAT ka publikuar 1 reagim në Seksionin e Reagimeve në faqen zyrtare INSTAT, ku disa të dhëna në databazën statistikore ishin keqinterpretuar.

Statistikat e website të INSTAT

Me përjashtim të temave “Statistikat e Përgjithshme dhe Rajonale”, “Ekonomi dhe Financë” dhe “Treguesit Demografikë dhe Socialë”, temat kryesore të faqes së INSTAT paraqiten me rritje. Në tabelën më poshtë janë të renditura për nga numri i shikimeve dhe ndryshimi në përqindje nga 2017 në 2021.

Tabela nr. 8: Page views sipas temave kryesore 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021

Tema	Total 2017	Total 2018	Total 2019	Total 2020	Total 2021
Shkencë, Teknologji dhe Shoqëria Dixhitale	972	5.189	7.548	8.166	12.054
Çmimet	6.202	41.263	31.879	91.016	139.969
Bujqësia dhe Peshkimi	3.418	18.800	26.622	25.849	26.342
Statistikat e Përgjithshme dhe Rajonale	2.612	13.961	16.399	16.907	14.539
Tregtia e Jashtme	3.357	17.891	22.508	46.558	59.687
Kushtet Sociale	5.105	25.463	42.049	48.659	58.986
Tregu i Punës dhe Arsimi	14.266	61.446	114.113	130.851	221.354
Censet	3.697	14.936	19.050	18.390	28.872
Mjedisi dhe Energjia	5.053	11.921	14.725	15.138	16.293
Industria, Tregtia dhe Shërbimet	29.469	68.291	74.284	91.851	123.454
Ekonomi dhe Financë	73.165	79.014	83.394	72.279	72.151
Treguesit Demografikë dhe Socialë	64.233	100.697	133.713	195.443	179.592
Gjithsej	211,549	458,872	586,284	761,107	953,293

Tabela 9: Klikime sipas temave kryesore 2020 dhe 2021

Tema	Total 2020	Total 2021
Shkencë, Teknologji dhe Shoqëria Dixhitale	8.166	12.054
Çmimet	91.016	139.969
Bujqësia dhe Peshkimi	25.849	26.342
Statistikat e Përgjithshme dhe Rajonale	16.907	14.539
Tregtia e Jashtme	46.558	59.687
Kushtet Sociale	48.659	58.986
Tregu i Punës dhe Arsimi	130.851	221.354

Censet	18.390	28.872
Mjedisi dhe Energjia	15.138	16.293
Industria, Tregtia dhe Shërbimet	91.851	123.454
Ekonomi dhe Financë	72.279	72.151
Treguesit Demografikë dhe Socialë	195.443	179.592
Gjithsej	761.107	953.293

Programi i transparencës

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Institutin e Statistikave, INSTAT. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit. Programi vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës INSTAT-i ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale.

INSTAT-i përditëson herë pas here Programin e Transparencës. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparente veprimtarinë e punës së INSTAT-it, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare ëëë.instat.gov.al, si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i Transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e publikimit si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të Programit të Transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Faqja zyrtare elektronike e INSTAT-it është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

Parime të Përgjithshme

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së INSTAT-it janë:

-“E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.

-Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: INSTAT-i ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

-Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e INSTAT-it dhe përkatësisht: Ligji nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare" dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore për zbatimin e tij.

-Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

-Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

-Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

-Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

Informacioni që bëhet publik pa kërkesë

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Instituti i Statistikave vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.instat.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të INSTAT-it, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- INSTAT-i, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga INSTAT.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon, referuar linkut:

Në vijim jepet tabela përmbledhëse e Programit të Transparencës, 2021 i cili pasqyrohet si në linkun: <http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrko-t%C3%AB-dh%C3%ABna/programi-i-transparenc%C3%ABs/>

Tabela nr. 10: Tabela përmbledhëse e Programit të Transparencës së INSTAT

Kategoritë e Informacionit publik pa Kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Organigrama StrukturaDrejtuese	Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Menuja përkatëse në faqe zyrtare: http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/ne-jemi-instat/struktura-organizative/	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; document politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b		Menjëherë pas botimit nëfletore zyrtare	Menuja përkatëse në faqe zyrtare: http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/legjislacioni/	Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c	Ligji "Për të Drejtën e Informimit" -Format Kërkesë /Ankesë -Adresë Postare -Adresë email -Plotësim kërkesë pranë receptionit -Kërkesë / ankesë info@instat.gov.al	Menjëherë pas botimit nëfletore zyrtare	Menuja përkatëse në faqe zyrtare: http://ëëë.instat.gov.al/al/rreth-nesh/k%C3%ABrko-t%C3%AB-dh%C3%ABna/programi-i-transparenc%C3%ABs/ /Kontaktet:	Drejtoria e Komunikimit dhe Publikimeve

Në fund të faqes
zyrtare
të INSTAT
<http://instat.gov.al/>

VI. Bashkëpunimet ndërkombëtare

Koordinimi i Projekteve

Bashkëpunimi statistikor ndërkombëtar synon krahasueshmërinë e statistikave zyrtare me standardet e Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i bashkëpunimit statistikor ndërkombëtar është të forcojë Sistemin Kombëtar Statistikor duke përshtatur metodologjinë dhe praktikat me *Acquis* dhe duke i integruar ato në Sistemin Evropian të Statistikave. Bashkëpunimi ndërkombëtar i statistikave gjithashtu siguron mbështetje dhe asistencë në ndërtimin e kapaciteteve duke ndikuar në rritjen profesionale.

Një pjesë e konsiderueshme e zhvillimit të statistikave zyrtare është realizuar në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ofruar nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat kombëtare statistikore të vendeve anëtare. Pjesa më e madhe e mbështetjes është ofruar nga asistenca e Bashkimit Evropian, Sida (Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar), Zyra e Bashkëpunimit Zviceran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në bashkëpunim me Zyrën Federale të Statistikave (FSO), si dhe Kombet e Bashkuara. Në vijim paraqitet informacion më i detajuar në lidhje me natyrën e mbështetjes.

Projektet me financime të ndryshme, të zbatuara në INSTAT gjatë vitit 2021, janë si më poshtë:

1) Projekti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri”

Në kuadër të Programit IPA 2014, INSTAT-i është përfitues i kontratës së Grantit “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri”. Kontrata është nënshkruar më 11.12.2018 dhe përfundon më 10.12.2024. Qëllimi i grantit është të mbështesë INSTAT-in nëpërmjet asistencës teknike dhe zhvillimit të Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit, për kryerjen e aktiviteteve operative të Censit të Popullsisë dhe Banesave, në mënyrë që politikbërësit, qeverisja qendrore, ajo lokale dhe qytetarët e Shqipërisë të disponojnë dhe shfrytëzojnë statistika të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse mbi popullsinë rezidente të vendit. Gjatë viti 2021, aktivitetet e lidhura me menaxhimin dhe organizimin, metodologjinë dhe pyetësorët, IT, tabulimin, GIS dhe komunikimin janë zbatuar sipas planit të rishikuar të aktiviteteve. Puna është fokusuar në kryerjen e Pilotit të dytë të Censit, i cili u zhvillua më 04 Tetor – 15 Nëntor 2021.

Më datë 08 Prill 2021, INSTAT-i organizoi takim me donatorë dhe partnerë ndërkombëtarë për të prezantuar nevojat për mbështetje financiare si pasojë e shtyrjes së Censit në vitin 2022. Në takim morën pjesë përfaqësues të Qeverisë Shqiptare, Delegacionit të BE-së në Shqipëri, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, Ambasadës Zviceriane, Ambasadës Suedeze, si financues të aktiviteteve të Censit, përfaqësues të ambasadave në Shqipëri, si dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Gjatë këtij takimi INSTAT-i siguroi angazhimin e donatorëve për financimin e aktiviteteve të pambuluara të Censit.

Bazuar në detyrimet e përcaktuara në Marrëveshjen Operacionale, INSTAT-i ka kontribuar në realizimin e aktiviteteve përkatëse si më poshtë:

1)ka raportuar pranë MFE, CFCU dhe MEPJ mbi progresin e zbatimit të aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave përmes raporteve mujore, 3-mujore dhe 6 mujore.

2)ka përgatitur dhe dërguar pranë autoritetit kontraktues raportet narrative dhe financiare 6 mujore të kontratës së Grantit.

3)ka monitoruar procedurat e prokurimit të kryera gjatë këtij viti si dhe ka përgatitur dhe monitoruar procesin e certifikimit ex-post të procedurave të prokurimit të financuara nga fondet e BE.

2) Projekti “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri, IPA 2014 NP”

Kontrata e shërbimit “Mbështetje për zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022 në Shqipëri, IPA 2014 NP” është nënshkruar më 21.06.2019, dhe përfundon më 20.06.2023.

Qëllimi i kontratës së shërbimit është të mbështesë INSTAT-in me asistencë teknike për realizimin e aktiviteteve të Censit. Kontrata është në fazën e zbatimit të saj. Asistenca teknike, gjatë vitit 2021 ka kontribuar në rishikimin e pytësorëve të Censit si dhe ka mbështetur infrastrukturën IT me ndryshimet e nevojshme për të siguruar kryerjen e Pilotit të dytë të Censit me cilësi dhe në kohë. Gjithashtu, janë zhvilluar dy mbledhje të Komitetit të Lartë Drejtues me qëllim prezantimin e ecurisë së aktiviteteve të fazës përgatitore të Censit, problematikave të hasura dhe si veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e tyre.

3) Programi i Bashkëpunimit Statistikor me Shumë Vende Përfituese – IPA 2017

Mbështetja nga programi IPA 2017 shumë-përfitues i bashkëpunimit statistikor sigurohet nëpërmjet asistencës teknike specifike dhe ekspertizë për projektet pilote të ndryshme me qëllim përmirësimin e grumbullimit, prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave cilësore. Periudha e zbatimit të kontratës së përgjithshme ka filluar më 01.01.2019 dhe përfundon më 30.06.2022. Gjatë periudhës raportuese, ekspertë nga zyra kombëtare e statistikave dhe përfaqësues nga prodhues të tjerë të statistikave zyrtare morën pjesë në shumë aktivitete horizontale të organizuara: 269 aktivitete për 312 pjesëmarrës në total.

Gjatë vitit 2021 janë kryer aktivitetet sipas kontratave të shërbimit për 22 projekte statistikore si më poshtë:

Për INSTAT:

1. Statistikat financiare të qeverisë dhe të deficit të tejkaluar;
2. Llogaritë kombëtare – Metodologjia;
3. Programi i transmetimit,
4. Llogaritë kombëtare vjetore,
5. Llogaritë kombëtare tremujore dhe raportimi i cilësisë; Llogaritë rajonale;
6. Llogaritë sektoriale;
7. Tabelat burime, përdorime dhe input-output;
8. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit dhe indeksi i çmimit të banesave;
9. Statistikat e çmimeve – Matja e fuqisë blerëse;
10. Regjistrat e ndërmarrjeve;
11. Statistikat afatshkurtra: përgatitja për kuadrin rregullator për integrimin e statistikave të ndërmarrjeve;
12. Statistikat strukturore të ndërmarrjeve dhe statistikave të demografisë së ndërmarrjeve;
13. Statistikat e Kërkim-Zhvillimit dhe statistikave të fondeve të qeverisë të alokuara për Kërkim-Zhvillimin;
14. Anketa e forcave të punës;
15. Zbatimi i anketës evropiane për nivelin e jetesës;
16. Anketa evropiane e shëndetit;
17. Statistikat e bujqësisë;
18. Llogaritë mjedisore;
19. Menaxhimi i cilësisë;
20. Zbatimi i standardeve për metadatat dhe shkëmbimin e të dhënave;
- 21.
22. PRODCOM

Për BSH:

Statistikat e disbalancës makroekonomike

4) Programi i Bashkëpunimit Statistikor Shumë Përfituese – IPA 2019

Programi i bashkëpunimit statistikor shumë përfitues IPA 2019 siguron mbështetje statistikore nëpërmjet asistencës teknike dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit të INSTAT. Periudha e zbatimit të kontratës ka filluar më 01.09.2021 dhe përfundon më 31.03.2024. Objektivi i përgjithshëm i programit është të përgatisë Sistemin Statistikor në Shqipëri në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE duke përshtatur metodologjitë me acquis communautaire, duke i integruar dhe harmonizuar ato në Sistemin European të Statistikave.

Programi përfshin komponentët sipas projekteve të mëposhtme statistikore:

1. Projekti Statistikor 1.1 Statistikat e Financave të Qeverisë dhe Deficitit të Tepërt;
2. Projekti Statistikor 2.1 Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumatorit (HICP) dhe Indeksi i Çmimeve të Banesave (HPI);
3. Projekti Statistikor 2.2 Statistikat e Çmimeve;
4. Projekti Statistikor 3.2 Statistikat Afatshkurtra të Biznesit;
5. Projekti Statistikor 4.1 Anketa e Forcës së Punës;
6. Projekti Statistikor 5.5 Llogaritë Ekonomike në Mjedis.
7. Projekti Statistikor 5.6 Statistikat e Mbetjeve;
8. Projekti Statistikor 6.1 Menaxhimi i Cilësisë;
9. Projekti Statistikor 6.2 Metadate;

Më datë 07.10.2021, është zhvilluar takimi i parë kick off i kontratës së Grantit IPA 2019, me qëllim informimin në lidhje me mënyrën e menaxhimit të grantit, si dhe detyrimet kontraktuale që ka INSTAT-i në lidhje me Eurostatin.

5) Projekti “Financim direkt për të mbështetur INSTAT për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022”, mbështetur nga Sida

Më datë 16.07.2021, është nënshkruar marrëveshja e Grantit Nr. 12550 ndërmjet Suedisë dhe INSTAT-it për “Financimin e drejtpërdrejtë për të mbështetur INSTAT-in për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2022”. Projekti përfundon më 15.06.2024. Mbështetja është e fokusuar në pagat për stafin e punës në terren për Censin real (pagat e kontrollorëve), fushatën publicitare për Pilotin e dytë të Censit, përgatitjen e raporteve tematike të rezultateve të Censit, kancelari, blerjen e automjeteve, si dhe blerjen e Licencave të Aksesit të Përdoruesit (CAL) për akses në distancë.

Gjatë vitit 2021, projekti ka siguruar realizimin e videove dhe blerjen e hapësirës televizive, në kuadër të fushatës publicitare për Pilotin e dytë të Cens.

6) Sida - Projekti i Bashkëpunimit Rajonal në Europën Juglindore”

Objektivi i projektit është të kontribuojë në transferimin e njohurive në vendet e Europës Juglindore në lidhje me prodhimin statistikor më efikas dhe përshtatjen me standardet dhe acquis të BE-së.

Projekti është ndarë në 3 komponentë:

1. Të dhënat administrative dhe regjistrat
2. Metodologjia e anketimit

3. Shkolla verore

Gjatë vitit 2021 janë realizuar disa aktivitete të cilat lidhen me komponentët e sipërpërmendur. Janë kryer trajnime të ndryshme sipas fushave të përfitimit, si Metodologjia e anketave dhe të Dhënat Administrative, si dhe është mbajtur Shkolla Verore.

7) Mbështetje për Statistika të Forta Vendore Shqiptare (SALSTAT)

SALSTAT-i është pjesë e programit “Bashki të Forta” financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. SALSTAT-i është një projekt bashkëpunimi ndërmjet Zyrës Statistike Federale Zviceriane dhe INSTAT-it me qëllim sigurimin e përmirësimit të statistikave në nivel lokal dhe rajonal, në mënyrë që bashkitë t’i ofrojnë qytetarëve shërbime efektive, eficiente dhe gjithëpërfshirëse. Projekti ka filluar zbatimin më 1 Shtator 2018 dhe përfundon më 31 Gusht 2022 dhe ka në fokus kryesor përmirësimin e statistikave në nivel lokal dhe rajonal, duke përdorur të gjitha metodat e mbledhjes së të dhënave statistikore si censet, të dhënat administrative dhe regjistrat statistikore. Për më tepër, ky projekt do të mbështesë krijimin e Regjistratit Statistikor të Popullsisë si dhe Regjistratit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave, sipas parashikimeve të ligjit nr. 140/2020 “Për censin e popullsisë dhe banesave”.

Gjatë vitit 2021, projekti ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve të stafit të bashkive mbi njohuritë në statistikat zyrtare dhe SKS, si dhe ka siguruar videoprojektorë, printera dhe mirëmbajtjen e lokacionit sekondar (*back up maintenance*) për Pilotin e dytë të Cens. Gjithashtu, projekti ka kontribuar në përgatitjen e publikimit të Raportit Vjetor Rajonal të vitit 2020 dhe 2021.

8) Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale në Statistika Faza e 5-të, Sida

Projekti “Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale në Statistika Faza e 5-të”, ka filluar zbatimin e tij në Janar 2018 dhe ka përfunduar me sukses në Dhjetor 2021. Objektivi i përgjithshëm i projektit të bashkëpunimit midis INSTAT-it dhe Statistikave të Suedisë ishte të kontribuonte në zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm statistikor në Shqipëri. Komponentet e projektit ishin:

- Komponenti i Menaxhimit
- Komponenti i Metodologjisë dhe prodhimit
- Komponenti i Teknologjisë së Informacionit

Gjatë vitit 2021, janë kryer trajnime të ndryshme sipas fushave të përfitimit, si Menaxhimi, Metodologjia dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Janë hartuar edhe modulet përkatëse të trajnimit për çdo komponent, është krijuar sistemi i monitorimit për burimet njerëzore. Gjithashtu, në kuadër të projektit është finalizuar INTRANETI (faqja e brendshme e institucionit ku shfaqen të gjitha risitë dhe zhvillimet e sektorëve të institucionit), i cili përditësohet në vazhdimësi nga punonjësit e institucionit. Projekti ka ndihmuar në organizimin e trajnimeve për stafin e ri të INSTAT-it dhe institucioneve të tjera mbi të dhënat bazë statistikore.

9) Projekti IPA III 2021-2027/Faza e programimit

Programi IPA III ka si fusha prioritare reformën në administratën publike dhe mirëqeverisjen. Qëllimi i programit është përmirësimi i administratës publike në nivel qendror dhe vendor në mënyrë që të bëhet më efikase, e përgjegjshme, transparente, gjithëpërfshirëse dhe efektive. Objektivi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në një sektor publik më të aftë dhe më të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe t’i përgjigjet kërkesave të procesit të integritetit në BE.

INSTAT-i ka plotësuar fishat e projekteve për dy fushat statistikore të identifikuara si nevoja prioritare për sistemin statistikor përkatësisht:

1. Llogaritë Kombëtare
2. Statistikat e Bujqësisë

Gjatë viti 2021, IPA III ka qenë në fazën e tretë të programimit, e cila konsistoi në detajimin e Fishave Tematike të Përgjigjeve për sektorin në nivel indikatorit, si dhe finalizimin e Përgjigjes Strategjike Kombëtare.

Në këtë kuadër, gjatë kësaj periudhe INSTAT-i ka rishikuar fishat e projekteve për Llogaritë Kombëtare dhe Statistikat e Bujqësisë sipas formatit të kërkuar nga Kryeministria. Gjithashtu, ka dhënë kontributin e tij në përgatitjen e dokumentit të Përgjigjes Strategjike Kombëtare për IPA III, si dhe ka reflektuar përgjigjet e tij në këtë dokument për sa i përket komenteve të donatorëve.

VII. Integrimi Evropian

Në kuadër të procesit të Integritimit Evropian, INSTAT-i, në bashkëpunim me agjencitë statistikore Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka përfshirë 9 akte në PKIE 2022-2024, përkatësisht 5 akte propozuara nga INSTAT-i dhe 4 akte nga Banka e Shqipërisë. Gjatë vitit 2021, janë miratuar aktet sipas parashikimeve në PKIE 2021-2023, ndërkohë një akt është shtyrë për në vitin 2023 dhe një akt është riformuluar.

Në zbatim të urdhrimit të Kryeministrit nr.94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin Evropian”, INSTAT-i ka zhvilluar takime periodike të GNPIE-së për Kapitullin 18 “Statistikat”, duke kryer edhe analizën dhe planifikimin për përafrimin e akteve komunitare.

Po në kuadër të procesit të Integritimit Evropian, mbështetur në VKM nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” si dhe në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr.113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”, INSTAT-i ka ngritur Tryezën e Diskutimit “Statistikat” për Kapitullin 18, me 8 përfaqësues nga shoqëria civile të cilët kanë shprehur interes dhe janë bërë pjesë e kësaj tryeze për të kontribuar në kuadër të Platformës së Partneritetit Publik për Integrimin Evropian. Gjatë vitit 2021, INSTAT-i organizoi takime konsultuese dhe informative me këtë tryezë diskutimi.

Si anëtar i grupit negociator, përgjegjës për Kapitullin 18 “Statistikat”, INSTAT-i ka marrë pjesë dhe kontribuar rregullisht në takimet periodike të Grupit Negociator, si dhe ka kryer raportimet javore dhe tremujore pranë Kryenegociatorit për problematikat dhe rezultatet e arritura.

INSTAT-i mori pjesë dhe kontriboi në Nënkomitetin e 13-të, të Çështjeve Ekonomike Financiare dhe Statistikat, ECOFIN, i cili u organizua online në data 11-12 Nëntor 2021, ku u raportuar kryesisht për:

- Progresin në zbatim të rekomandimeve të “Peer Review” 2018;
- Progresin në zbatimin e ligjit përstatistikat zyrtare;
- Situatën në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Përditësimin mbi Censin e dytë pilot dhe Censin e Popullsisë së Banesave 2022;
- Progresin në Llogaritë Kombëtare Tremujore dhe Vjetore sipas ESA 2010, duke përfshirë Tabelat e njoftimit të Procedurës së Deficitit të Tejkaluar (EDP);
- Statistikat e Bujqësisë, planin për censin e ardhshëm të bujqësisë si dhe përparimet e bëra në regjistrat e fermës dhe të kafshëve.

Gjatë takimit Komisioni vlerësoi progresin e bërë mbi zbatimin e rekomandimeve të Peer Review 2018 dhe inkurajoi INSTAT-in të vazhdojë punën për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Komisioni gjithashtu mirëpriti angazhimin e treguar nga institucionet shqiptare në lidhje me Censin e Popullsisë dhe Banesave dhe vlerësoi përparimin e bërë në Llogaritë Kombëtare dhe Tabelat e njoftimit të Procedurës së Deficitit të Tejkaluar EDP. Nga ana tjetër Komisioni theksoi nevojën për përmirësime për të arritur përputhjen e plotë me ESA 2010.

Në kuadër të Progres Raportit të BE-së për Shqipërinë 2021, Komisioni Evropian theksoi për Kapitullin 18 Statistikat” se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për statistikat.

Sipas raportit, njëfarë progresi është arritur, veçanërisht në përafrimin me standardet e ESA 2010, publikime në kohë të statistikave dhe rritja e transmetimit në Eurostat. Roli i SKS u forcua më tej dhe burimet u përmirësuan; megjithatë, u rekomandua që metodat e mbledhjes së të dhënave duhet të modernizohen dhe proceset statistikore të prodhimit të përmirësohen. Komunikimet me përdoruesit duhet të përmirësohen.

Në vitin 2022, Shqipëria duhet veçanërisht:

- të zbatojë Censin e Popullsisë dhe Banesave në përputhje me legjislacionin përkatës të BE –së dhe standardet ndërkombëtare;
- të finalizojë planin e veprimit dhe buxhetin e parashikuar të detajuar për Censin e Bujqësisë të vitit 2024;
- të zbatojë ligjin për statistikat zyrtare dhe të vazhdojë përmirësimin dhe rolin e tij si Koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor si dhe zgjerimin e numrit të agjencive statistikore.

Të udhëhequr nga objektivi strategjik “Fuqizimi i rolit të INSTAT si një pjesëtar aktiv në sistemin statistikor në vend, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare”, INSTAT ka vijuar me angazhimin e tij në paraqitjen e raporteve, mendimeve e studimeve në arenën ndërkombëtare në fushën e prodhimit dhe zhvillimit statistikor duke marrë pjesë dhe kontribuar në forume dhe aktivitete të ndryshme botërore të statistikave.

Në nivel ndërkombëtar, INSTAT ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në takimet periodike të organizuara nga Kombet e Bashkuara, si në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe ndërtim të kapaciteteve për statistikat për Axhendën e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm- HLG PCCB, ku Shqipëria është anëtar; në Komitetin e Programit të Forumit Botëror të të Dhënave të Kombeve të Bashkuara; në Komisionin për Ekonominë, etj.

INSTAT-i mori pjesë dhe kontribuoi në “Forumin e tretë Botëror të të Dhënave të Kombeve të Bashkuara”, organizuar në datat 3-6 Tetor në një format hibrid me afro 7,000 pjesëmarrës që online dhe më shumë se 700 pjesëmarrje fizike në Bern Zvicër. Forumi i tretë Botëror i të dhënave i OKB-së, përbëhej nga një kombinim i seancave plenare të nivelit të lartë dhe ngjarjeve paralele të shpërthimit duke u fokusuar në grupe të veçanta tematike. (për më shumë informacion, shih seksionin OZHQ).

Në kontekstin Evropian, INSTAT ka qënë gjithashtu aktiv. Në datat 21-22 Tetor 2021, u mbajt online takimi i përvitshëm i Grupit të politikave për bashkëpunimin statistikor – PGSC, organizuar nga Eurostat me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, DG Near dhe donatorë si Sida, EFTA etj. Në këtë takim INSTAT prezantoi “Zhvillimet mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave” si dhe zhvillime të tjera në fushën e statistikave zyrtare.

Vlen të theksohet se INSTAT-i ka mbajtur komunikime të vazhdueshme me Eurostat, organizata ndërkombëtare si UN, UNECE, EFTA, OECD, PARIS 21, si dhe institucione ndërkombëtare homologe mbi mbështetjen dhe monitorimin e aktiviteteve të ndryshme statistikore, në kuadër të zhvillimeve të reja dhe me të fundit në fushën e statistikave.

VIII. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

INSTAT vazhdon t'i kushtojë një rëndësi të veçantë zbatimit të Agjendës 2030, për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasi statistikat janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Politikat dhe strategjitë që duhet të zhvillohen për arritjen e 17 objektivave dhe 169 targeteve duhet të mbështeten nga treguesit statistikorë për një vendimarrje të bazuar në evidenca.

Aktualisht INSTAT prodhon 55 indikatorë statistikorë, të cilët përditësohen në platformën për OZHQ-të, në faqen zyrtare të INSTAT <http://instat.gov.al/al/sdgs/>.


Për rritjen e numrit të indikatorëve dhe standardizimit të metodologjive të prodhimit të tyre, INSTAT bashkëpunon me institucionet e tjera në vend, si dhe me organizatat e Kombeve të Bashkuara.

INSTAT, që prej vitit 2019 ka vijuar kontributin e tij në Grupin e Nivelit të Lartë për Partneritet, Koordinim dhe Ndërtim të Kapaciteteve për Statistikat për Axhendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm - HLG PCCB, ku Shqipëria është anëtare. INSTAT mori pjesë dhe kontribuoi në "Forumin e tretë Botëror të të Dhënave të Kombeve të Bashkuara", të mbajtur në datat 3-6 Tetor 2021. Gjatë Forunit u organizuan mbi 50 sesione nën gjashtë tema, përkatësisht: qasje të reja për zhvillimin e kapaciteteve për të dhëna më të mira; inovacionet dhe sinergjitë në të gjithë ekosistemet e të dhënave; moslënia e askujt pas; kuptimi i botës përmes të dhënave; ndërtimi i besimit në të dhëna dhe statistika; dhe sa larg kemi arritur.

IX. Organigrama dhe baza ligjore

Struktura e Institutit të Statistikave

Në fund të vitit 2021, gjendja faktike në INSTAT është 223 punonjës, nga të cilët 211 punonjës në shërbimin civil dhe 12 punonjës administrativ, 11 pozicione vakante dhe 2 pozicione të pezulluara me kërkesë të punonjësit.



Kuadri Rregullator për fushën e prodhimit të statistikave zyrtare

Veprimtaria e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe INSTAT-it si pjesë kryesore përbërëse e tij ushtrohet në përputhje me Ligjin Nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Programin e Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021 dhe Planin Vjetor 2021 për zbatimin e tij, miratuar përkatësisht me Vendimet e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017 dhe nr. 19/2021, në zbatim të neneve 9 dhe 10 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”. Sistemi Kombëtar Statistikor mbështetet edhe në normat ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë sektoriale të prodhuesve të tjerë të statistikave zyrtare, çështjet e mbrojtjes së të dhënave personale etj.

Në kuadrin rregullator të sistemit përfshihen edhe konventat e marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare në interes të zhvillimit statistikor në vend, si dhe aktet komunitare të BE-së në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojnë të përarrfrojnë standardet statistikore të përcaktuara veçanërisht në Rregulloren (KE) nr. 223/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, datë 11 Mars, 2009, “Mbi statistikat evropiane”, ndryshuar me rregulloren (KE) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 Prill, 2015.

Instrumentë të tjerë rregullatorë të veprimtarisë statistikore të SKS janë edhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të nënshkuara nga INSTAT me institucionet që furnizojnë prodhuesit me të dhëna administrative si edhe institucionet që mbështesin kryerjen e aktiviteteve.

Vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e klasifikimeve statistikore janë gjithashtu pjesë e kornizës ligjore që siguron harmonizimin e emërtimeve dhe kodifikimeve të produkteve, mallrave e shërbimeve nga të gjitha institucionet publike, dhe për rrjedhojë, edhe harmonizimin e definicioneve të tyre nga pikëpamja statistikore, në përputhje me klasifikimet statistikore ndërkombëtare.

a) Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij

Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në zbatim të rekomandimeve të BE-së për Shqipërinë në lidhje me forcimin e Sistemit Kombëtar Statistikor dhe rritjen e pavarësisë profesionale të prodhuesve të statistikave zyrtare. Miratimi i ligjit u cilësua nga partnerët ndërkombëtarë si hapi më i rëndësishëm në fushën e prodhimit statistikor për të garantuar cilësinë statistikore dhe përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për këto produkte. Me pozicionimin e INSTAT-it si institucion publik i pavarur, i cili raporton drejtpërdrejt në Kuvend, është mundësuar rritja e besueshmërisë së publikut në vlefshmërinë e statistikave të prodhuara si dhe bashkëpunimi profesional ndërmjet aktorëve të tjerë të Sistemit Kombëtar Statistikor.

Në zbatim të ligjit për statistikat zyrtare, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, kanë miratuar akte nënligjore, të cilat rregullojnë më tej funksionimin e sistemit statistikor dhe organeve të përfshira në drejtimin e tij:

- i. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 7.11.2018 “Për miratimin e procedurave, të kritereve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidatave për t'u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave”. Ky projektakt është nxjerrë në vijim të frymës së ligjit për të forcuar pavarësinë profesionale të organit drejtues të INSTAT. Ai përcakton në mënyrë të detajuar procedurat që duhen ndjekur për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, duke ndjekur procedurën transparente dhe publike të përzgjedhjes së tij.
- ii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”. Vendimi është nxjerrë si pasojë e ndryshimit të natyrës së përfaqësimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Sipas kërkesave të ligjit, Këshilli i

Statistikave duhet të përbëhet nga përfaqësues të përdoruesve të statistikave zyrtare, si grupi i drejtpërdrejtë i interesuar për produktin statistikor. Në përbërje të tij janë përfshirë anëtarë përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, organet e vetëqeverisjes vendore, medias, botës akademike, shoqërisë civile.

- iii. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 07.11.2018 “Për ngritjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën”. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën është organ i cili udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të cilat përpunojnë të dhëna administrative. Ky komision ka për detyrë të kryejë përditësimin, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare. Harmonizimi i nomenklaturës finalizohet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të këtij komisioni.
- iv. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 19.06.2019 “Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara”. Ky vendim është miratuar në mbështetje të pikës 2 të nenit 36 të ligjit për statistikën zyrtare, në vijim të rritjes së autonomisë së INSTAT-it në menaxhimin e të ardhurave që krijon gjatë shërbimeve statistikore të kryera përtej atyre të parashikuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe Planin Vjetor për zbatimin e tij.
- v. Vendimi i Kuvendit nr. 127/2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Institutit të Statistikave”. Për shkak të ligjit të ri për statistikën zyrtare, INSTAT ka ndryshuar statusin nga institucion qendror në varësi të ekzekutivit, në institucion publik të pavarur. Struktura organizative e institucioneve të pavarura rregullohet me ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar.
- vi. Vendimet e Kuvendit nr. 75/2019, 76/2019, 77/2019, 78/2019, 79/2019, 80/2019 dhe 81/2019, datë 04.07.2019 dhe 61/2021 datë 01.07.2021 për lirin/emërimin/zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave. Vendimet e Kuvendit mundësuan plotësimin e të gjitha vendeve vakante të Këshillit të Statistikave dhe funksionimin e plotë të tij. Referuar ligjit për statistikën zyrtare, anëtarët e këshillit gëzojnë mandat 5-vjeçar me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë.

b) Programi i Statistikave Zyrtare

Programi i Statistikave Zyrtare (PSZ) është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga Sistemi Kombëtar Statistikor të të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, për një hark kohor prej pesë vitesh. Programi është dokumenti kryesor mbi të cilin bazohen veprimtaritë e institucioneve prodhuese të statistikave zyrtare. Ai përcakton institucionet prodhuese të statistikave, njësitë që detyrohen të ofrojnë të dhënat administrative etj, metodologjinë e prodhimit dhe frekuencën e publikimit të tyre.

Programi respekton garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në legjislacionin për statistikën zyrtare, në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane⁴ dhe parimet themelore të Kombeve të Bashkuara (Fundamental principles).

Programi aktual përfshin periudhën 2017-2021 dhe është miratuar me Vendimin e Kuvendit nr. 10/2017, datë 09.02.2017 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021”.

c) Plani Vjetor për zbatimin e PSZ

⁴<http://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-statistics-code-of-practice>

Plani Vjetor për zbatimin e PSZ është dokument i cili përgatitet nga INSTAT në bashkëpunim me prodhuesit e tjerë të statistikave zyrtare dhe miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë në zbatim të neneve 9 dhe 10 të Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”. Dokumenti shërben për parashikimin e veprimtarive statistikore në përmbushje të objektivave strategjike dhe rezultateve të pritshme të parashikuara në PSZ.

Mbështetur në pikën 2 të nenit 9 të ligjit për statistikat zyrtare, INSTAT është përgjegjës për përgatitjen e Planit Vjetor në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor, për të planifikuar operacionet, burimet dhe rezultatet e pritshme për vitin pasardhës si dhe për të përcaktuar përgjegjësitë e aktorëve institucionalë të përfshirë për sigurimin, mbledhjen, përpunimin, prodhimin dhe publikimin e statistikave zyrtare.

Në tërësinë e tij, dokumenti paraqet aktivitetet statistikore që do të kryejnë prodhuesit e statistikave zyrtare (aktualisht janë INSTAT, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë), sipas fushave përkatëse statistikore që mbulojnë, shoqëruar me afatet e zbatimit të tyre. Më tej, në brendësi të tij, paraqiten institucionet që janë përgjegjëse për dhënien e informacionit statistikor dhe frekuencën e transmetimit të këtij informacioni. Me qëllim që të sigurohet mbarëvajtja e veprimtarive të parashikuara dhe parandalimi i pengesave të mundshme, dokumenti përmban edhe nivelin e risqeve të pritshme.

ç) Memorandume Mirëkuptimi

Për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në interes të përmirësimit të statistikave zyrtare, besueshmërisë së publikut në to dhe për t’iu përshtatur standardeve të reja të përcaktuara nga ligji për statistikat zyrtare, INSTAT ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me një sërë institucionesh furnizuese me të dhëna administrative. Gjatë vitit 2021 janë nënshkruar dy marrëveshje të reja mirëkuptimin përkatësisht: memorandum mirëkuptimi ndërmjet INSTAT dhe Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare dhe memorandum mirëkuptimi ndërmjet INSTAT dhe Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu është firmosur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet INSTAT dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe janë përditësuar sipas kuadrit të ri ligjor disa memorandume mirëkuptimi me institucione të tjera, të cilët mbajnë të dhëna administrative. Nëpërmjet memorandumeve, palët janë dakordësuar për shkëmbimin e të dhënave që disponojnë, duke respektuar parimet e konfidencialitetit statistikor dhe kuadrin ligjor mbi të cilin ushtrojnë veprimtarinë institucionet përkatëse. Gjithashtu, nëpërmjet memorandumeve, palët shprehin vullnetin për të zhvilluar aktivitete e projekte të përbashkëta për rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve, përfshirjes së stafit në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe prodhimit statistikor, etj. Marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me universitetet kanë për qëllim përfshirjen e kërkuesve shkencorë në proceset e prodhimit dhe përdorimit të statistikave zyrtare si dhe të studentëve për tu njohur me fushën statistikore si praktikantë. Për të siguruar zbatimin e duhur të marrëveshjeve, palët janë dakordësuar për ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, të cilët jo vetëm do të kujdesen për zbatimin e saj, por edhe për të propozuar ide apo veprime të tjera në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore. Lista e memorandumeve të bashkëpunimit të nënshkruara ndërmjet INSTAT dhe institucioneve të tjera është si vijon:

Nr.	Memorandume Mirëkuptimi	Data e nëshkrimit
<u>Prodhues të statistikave zyrtare</u>		
1	Banka e Shqipërisë	12.05.2008
2	Ministria Financave dhe Banka e Shqipërisë	03.10.2016
<u>Ofrues të të dhënave administrative / Përdorues</u>		
3	Ministria e Brendshme	11.11.2010
4	Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve	11.03.2015
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	31.03.2016
6	Shërbimit Gjeologjik Shqiptar	11.04.2017
7	Instituti i Sigurimeve Shoqërore	18.04.2017
8	Qendra Kombëtare e Biznesit	08.05.2017
9	Shërbimi Social Shtetëror	06.06.2017
10	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	09.06.2017
11	Ministria e Mbrojtjes	13.06.2017
12	Ministria e Kulturës	14.07.2017
13	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	05.09.2017
14	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	27.09.2017
15	Agjencia e Zhvillimit të Territorit	06.10.2017
16	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	17.11.2017
17	Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare	14.12.2017
18	Fondi Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	20.12.2017
19	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	06.02.2018
20	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	09.02.2018
21	Instituti Shëndetit Publik	19.04.2018
22	Shërbimi Kombëtar i Punësimit	19.11.2018
23	Prokuroria e Përgjithshme	30.10.2019
24	Agjenca Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion	09.07.2020
25	Avokati Popullit	03.09.2020
26	Autoriteti Mbikqyrjes Financiare	30.03.2021
27	Ministria Drejtësisë	11.11.2021
28	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	06.07.2005
<u>Bota akademike dhe përdorues të tjerë</u>		
1	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë	05.05.2017
2	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë	20.03.2018
3	Kolegji Harvard	20.03.2018
4	Agjencia e Statistikave të Kosovës	07.06.2021

Bazuar në aktivitetet e Planit Operacional, synohet që për vitin 2022 të rishikohen memorandumet ekzistuese, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstucional. Memorandumet e reja që priten të nënshkruhen në 2022 janë me institucionet siç vijon:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
2. Minsitria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
3. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
5. Agjensia Kombëtare e Mjedisit;
6. Autoritetet Portuale dhe Portet në Shqipëri (Porti Durrës, Porti Vlorë, Porti Sarandë, Porti Shëngjin).

X. Veprimtaria e organizmave mbështetëse të prodhimit statistikor

Referuar legjislacionit për statistikat zyrtare, organizmat mbështetëse për prodhimin statistikor janë:

- Bordi Drejtues i INSTAT-it
- Këshilli i Statistikave, dhe
- Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën

Veprimtaria e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues është organ i cili vepron brenda INSTAT-it dhe ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit, të propozojë planet për zbatimin e buxhetit dhe mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave të tij, si dhe t'i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT udhëzime e standarde, të cilat sigurojnë zbatimin e parimeve statistikore nga Sistemi Kombëtar Statistikor. Detyrat specifike të bordit përcaktohen në nenin 20 të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare".

Bordi Drejtues përbëhet nga nëpunësit civilë të INSTAT-it, të cilët janë të paktën të nivelit të mesëm drejtues, duke iu referuar strukturës organizative të miratuar me vendimin e Kuvendit. Në interes të transparencës me publikun si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Peer Review, veprimtaria e Bordit Drejtues është publikuar në faqen zyrtare internetit të INSTAT-it.

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2021, Bordi Drejtues ka zhvilluar 2 mbledhje. Në mbledhjen e datës 01.02.2020 është miratuar Plani Vjetor i Rekrutimeve dhe Plani Vjetor i Trajnimeve. Gjithashtu, në këtë mbledhje është diskutuar dhe ecuria e përgatitjes së strategjisë së gjuhës "R", si dhe standardizimi i tabelave që drejtoritë prodhuese dërgojnë tek drejtoria e Llogarive Kombëtare. Ndërsa në mbledhjen e datës 29.04.2021 Bordi Drejtues i INSTAT shqyrtoi projekt-buxhetin afatmesëm (PBA) 2022-2024 dhe miratoi regjistrin e Riskut për vitin 2021. Ky dokument u ndërtua bazuar në standardet e dokumenteve të ngjashëm të ministrive apo institucioneve të tjera shtetërore, duke paraqitur një pasqyrë të plotë të risqeve të mundshme që rrezikojnë realizimin e plotë dhe në kohë të aktiviteteve statistikore, si dhe parashikimin e masave që duheshin marrë për evitimin/minimizimin e efekteve të mundshme të këtyre risqeve. Dokumenti u shoqërua me një trafik light, duke prioritetizuar kështu risqet për nga efekti dhe mundësia e ndodhjes së tyre.

Gjatë katërmujorit të dytë është zhvilluar një mbledhje e Bordit Drejtues, në datën 27.08.2021, në të cilën u diskutua PBA 2022-2026, u miratua plani i rishikuar i rekrutimeve, për shkak të vakancave të krijuara, si dhe u miratuan udhëzimet e cilësisë sipas versionit 5.1 i GSBPM (Modeli i Planifikimit të Fazave të Prodhimit Statistikor). Në zbatim dhe të rekomandimeve të Peer Review nga Eurostat për harmonizimin e GSBPM dhe zgjerimin e përdorimit të tij, INSTAT në bashkëpunim me Institutet e tjera ndërkombëtare ka përgatitur versionin 5.1 të këtij modeli planifikimi, i cili tashmë shoqërohet nga udhëzimet dhe rekomandimet për zbatimin e duhur të tij, si një dokument i bazuar në kërkesat e cilësisë të Kodit të Praktikave dhe rekomandimet e tjera ndërkombëtare.

Në katërmujorin e tretë të vitit, janë zhvilluar tre mbledhje të Bordit Drejtues. Në mbledhjen e datës 19.11.2021 u miratua Projekt-Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026, si dhe u shqyrtua Plani Vjetor i PSZ 2022. Projekt-Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026 iu paraqit Bordit Drejtues pas shqyrtimit të nga Këshilli i Statistikave, dhe për pasojë pas reflektimit të ndryshimeve/rishikimeve në zbatim të rekomandimeve të këtij organizimi për përmirësimin e dokumentit. Ndërsa lidhur me Planin Vjetor të PSZ 2022 u vendos që të rishikohej në të linjë me rishikimet të cilave iu nënshtrua Projekt-PSZ 2022-2026, duke qenë se vetë dokumenti i Planit Vjetor hartohet në zbatim të Programit 5 vjeçar të Statistikave

Zyrtare. Në mbledhjen e datës 10.12.2021 u miratua Projekt-Plani Vjetor i PSZ 2022, dokument i cili iu paraqit Bordit Drejtues për miratim pas ndryshimeve/rishikimeve në funksion të harmonizimit të tij me Projekt-PSZ 2022-2026; u miratua strategjia e përdorimit të softëare-ve të përpunimit statistikor open source dhe e gjuhës “R”, si dhe u diskutua plani operacional 2022, plani i anketave 2022 dhe kalendari i diskutimeve 2022. Në mbledhjen e datës 29.12.2021, Bordi Drejtues miratoi perfshirjen ne Planin Vjetor të Rekrutimit, pozicionin vakant të Sekretarit të Përgjithshëm të INSTAT-it.

Veprimtaria e Këshillit të Statistikave

Këshilli i Statistikave mbështet INSTAT-in në rolin e tij për të siguruar se Programi Statistikave Zyrtare është hartuar në përputhje me parimet themelore të Kombeve të Bashkuara për statistikat zyrtare.

Këshilli i Statistikave përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit e statistikave zyrtare, botën akademike, shoqërinë civile, sipërmarrësit privatë, organet e vetëqeverisjes vendore dhe median.

Emërimi i anëtarëve bëhet me vendim të Kuvendit. Këshilli i Statistikave e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe VKM-në nr. 670, datë 7.11.2018 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”.

Këshilli i Statistikave mblidhet të paktën tri herë në një vit kalendarik. Kuorumi përbëhet nga të paktën shtatë anëtarë të Këshillit. Sekretariati i Këshillit të Statistikave sigurohet nga INSTAT-i.

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 4 mbledhje të Këshillit, përkatësisht në datat 12.03.2021, 30.06.2021, 01.11.2021 dhe 16.11.2021.

Në mbledhjen e parë, të datës 12.03.2021, Këshilli shqyrtoi ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2020. Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT me anë të raportit 4-mujor të zbatimit të PSZ prezantoi ecurinë e performancës së Sistemit Kombëtar Statistikor në drejtim të zbatimit të afateve të proceseve të prodhimit statistikor të parashikuara në Planin Vjetor të PSZ 2020. Rezultatet e raportimit konsistonin në matjen e realizimit në kohë dhe me cilësi të fazave të prodhimit statistikor si: Grumbullimi, përpunimi, publikimi dhe transmetimi i të dhënave. Në diskutimet e anëtarëve të Këshillit u propozua mundësia e përfshirjes në raport të disa indikatorëve të tjerë matës të performancës së Sistemit përtej prodhimit statistikor, në mënyrë që të vërehej dhe trendi i rezultateve të tyre në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në mbledhjen e dytë, të datës 30.06.2021, u pasqyrua ecuria e zbatimit të PSZ për periudhën Janar-Prill, 2021. Në raport ishin reflektuar dhe risitë në zbatim të rekomandimeve të Këshillit në mbledhjen paraardhëse të tij, duke paraqitur trendin e performancës në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar për indikatorë si: Zbatimi i PSZ; Zbatimi i Planit të Trajnimeve; Përdorimi i sistemit për aksesimin e të dhënave nga jashtë në mënyrë të sigurtë; Dokumentimi i Aktiviteteve Statistike; Raportet e Cilësisë; Google Analytics (nr i vizitave në faqen e INSTAT); Botime të reja. Rezultatet treguan për një trend rritës të performancës së SKS në këto drejtime.

Në mbledhjen e tretë, të datës 01.11.2021, Këshilli shqyrtoi draft-Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 dhe draft-Planin Vjetor të PSZ 2022. Një ndër rekomandimet kryesore sa i përket draft-PSZ 2022-2026 ishte sinkronizimi i pjesës operacionale dhe pjesës strategjike të Programit, si dhe paraqitja në program e një qasje krahasuese midis PSZ 2017-2021 dhe PSZ 2022-2026, duke evindetuar kështu dhe sfidat e SKS në 5 vitet e ardhshme. Sa i përket rekomandimit të parë Këshilli sugjeroi vendosjen e një lidhje midis aktiviteteve statistikore dhe objektivave strategjik të cilëve i dedikohet realizimi i tyre. Ndërsa

sa i përket rekomandimit të dytë u propozua paraqitja e disa dimensioneve krahasuese midis 2 programeve duke na parashtruar drejtimet të cilat kërkojnë më shumë fokus në 5 vitet e ardhshme. Në mbledhje u vendos që programi të rishikohet sipas këtyre qasjeve dhe t'i paraqitet Këshillit në formë të rishikuar brenda dy javeve nga data e mbledhjes referencë, si dhe Plani Vjetor i PSZ të rishikohet në të njëjtën linjë me PSZ 5-vjeçare.

Në mbledhjen e katërt, të datës 16.11.2021, u paraqit në Këshillin e Statistikave versioni i rishikuar i Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, Projekt-Plani i PSZ 2022, si dhe u prezantua ecuria e zbatimit të PSZ për periudhën Maj-Gusht, 2021. Pas shqyrtimit Këshilli miratoi projekt-Programin e PSZ 2022-2026 duke konfirmuar zbatimin e rekomandimeve që ky organizëm kishte dhënë për përmirësimin e dokumentit si dhe miratoi projekt- Planin e PSZ 2022 i cili ishte rishikuar në të njëjtën linjë me projekt-PSZ 2022-2026.

Veprimtaria e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën

Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën drejton aktivitetet për përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike dhe sociale, në përputhje me nomenklaturat evropiane dhe ndërkombëtare.

Komisioni e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare” dhe akteve nënligjore që rregullojnë ngritjen, funksionimin, detyrat dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këtij komisioni.

KKN kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT, dhe anëtarët e komisionit përfaqësojnë institucionet sipas VKM Nr. 671, datë 07.11.2018.

Komisioni Kombëtar i Nomenklaturave përbëhet nga 19 anëtarë, të cilët përfaqësojnë përdoruesit kryesorë të nomenklaturave, pjesë e sistemit kombëtar statistikor.

Nomenklaturat përdoren si bazë për mbledhjen, përpilimin dhe shpërndarjen e të dhënave në çdo fushë statistikore. Ato ofrojnë koncepte të standardizuara, të përdorura për të përshkruar fenomene të tilla si aktiviteti ekonomik, produktet, shpenzimet, profesioni, shëndetësia etj, si dhe shërbejnë për të matur në mënyrë të vazhdueshme këto fenomene brenda vendit dhe në të gjithë vendet dhe rajonet gjeografike. Klasifikimet ndërkombëtare vendosin standarde për klasifikimet e përdorura, të cilat shërbejnë si modele për zhvillimin e klasifikimeve statistikore përkatëse kombëtare. Nomenklaturat bëjnë të mundur krahasimin e të dhënave me rajonin, Evropën apo edhe me shtetet e tjera në mbarë botën. Ato janë mjete që përdoren nga organizatat kombëtare të statistikave, agjencitë ndërkombëtare, akademitë dhe përdoruesit e tjerë, përfshirë edhe përfaqësuesit ligjorë.

Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar katër mbledhje të Komisionit, përkatësisht në datat 31 Mars 2021, 28 Maj 2021 (mbledhje ad-hoc), 10 Dhjetor 2021 dhe 23 Dhjetor 2021.

Në datë 31.03.2021 u zhvillua mbledhja e parë e KKN-së. Diskutimet u fokusuan në çështje si: Miratimi i projektrregullores për funksionimin e Komisionit të Nomenklaturave; Zgjedhja e Zëvendëskryetarit të KKN; Diskutim për nomenklaturat që do të trajtoheshin gjatë vitit 2021 dhe reflektimi në Planin e Punës 2021; Miratimi i Planit të Punës së KKN për vitin 2021; Diskutime mbi nomenklaturën GEONOM (Nomenklatura e Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e tjera të Biznesit). Gjithashtu në këtë mbledhje u diskutuan dhe trajnimet që INSTAT ofron bazuar në strategjinë afatgjatë të trajnimeve që institucioni ka hartuar.

Në datë 28.05.2021 u zhvillua mbledhja ad-hoc e KKN për miratimin e nomenklaturës GEONOM. Votimi u krye online nga pjesmarrësit prezent në mbledhje, të cilët vendosën miratimin e kësaj nomenklature.

Më datë 10 Dhjetor 2021 u zhvillua mbledhja e tretë e KKN. Mbledhja u fokusua në dy çështje kryesore përkatësisht: Miratimi i dy klasifikimeve përkatësisht Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (KSNA 2011) si dhe Nomenklatura e Produkteve sipas Aktiviteteve Ekonomike (NPA 2.1). Pas diskutimeve anëtarët vendosën për miratimin e klasifikimeve të

Në datë 23 Dhjetor 2021 u zhvillua dhe takimi i fundit i KKN për vitin 2021. Diskutimet u fokusuan nëçështje si: Prezantimi i Relacionit dhe projekt-vendimit për klasifikimin KSNA 2011; Prezantimi i Relacionit dhe projekt-vendimi për klasifikimin NPA 2.1; Prezantimi i draft-planit të aktiviteteve të KKN për vitin 2022, si dhe prezantimi tek anëtarët e ecurisë së punës së kryer nga grupi i punës mbi Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimeve, ICCS, i cili do të kalojë për miratim në KKN gjatë vitit 2022.

Tabela nr. 11: Nomenklaturat statistikore të miratuara në Republikën e Shqipërisë

Nr	Emri nomenklaturës	Bazaligjore kombëtare	Baza ligjore evropiane/ndërkombëtare	Përmbajtja e bazës ligjore
1	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev2	Vendim i KM nr. 320, datë 28.5.2014 "Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev.2)"	Rregullore e Komisionit (EC) Nr 1893/2006 e 20 Dhjetorit 2006 mbi klasifikimin statistikor të aktiviteteve ekonomike NA CE Revision 2	Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev2
2	Nomenklatura e Mallrave dhe Tarifave	1. Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. 2. VKM nr. 651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë"	Rregullorja e Këshillit të Europës, Nr 2658/87, të datës 23 korrik mbi nomenklaturën tarifore dhe statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore (Rregullorja bazë)	http://www.dogana.gov.al/dokument/1179/ligj-nr-102-2014-date-3172014-i-ndryshuar http://www.dogana.gov.al/dokument/1497/dz-vkm-nr-651-date-10112017
3	Nomenklatura e produkteve	Vendim i KM Nr. 433 datë 17.6.1996 "Për miratimin e zbatimit të nomenklaturës së produkteve"	Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr 1232/98 datë 17 Qershor 1998, ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr. 3696/93 mbi klasifikimin statistikor të produkteve sipas aktiviteteve (CPA).	http://www.instat.gov.al/media/1841/nomenklatura_e_produkteve_sipas_aktiviteteve.pdf
4	Nomenklatura e Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 20.9.2017 për "Miratimin e zbatimit të klasifikimit të produkteve të konsumit sipas qëllimit (COICOP)".	Rregullorja e Këshillit të Europës Nr. 1749/1999, datë 23 Korrik 1999 "Mbi klasifikimin e konsumit individual sipas qëllimit".	http://www.instat.gov.al/media/3959/02_nomenklatura_coicop_5digjit_i_plote_final_al.pdf

<p>5</p> <p>Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Profesioneve (LKP) është një mjet përgrupimin e vendeve të punës nëgrupe të përcaktuara qartë sipas detyravetëndër marranëpunë.</p>	<p>Vendim i Këshillit të Ministrave nr.514, datë 20.9.2017 Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP), tërishi ikuar</p>	<p>Rregullorja e Këshillit të Evropës Nr.1022/2009, datë 29 Tetor 2009 "Mbi Klasifikimin Standard Ndërkombëtar të Profesioneve".</p>	<p>Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtar i Profesioneve (LKP)</p>
<p>6</p> <p>Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit</p>	<p>Vendim i Këshillit të Ministrave nr.136, datë 20.3.2019 "Për Miratimin e Nomenklaturës së Klasifikimit të Llojeve të Ndërtimit (KN)</p>		<p>Klasifikimi i llojeve të Ndërtimit</p>
<p>7</p> <p>Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit</p>	<p>Vendimi i KM Nr. 137, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës së Statistikave të Transportit".</p>	<p>Rregullorja e Komisionit Evropian Nr.1304/2007, datë 7 Nëntor 2007, amenduar me Direktivën e Këshillit Nr. 95/64, Rregulloren e Këshillit Nr. 1172/98, Rregulloret e KE Nr. 91/2003 dhe Nr. 1365/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me themelimin e NST 2007 si klasifikimin unik për mallrat e transportuara në mënyrat e caktuara të transportit.</p>	<p>Nomenklatura Standarde Transporteve</p>
<p>8</p> <p>Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin</p>	<p>Vendimi i KM Nr. 135, datë 20.03.2019 "Për miratimin e Nomenklaturës Ndërkombëtare të Sëmundjeve ICD-10".</p>		<p>Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizioni i 10-të/vëllimii Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të lidhura me shëndetin/Revizionimi i 10-të/vëllimii</p>
<p>9</p> <p>Klasifikimi i Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit. (GEONOM)</p>	<p>Vendimi i KM, Nr. 541, datë 29.09.2021 "Për miratimin e Nomenklaturës së Shteteve dhe të Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit"</p>	<p>Rregullore e Komisionit të Bashkimit Evropian 2020/1470, datë 12 Tetor 2020 mbi Nomenklaturën e Shteteve dhe Territoreve për Statistikat Evropiane për Tregtinë Ndërkombëtare të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit.</p>	<p>Klasifikimi i Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe Ndarjen Gjeografike për Statistikat e Tjera të Biznesit. (GEONOM)</p>

XI. Zbatimi i Rekomandimeve

Rekomandimet e Kuvendit

Rekomandimi 1

Të publikojë raportet e rekomandimeve të lëna nga Këshilli i Statistikave dhe aktet e miratuara nga Bordi Drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, si dhe të publikohet pjesëmarrja e anëtarëve dhe mënyra e votimit.

Statusi: Realizuar

Këshilli i Statistikave, në mbledhjen e tij të datës 05.11.2020 ka vendosur të publikojë të gjitha aktet e miratuara në faqen zyrtare të INSTAT, pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhje si dhe përmbledhësen e çështjeve të diskutuara në mbledhje sipas rendit të ditës.

Për vitin 2021 nuk ka patur akte të miratuara nga Këshilli. Dokumentacioni i mbledhjeve gjendet i publikuar në faqen elektronike të INSTAT-it:

<http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/keshilli-i-statistikave/mbledhjet-e-keshillit-te-statistikave/>

Ndërkohë, aktet e Bordit Drejtues së bashku me agjendën ku pasqyrohen rendi i ditës dhe pjesëmarrja, janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT-it.

Rekomandimi 2

Të marrë masa për funksionimin e të gjithë mekanizmave organizativë e mbështetës, me qëllim shmangien e shtyrjes së dytë të zhvillimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave, si dhe hartimin e një strategjie efektive komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës për rëndësinë e Censit.

Statusi: Realizuar

Në zbatim të aktiviteteve të Censit për vitin 2021, parashikuar në Planin Vjetor 2021 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, nëpërmjet Urdhërit nr. 33, datë 28.05.2021 ka ngritur Njësinë e Censit, e cila parashikon strukturën, organikën dhe përgjegjësitë e sektorëve përbërës të saj, në mënyrë që të garantohet ecuria e suksesshme e aktiviteteve të parashikuara. Në muajin Tetor 2021 u zhvillua procesi i pilotimit të Censit, si dhe u analizuan gjetjet e pilotit, në mënyrë që të testohen instrumentet e parapërgatitura dhe të evidentohen problematikat e terrenit, të cilat duhet të merren parasysh gjatë kryerjes Censit vitin e ardhshëm.

Në faqen zyrtare të INSTAT-it (linku: <http://instat.gov.al/al/cens-2022/rreth-cens/publikimi-dhe-shperndarja/>) është publikuar informacioni i plotë për publikun në mënyrë që të rritet shkalla e ndërgjegjësimit të popullatës për dhënien e informacionit dhe besueshmëria në statistikën e prodhuara. Me mbështetjen e donatorëve, ekipe të posaçme të INSTAT-it janë shpërndarë në të gjitha zonat e pilotimit për të organizuar tryeza të rrumbullakëta me përfaqësuesit e grupeve të interesit. Veprimtaria dhe rezultatet e këtyre takimeve janë publikuar po ashtu në faqen elektronike të INSTAT-it.

Për t'iu përshtatur kërkesave dhe kushteve të reja, Strategjia e Censit është riparë dhe publikuar në faqen elektronike gjithashtu (<http://instat.gov.al/media/9000/strategjise-dhe-planifikimit-censit-2022.pdf>). Një pjesë e mirë e komponentëve të strategjisë përmbajnë edhe elementët e komunikimit për Censin Pilot, gjë që janë në fazën e zbatimit në terren.

Rekomandimi 3

Të raportojë ecurinë e planit të punës për kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave në raportet 4-mujore për ecurinë e Programit të Statistikave Zyrtare që i paraqiten Këshillit të Statistikave dhe këto raporte të publikohen në faqen zyrtare të INSTAT-it.

Statusi: Realizuar

Ecuria e planit të punës për kryerjen e Censit është pjesë e Raporteve 4-mujor të INSTAT për zbatimin e Planit Vjetor 2021 (Fusha statistikore nr. 1 "Statistikat Demografike-Sociale), të cilat i paraqiten Këshillit të Statistikave. Raportet janë publikuar në linkun:

<http://instat.gov.al/al/rreth-nesh/keshilli-i-statistikave/mbledhjet-e-keshillit-te-statistikave/>

Rekomandimi 4

Të intensifikojë rolin e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare veçanërisht në proceset e përgatitjes së projekt-Programit të Statistikave Zyrtare, si dhe të publikohet veprimtaria e tij në faqen zyrtare.

Statusi: Në proces

Për realizimin e këtij rekomandimi institucionet e përfaqësuara në këtë Komitet kanë kontribuar në procesin e përgatitjes së Projekt-Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026 dhe Projekt-Planin e PSZ 2022 sipas fushave të kompetencës që parashikojnë këto dokumente. Ky bashkëpunim u iniciua me takimin e parë të Komitetit në 25 Dhjetor 2020 dhe ka vijuar gjatë gjithë vitit 2021, duke u materializuar me zhvillimin e takimeve konsultative gjatë periudhës Maj-Qershor 2021, si rezultat i të cilave u përcaktuan aktivitetet dhe indikatorët statistikore që do të kryhen/prodhohen gjatë harkut kohor 2022-2026.

Rekomandimi 5

Të paraqesë brenda vitit projekt-Programin e ri të Statistikave Zyrtare 2022-2026 sipas strukturës së parashikuar nga legjislacioni për statistikat zyrtare, por edhe për të siguruar një Sistem Kombëtar Statistikor me pjesëmarrje më të gjerë institucionesh publike.

Statusi: Realizuar

Gjatë vitit 2021, INSTAT në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore, institucionet furnizuese me të dhëna administrative dhe të gjithë grupet e interesit përgatiti Projekt-Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026 dhe Projekt-Planin e PSZ 2022. Përgatitja e Programit iu nënshtua një procesi gjithëpërfshirës konsultativ dhe kontribues të gjithë aktorëve të Sistemit Kombëtar Statistikor. Në muajin Nëntor, 2021, u dërgua në Kryeministri Projekt-PSZ 2022-2026, ndërsa në Dhjetor u dërgua Projekt-Plani i PSZ 2022.

Rekomandimi 6

Të finalizojë hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Censin e Bujqësisë duke planifikuar dhe detajuar elementet më të rëndësishme të projektit, të përgatisë kuadrin rregullator dhe të vlerësojë burimet dhe aktorët që do të përfshihen.

Statusi: Në proces

Pandemia globale COVID-19, si në të gjithë botën, po ndikon në aktivitetet e INSTAT, përfshirë punën përgatitore për të dyja cens-et, si atë të Popullsisë dhe Banesave ashtu dhe për atë të Bujqësisë. Për këtë

arsye, duke qenë se Censi i Popullsisë dhe Banesave u shty nga viti 2020 në vitin 2022, ashtu edhe censi i rradhës i Bujqësisë u shty me dy vite (nga viti 2022 i parashikuar më parë, në vitin 2024).

Në zbatim të këtij rekomandimi të Kuvendit të Shqipërisë, INSTAT ka hyrë në fazën përgatitore për realizimin e Censit të Bujqësisë. Fillimisht, INSTAT hartoi draft strategjinë dhe planin e veprimit të Cens-it të Bujqësisë me mbështetjen e ekspertizës ndërkombëtare nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO). Strategjia përshkruan kërkesat ligjore, teknologjike, operacionale dhe buxhetore për aktivitetin. Në aspektin e përcaktimit të kuadrit ligjor për kryerjen e censit, brenda vitit 2022 INSTAT do të hartojë projektligjin e ri “Për censin e bujqësisë dhe fermave bujqësore” i cili do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Projektakti do të mundësojë përafrimin e standardeve të reja, duke ndjekur rekomandimet e Programit Botëror për Censet e Bujqësisë 2020. Në këtë drejtim, INSTAT ka përfshirë projektligjin në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2021-2023.

Rekomandimi 7

Të marrë masa konkrete në drejtim të automatizimit të proceseve të punës, të zhvillojë dhe testojë sistemet e Teknologjisë së Informacionit për pyetësonin elektronik e sistemin e monitorimit të procesit në terren dhe të sigurohet për trajnimin e përdoruesve të këtyre sistemeve.

Statusi: Në proces

Me qëllim përmbushjen e këtij rekomandimi, INSTAT-i është angazhuar në lidhje me modernizimin e teknologjive për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e aktiviteteve statistikore. Për përmirësimin e teknikave të grumbullimit të informacionit statistikor, INSTAT-i është duke përdorur metoda moderne si CAPI apo CAWI (mbledhja e të dhënave me tablet/laptop dhe mbledhja e të dhënave nëpërmjet internetit) të cilat përmirësojnë cilësinë, kohën e kapjes dhe përpunimit të të dhënave, dhe reduktojnë afatin e publikimit të tyre. Për vitin 2021, metoda CAPI është përdorur në tetë aktivitete të realizuara nga INSTAT ndërsa metoda CAWI është përdorur në katër aktivitete. Metoda CAPI do të përdoret edhe për Censin 2022 ku për këtë qëllim INSTAT-i është duke punuar për ndërtimin e aplikacioneve për mbledhjen dhe monitorimin në kohë reale nëpërmjet tableteve. Janë zhvilluar për Pilot Cens edhe aplikacionet e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave, të cilët janë aktualisht duke u përdorur nga stafi në terren.

Për të mbështetur dhe monitoruar modernizimin e proceseve prodhuese, INSTAT kryen një sërë procesesh vlerësimi të hardware dhe software në dispozicion të prodhimit statistikor për automatizimin dhe standardizimin e procesve të punës. Në përputhje me Kodin e Praktikës, prioritet i lartë i është dhënë edhe sigurisë së Informacionit. Në këtë kuadër gjatë vitit 2021 është zhvilluar një web-service (metodë transmetimi të sigurt të të dhënave administrative) për të ulur ngarkesën e të intervistuarve, rritur cilësinë statistikore dhe përmirësuar metodat e shpërndarjes dhe komunikimit.

Rekomandimi 8

Të përafrojë në vazhdimësi standardet sipas Parimeve të Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane me synim përmirësimin e proceseve të mbledhjes, përpunimit, publikimit të të dhënave dhe rritjen e besueshmërisë në statistikat zyrtare.

Statusi: Në vazhdimësi

Në interes të zbatimit të parimeve statistikore, INSTAT, jo vetëm si prodhues i statistikave zyrtare, por edhe si koordinator i Sistemit Kombëtar Statistikor, është angazhuar në disa drejtime:

Pavarësia profesionale e statistikienëve është garantuar me ligj. Referuar legjislacionit për statistikat zyrtare, INSTAT ka një autonomi të zgjeruar përsa i takon menaxhimit të burimeve njerëzore dhe financiare. Standardet statistikore dhe metodologjia e prodhimit statistikor vendoset nga vetë INSTAT. Produktet statistikore sipas Planit Vjetor, por edhe ato të gjeneruara me mbështetjen e donatorëve, raportohen rregullisht në Eurostat.

Ligji për statistikat zyrtare jep prodhuesve të statistikave zyrtare *mandat* të fortë për mbledhjen e të dhënave dhe aksesin në të dhënat administrative. Shkalla e përgjigjes për informacion nga popullata është në nivele të kënaqshme, duke patur parasysh mënyrën e intervistimit *derë më derë* nëpërmjet anketave.

Burimet financiare dhe njerëzore kanë qenë të mjaftueshme për prodhimin e statistikave zyrtare të planifikuara në Planin Vjetor 2021. Megjithatë, duke patur parasysh kërkesat në rritje për statistika, qeveria shqiptare i ka alokuar INSTAT-it një shtesë prej 13 punonjësish për vitin e ardhshëm. Projekt-Programi i ri për Statistikat Zyrtare parashikon shtesën e mëtejshme të burimeve njerëzore dhe financiare, veçanërisht kur kemi parasysh kryerjen e Censit të Popullsisë dhe Banesave në vitin e ardhshëm.

Në zbatim të *cilësisë statistikore*, INSTAT tashmë ka arritur të dokumentojë 100% proceset e prodhimit statistikor, gjë që përmirëson më tej jo vetëm formalizimin e proceseve, por edhe transparencën ndaj publikut. Nga ana tjetër, dokumentimi i proceseve ndihmon në zhvillimin e kontrolleve dhe sugjerimin për përmirësime të mëtejshme.

Statistikat zyrtare janë *shpërndarë* sipas Kalendarit Vjetor të Publikimeve, duke *respektuar afatet e publikimit* edhe pse në kushte pandemie. Publikimi i statistikave është kryer në të njëjtën kohë dhe formë për të gjithë përdoruesit.

Për të përmirësuar *kosto-efektivitetin* por edhe të nxitur nga situata e pandemisë, INSTAT ka zhvilluar metoda të reja të mbledhjes së të dhënave nëpërmjet sistemeve CAPI, CATI e CAËI. Intervistat nëpërmjet telefonatave kanë reduktuar kostot për anketuesit dhe kohën e intervistimit. (ref. Rekomandimit nr. 7) Gjithashtu, pjesa më e madhe e publikimeve nuk kryhet më në formate libri, por në faqen elektronike kryesisht në format pdf.

Programi i ri për statistikat zyrtare do të ndikojë më tej në zbatimin e parimeve statistikore, kryesisht në *përafrimin e akteve komunitare, metodologjinë dhe koherencën*.

Rekomandimi 9

Të mundësojë prezencën në media të përfaqësuesve të INSTAT-it, me qëllim informimin e publikut të gjerë për metodat e përlllogaritjes së treguesve statistikorë në funksion të rritjes së kuptueshmërisë dhe besueshmërisë në statistikat zyrtare të prodhuara.

Statusi: Në proces

Në vitin 2021, në zbatim të masave kundër Covid-19 INSTAT ka realizuar 2 konferenca për median. Konferencat kanë patur si qëllim informimin mbi aktivitetet dhe publikimet e statistikave të INSTAT-it: Konferenca mbi njoftimin e fillimit të Pilotit të Censit të Popullsisë dhe banesave ku bëri të ditur datën e fillimit të aktivitetit dhe bashkitë ku do të zhvillohet piloti dhe Konferenca për Produktin e Brendshëm Bruto, ku INSTAT kishte si qëllim të njoftonte rritjen ekonomike të vendit duke përfshirë të gjithë aktivitetet dhe kontributet që ka patur secili sektor i ekonomisë.

INSTAT figuron në median e shkruar dhe vizive pothuajse çdo ditë me artikuj apo analiza të ndryshme mbi shifrat e publikuara. Raporti vjetor i INSTAT ka parashikuar një tregues për nivelin e përmendjes së INSTAT si burim statistikor, i cili do të publikohet në katërmujorin e vitit të ardhshëm.

Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Rekomandimi 1

Instituti i Statistikave, brenda mundësive logjistike dhe në përputhje me Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare, të përfshijë edhe popullsinë shqiptare që jeton jashtë kufinjve në grumbullimin e të dhënave në lidhje me migracionin.

Në lidhje me këtë rekomandim INSTAT, është në proces dhe në varësi të miratimit të memorandumit të ri të bashkëpunimit me Drejtorin e Përgjithshme të Gjendejës Civile, pjesë e të cilit do të jetë dërgimi i të dhënave për Shtetasit Shqiptarë me vendbanim jashtë vendit.

Rekomandimi 2

Ministria e Brendshme dhe Ministria e e Financave në bashkëpunim me INSTAT, të formalizojnë formatet tip të të dhënave administrative dhe statistikore në funksion të hartimit të saktë të Profilit të Migracionit dhe Strategjisë Kombëtare të Migracionit si dhe në harmoni me standartet ndërkombëtare të raportimeve të fushës.

Në zbatim të këtij rekomandimi, gjatë vitit 2021 u iniciua puna për standardizimin e formateve të të dhënave administrative në përputhje me rregulloren e Eurostat 862/2007 mbi Statistikat e Migracionit dhe Mbrojtjes Ndërkombëtare, gjithashtu është përgatitur dhe një Udhërrëfyes për Statistikat e Migracionit në Shqipëri në bashkëpunim me IOM (Organizata Ndërkombëtare e Migracionit). Në vazhdim të standardizimit të të dhënave administrative janë hartuar formate tabelash dhe janë dërguar në institucionet përkatëse (MB/ Ministria e Brendshme dhe DKM/Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit) me shkresë zyrtare Shkresa nr. 1007 prot. dhe shkresa nr.1073 prot.).

Kthimi i përgjigjeve ka ardhur nga institucionet përkatëse, por jo në formatet e tabelave të standartizuara. Shkresa nr.1007/1 prot. datë 14.06.2021 dhe shkresa nr.1037/1 prot. datë 29.06.2021).

Rekomandimi 3

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Shërbimin kombëtar të Punësimit dhe Aftësive dhe INSTAT të hartojë Memorandume bashkëpunimi për të saktësuar tipologjinë e mbledhjes, raportimit dhe afateve të të dhënave statistikore sipas fushës së veprimtarisë në Profilin e Migracionit.

INSTAT ka kryer takime me përfaqësues të institucioneve në fjalë në kuadër të rishikimit të aneksit të Memorandumit të bashkëpunimit, Nr. 474/6 Prot., datë 19.11.2018 dhe në kuadër të takimeve për përgatitjen e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, janë diskutuar të dhënat e nevojshme sipas formateve të kërkuara me përfaqësues nga Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

INSTAT po vlerëson nga ana metodologjike të dhënat e siguruar nga AKPA, si dhe po analizon mundësinë e përdorimit të tyre në prodhimin e statistikave zyrtare.

Rekomandimi 4

INSTAT në funksion të përdorimit të informacionit real, të bashkëpunojë me Ministrinë e Brendshme për hartimin e modaliteteve të përdorimit të sistemit të përbashkët të të dhënave mbi popullsinë dhe migrantët duke zbatuar njëherësh edhe rolin e saj kordinues për Sistemin Kombëtar të Statistikave në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin prej nenit 12 të Ligjit nr. 17/2018 Për statistikat zyrtare.

Në lidhje me këtë rekomandim INSTAT, është në proces miratimi të një memorandumi të ri me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku pjesë e këtij memorandumi do të jetë dërgimi i të dhënave për Shtetasit Shqiptarë me vendbanim jashtë vendit, si dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm në përmirësimin e të dhënave mbi migracionin në përgjithësi, sipas shkresës nr.638/1 prot., datë 11.06.2021.

Rekomandimet e Peer Review 2018

Raporti i Peer Review 2018 parashikon 24 rekomandime, të operacionalizuara në 53 aktiviteteve zbatuese-përmirësuese.

Gjatë vitit 2021 ka vijuar puna në funksion të jetësimit të 3 aksioneve madhore si: Forcimi i Mjedisit Institucional; Zhvillimi i mëtejshëm i menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të raportit kosto-efektivitet; Përmirësimi i komunikimit me përdoruesit dhe aktorët e tjerë, dhe situata aktuale e zbatimit të rekomandimeve dhe aktiviteteve përmirësuese që derivojnë nga këto 3 shtylla kryesore është si vijon:

1. Forcimi i mjedisit institucional

Nga 9 rekomandime në total, janë realizuar 8 prej tyre, të cilat kanë të bëjnë me krijimin e instrumentave të duhur për forcimin e koordinimit të Sistemit Kombëtar Statistikor; sigurimin e konfidencialitetit statistikor dhe aksesin në të dhënat administrative; përmirësimin e imazhit të INSTAT dhe menaxhimin e cilësisë. Është në proces përbushje 1 rekomandim, i cili ka të bëjë me zgjerimin e Sistemit Kombëtar Statistikor.

Në zbatim të Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, INSTAT ka filluar diskutimet me institucione të cilat mund të konsiderohen potencialisht si prodhues të statistikave zyrtare. Pasi të kryhet një proces vlerësimi i statistikave dhe infrastrukturës ligjore përkatëse, INSTAT do të propozojë institucionet konkrete për tu përfshirë në Sistemin Kombëtar Statistikor.

Nga 19 aktivitete përmirësuese, janë realizuar 15 prej tyre që lidhen kryesisht me forcimin e sistemit Kombëtar Statistikore nëpërmjet krijimit të Komitetit të prodhuesve, rritjen e vizibilitetit të veprimtarisë së Këshillit të Statistikave dhe veprimtarisë së INSTAT në tërësi, si dhe ngritjen e Komitetit të Konfidencialitetit shoqëruar me hartimin e Politikës së Konfidencialitetit. Ndërkohë janë në proces zbatimi 3 aktivitete që lidhen me:

- Hartimin e listës së burimeve administrative si dhe përgatitjen e inventarit për statistikat jo zyrtare të prodhuara nga institucione të tjera publike. Me përgatitjen e projekt-Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026 është hartuar lista e institucioneve që ofrojnë të dhëna administrative, ndërsa për inventarizimin e të jo zyrtare, INSTAT ka planifikuar të kryej një anketë për marrjen e këtij informacioni nga institucionet që aktualisht prodhojnë statistika jo zyrtare.

- Përgatitjen e listës së institucioneve që mund të konsiderohen potencialisht si agjenci statistikore. Siç dhe është përmendur më lart, INSTAT ka filluar komunikimet dhe diskutimet me 2 institucione që potencialisht mund të konsiderohen si agjenci statistikore: Autoritetin për Mbikëqyrjen Financiare dhe Agjencinë Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë, të cilat gjatë takimeve konsultative për hartimin e PSZ 2022-2026 kanë shprehur gatishmërinë e tyre nga ana e infrastrukturës statistikore për prodhimin e statistikave zyrtare.

- Vlerësimin e të gjithë legjislacionit kombëtar për çdo kërcënim që mund të paraqitet në legjislacionin statistikor. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit ka përgatitur draft-ligjin e ri, i cili është në përputhje me rregulloren në fuqi të këtij institucioni, dhe që do t'i paraqitet Kuvendit gjatë vitit 2022. Ky draft-ligj është në përputhje me legjislacionin mbi statistikat zyrtare dhe masat për forcimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

Është anuluar/modifikuar 1 aktivitet që lidhet me ndryshimin e PSZ, pasi në Dhjetor, 2021, u dërgua në Kryeministri Projekt-Programi i ri i Statistikave Zyrtare 2022-2026.

2. *Zhvillimi i mëtejshëm i menaxhimit të cilësisë dhe përmirësimit të raportit kosto-efektivitet*

Nga 10 rekomandime në total, janë realizuar 9 prej tyre, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e përdorimit të teknikave elektronike për mbledhjen e të dhënave, hartimin e udhëzimeve metodologjike për të gjithë produktet statistikore, pilotimin dhe zbatimin e metodës së standardizuar për prodhimin statistikor, harmonizimin e proceseve statistikore në drejtim të GSBPM, rritjen e indikatorit të performancës lidhur me afatet kohore të realizimit të produkteve statistikore, matjen sistematike të ngarkesës së përgjigjeve për të gjithë anketat, përcaktimin e indikatorit të performancës dhe raportit kosto-efektivitet etj.

Është në proces realizimi i rekomandimit që lidhet me intensifikimin e marrëdhënieve të shërbimit postar për aktivitetin e mbledhjes së të dhënave, për të cilin do të ndërmerren disa hapa bashkëpunimi gjatë vitit 2022.

Nga 23 aktivitete përmirësuese në total, janë realizuar 21 aktivitete që lidhen me pilotimin dhe përdorimin e metodave elektronike për mbledhjen e të dhënave për aktivitetet statistikore për të cilat nuk janë aplikuar më parë këto metoda, krijimin e udhëzimeve metodologjike për të gjithë produktet statistikore, vendosjen e linjave të duhura të bashkëpunimit me NSI-të tjera për zbatimin e duhur të GSBPM si dhe për harmonizimin e tij, kryerjen e pilotit të vetëvlerësimit dhe auditimit, shtimin e indikatorëve të performancës për afatet kohore të anketave, testimin e SIPK si dhe matjen e indikatorit mbi kosto-efektivitetin gjatë realizimit të aktiviteteve.

Është në proces aktiviteti që ka të bëjnë me Intensifikimin e marrëdhënieve me shërbimin postar për aktivitetin e mbledhjes së të dhënave. Gjatë vitit 2022 INSTAT do të tentojë të intensifikojë këto marrëdhënie për aplikimin e shërbimit postar të paktën për anketat ekonomike në ndërmarrje, ku si fillim do të të procedohet me dërgimin e një letre informuese subjekteve që janë pjesë e kampionit. Në vijim do të shikohet ecuria e këtij aksioni.

Ndërkohë është anuluar aktiviteti që lidhet me përdorimin e shërbimit postar për shpërndarjen e pyetësorëve të vrojtimit, pasi INSTAT nuk ka parshikuar anketa për të cilat aplikohet metoda e vetëplotësimit nga njësitë statistikore.

3. *Përmirësimi i komunikimit me përdoruesit dhe aktorët e tjerë*

Nga 5 rekomandime në total, janë realizuar 4 prej tyre, që kanë të bëjnë me vizibilitetin e Veprimtarisë së Këshillit të Statistikave, ngritjen e grupeve të përhershme të përdoruesve si zgjerimin e grupeve me përdorues të rinj, përmirësimin e cilësisë së publikimeve, përfshirjen në PSZ bashkëpunimin me botën akademike. Ndërkohë është në proces rekomandimi për forcimin e bashkëpunimit me botën akademike.

Nga 11 aktivitete përmirësuese në total, janë realizuar 9 prej tyre dhe janë në proces 2 aktivitete të tjera që i dedikohen:

-Rritjes së bashkëpunimit me botën akademike me anë të trajnimeve apo bashkëpunimit në përgatitjen e artikujve shkencorë. Siç dhe është përmendur më lart, INSTAT ka përgatitur ëëbinarin për lançimin e numrit të radhës të revistës shkencore, si një hap drejt përfshirjes së botës akademike në procesin e përgatitjes së artikujve shkencorë, që përgatit terrenin për forcimin e bashkëpunimit në zhvillimin e metodave të reja shkencore në procesin e prodhimit statistikor.


-Dokumentimit të projekteve shkencore që kanë përdorur të dhëna mikro si dhe rezultateve të tyre, i cili është një proces i vazhdueshëm.

Përmbledhje


Nga 24 rekomandime në total, janë finalizuar 20 prej tyre dhe 4 të tjera janë në proces realizimi. Ndërkohë nga 53 aktivitete përmirësuese, janë realizuar 45 prej tyre, 6 të tjera janë në proces realizimi dhe 2 aktivitete janë anuluar.

Më poshtë paraqiten grafikët për statusin aktual të rekomandimeve dhe aktiviteteve përmirësuese:

Grafiku.1. Statusi aktual i rekomandimeve përmirësuese



Grafiku 2. Statusi aktual i aktiviteteve përmirësuese



XII. Burimet financiare dhe njerëzore

Burimet Financiare

INSTAT është institucion publik qëndror, i pavarur, burimet e financimit për kryerjen e aktiviteteve statistikore dhe atyre mbështetëse sigurohen kryesisht nga buxheti i shtetit. Ndikim domethënës kanë edhe financimet e huaja nëpërmjet donatorëve apo granteve të alokuara nga ata, si dhe të ardhurat dytësore apo fondet jashtë limitit, të cilat sigurohen nga veprimtaritë dytësore që kryen INSTAT.

Për vitin 2021 janë shpenzuar nga buxheti i shtetit rreth 543 milion lekë, së bashku me donatorët janë shpenzuar 749 milion lekë sipas tabelës së më poshtme:


Tabela nr. 12: Shpenzimet 2013-2021 (mijë/lekë)

FAKT					
SHPENZIMET	2017	2018	2019	2020	2021
Paga + kontribut	349,893.0	396,913.0	466,708.8	423,141.9	455,529.6
Mallra dhe shërbime të tjera	67,427.0	62,330.0	79,440.6	47,887.6	37,091.5
Totali operative	417,320.0	459,243.0	546,149.4	471,029.6	492,621.1
Investime	18,902.0	27,560.0	28,994.4	44,766.8	15,135.3
TOTALI BUXHETI	436,222.0	486,803.0	575,143.8	515,796.4	507,756.4
Paga + kontribut	11,526.0	9,500.0	19,134.7	32,445.1	35,269.1
Mallra dhe shërbime të tjera	17,980.0	19,853.0	1,993.4	25.7	11.3
Totali operative	29,506.0	29,353.0	21,128.1	32,470.8	35,280.4
Investime	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI nga te ardhurat	29,506.0	29,353.0	21,128.1	32,470.8	35,280.4
Paga + kontribut	1,313.0	2,080.0	962.3	9,425.7	3,174.3
Mallra dhe shërbime të tjera	18,453.0	21,009.0	25,219.2	18,406.8	86,566.2
Totali operative	19,766.0	23,089.0	26,181.5	27,832.4	89,740.6
Investime		2,366.0	1,920.0	21,347.5	0.0
Te ardhura jashtë limiti	19,766.0	25,455.0	28,101.5	49,180.0	89,740.6
Paga + kontribut	1,746.0	3,666.0	23,262.0	7,071.4	7,093.7
Mallra dhe shërbime të tjera	3,950.0	9,162.0	96,209.0	14,456.3	102,400.1
Totali operative	5,696.0	12,828.0	119,471.0	21,527.7	109,493.9
Investime	25,775.0	5,879.0	45,049.0	8,095.0	6,451.6
Te ardhura donator	31,471.0	18,707.0	164,520.0	29,622.7	115,945.5
Paga + kontribut	364,477.0	412,159.0	510,067.9	472,084.1	501,066.7
Mallra dhe shërbime të tjera	107,810.0	112,355.0	202,862.2	80,776.4	226,069.2
Totali operative	472,287.0	524,513.0	712,930.0	552,860.5	727,135.9
Investime	44,677.0	35,805.0	75,963.4	74,209.3	21,586.9
TOTALI	516,964.0	560,318.0	788,893.4	627,069.8	748,722.8

Figura 14: Shpërndarja e shpenzimeve operative dhe investimeve sipas zërave për vitin 2021 me fondet e buxhetit të shtetit paraqitet si më poshtë:

Art	SHPENZIMET	PL Vjetor	PL i Rishikuar	Fakti	Real ne %
600	Paga	529,614.0	430,614.0	420,463.8	97.6
601	Kontribute sig shoq-shend	86,812.0	72,012.0	70,334.8	97.7
602	Mallra dhe sherbime te tjera	88,000.0	42,890.0	35,795.6	83.5
604	Transferime korente	1,574.0	774.0	729.3	94.2
606	Transferime buxhetesh familjare	0.0	1,100.0	578.0	52.5
	SHUMA	706,000.0	547,390.0	527,901.5	96.4
	Investime Aparati Qendror	219,600.0	17,300.0	15,135.3	87.5
231	Investime buxheti	219,600.0	17,300.0	15,135.3	87.5
	TOTALI	925,600.0	564,690.0	543,036.8	0.96

Figura 15: Shpërndarja e shpenzimeve operative dhe investimeve



Siç shihet nga grafiku volumin kryesor të shpenzimeve ndër vite e zë pjesa e pagave të stafit të INSTAT-it dhe paga e personave të kontraktuar me kohë të pjesshme.

Instituti të Statistikave për vitin ushtrimor 2021 i janë akorduar nga buxheti i shtetit 796,690 mijë lekë nga 758,624 mijë lekë të akorduara në vitin 2020, ose 38,336 mijë lekë më shumë.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2021 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 543,037 mijë lekë.

Realizimi i shpenzimeve të Aparatit Qëndror INSTAT dhe Zyrave të Statistikave në rrethe, sipas zërave.

Tabela nr. 13: Realizimi i shpenzimeve Janar - Dhjetor 2021

mijë/lekë

VITI 2021					
Art	SHPENZIMET	PL Vjetor	PL i Rishikuar	Fakti	Real ne %
600	Paga	529,614.0	430,614.0	420,463.8	97.6
	Zyrat Rajonale	34,036.0	32,416.0	31,379.6	96.8
	Aparati Qendror nga buxheti	463,314.0	365,934.0	358,916.3	98.1

	Aparati Qendror nga të ardhurat	32,264.0	32,264.0	30,168.0	93.5
601	Kontribute sig shoq-shend	86,812.0	72,012.0	70,334.8	97.7
	Zyrat Rajonale	5,691.0	5,691.0	5,243.1	92.1
	Aparati Qendror nga buxheti	75,737.0	60,937.0	59,990.7	98.4
	Aparati Qendror nga të ardhurat	5,384.0	5,384.0	5,101.1	94.7
602	Mallra dhe sherbime te tjera	88,000.0	42,890.0	35,795.6	83.5
	Zyrat Rajonale	6,046.0	5,436.0	4,562.2	83.9
	Aparati Qendror nga buxheti	79,954.0	35,454.0	31,222.1	88.1
	Aparati Qendror nga te ardhurat	2,000.0	2,000.0	11.3	0.6
604	Transferime korente	1,574.0	774.0	729.3	94.2
	Aparati Qendror nga buxheti	1,574.0	774.0	729.3	94.2
606	Transferime buxhetesh familjare		1,100.0	578.0	52.5
	SHUMA	706,000.0	547,390.0	527,901.5	96.4
	Investime Aparati Qendror	219,600.0	249,300.0	131,080.8	52.6
230	Investime				0.0
231	Investime buxheti	219,600.0	17,300.0	15,135.3	87.5
	Financim i huaj	0.0	232,000.0	115,945.5	50.0
	Të ardhura jashtë limitit	0.0	0.0	89,740.6	#DIV/0!
	TOTALI	925,600.0	796,690.0	748,722.8	94.0

Siç shihet nga pasqyra, në artikullin 600, *Paga*, janë shpenzuar 420,464 mijë lekë e barabartë kjo me 97,6% të vlerës së parashikuar në Planin Vjetor.

Mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mosplotësimi i 14 vendeve vakante të strukturës organike dhe shtyrja në afate të anketimeve për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.

Në artikullin *Sigurime shoqërore e shëndetësore* janë shpenzuar 70,335 mijë lekë, e barabartë kjo me 97.7% të vlerës së parashikuar në Planin Vjetor. Ky mosrealizim ka ardhur si rezultat i mosrealizimit të fondit të pagave.

Në zërin *Mallra dhe shërbime të tjera*, për vitin 2021, janë shpenzuar 35,796 mijë lekë, e barabartë kjo me 83.5% të vlerës së parashikuar në Planin Vjetor. Mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i procedurave të prokurimeve.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2021 për zërin *Transferta korrente të brendshme* është 774 mijë lekë dhe nga këta janë shpenzuar 730 mijë lekë, ose 94.2% e fondit.

Gjatë vitit 2021 për zërin *Transferta për buxhete familjare* janë shpenzuar 578 mijë lekë, ose 52.5%.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm është 15,135 mijë lekë ose 87,5% e totalit.

Realizimi i shpenzimeve me Financim të Huaj për vitin 2021 është 115,946 mijë lekë ose 50 %.

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për vitin 2021 janë 89,741 mijë lekë.

Këto fonde INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistike”.

Tabela nr. 14: Buxheti sipas programit “Veprimtaria Statistike”


Mijë /lekë

	SHPENZIMET	Plani	Fakti	% Realizimit
	Veprimtaria Statistike	564,690.0	543,036.8	96.2 %
	Të ardhura jashtë limitit	89,740.6	89,740.6	100 %

	TOTALI	654,545.8	632,777.4	96.6%
--	---------------	------------------	------------------	--------------

Për programin e *Veprimtarisë Statistike* për vitin 2021 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 543,037 mijë lekë, ose 96,2% e vlerës së parashikuar në PlaninVjetor, nga të *Ardhurat jashtë limitit* janë shpenzuar 89,741 mijë lekë, në total janë shpenzuar 632,777 mijë lekë.

Figura nr. 16: Buxheti 2021



Siç shihet nga të dhënat e tabelës, plani i shpenzimeve të buxhetit në artikullin 600+601 (paga dhe sigurime), që zë rreth 63% të tij është realizuar 97,6% e planit të parashikuar, në artikullin 602 *Mallra dhe shërbime të tjera* që zë 6% te buxhetit është realizuar 82.9% e planit të parashikuar dhe në artikullin 231 *shpenzime për investime* që zë 31% të buxhetit është realizuar 52,5% planit të parashikuar.

Burimet Njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është i orientuar në zhvillimin e aftësive të punonjësve, mbështetjen në punë, identifikimin dhe trajnimin e tyre, duke synuar përfshirjen e personelit dhe rritjen e angazhimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe rritjes së vazhdueshme të performancës.

Në këtë kuadër, INSTAT ka ndërmarrë disa hapa dhe është në proces të vazhdueshëm të hartimit të politikave dhe strategjive që ndihmojnë në arritjen e objektivave institucionale dhe zhvillimin e aftësive të punonjësve.

Në funksion të përmirësimit të rezultateve të kënaqësisë së punonjësve, INSTAT kryen anketën e kënaqësisë së punonjësve, si një strategji të vazhdueshme mbi analizën e faktorëve që ndikojnë në uljen apo rritjen e kënaqësisë së punonjësve dhe hartimin e planit të veprimit mbi rritjen e kënaqësisë së punonjësve.


Gjatë vitit 2021, në zbatim të Strategjisë së trajnimeve të INSTAT si dhe kalendarit vjetor të trajnimeve janë realizuar trajnime të vazhdueshme si brenda dhe jashtë venditme qëllim ngritjen, përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të njohurive profesionale.

Gjithashtu INSTATgjatë vitit 2021, ka vijuar zhvillimin e procedurave të rekrutimit për shërbimin civil në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, nëpërmjet sistemit online të rekrutimeve në faqen eëb: www.rekrutime.instat.gov.al, proces i filluar në muajin Shkurt 2021.

Në organikën e INSTAT, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 127/2018 datë 29.12.2018, numri i punonjësve të miratuar është 236 punonjës (187 punonjës në qendër dhe 49 punonjës në zyrat rajonale).

Përsa i përket raportit gjinor të punonjësve të INSTAT, ashtu si dhe në vitet e mëparshme, në përbërjen e stafit të INSTAT kryeson gjinia femërore. Përqindja që zënë femrat në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve është 69% kundrejt meshkujve që zënë 31% të totalit.

Figura nr. 17: Numri i punonjësve në raportin Femra/Meshkuj:



Rekrutime

Njësia Përgjegjëse në INSTAT gjatë vitit 2021 ka përfunduar procedurat e rekrutimeve sipas Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin civil" për 28 pozicione vakante.

Rekrutimi i nëpunësve të INSTAT-it kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Rekrutimi i nëpunësve kryhet nga Drejtoria e Financës dhe Projekteve në cilësinë e Njesisë Përgjegjëse të INSTAT.

Gjatëvitit 2021 janë publikuar në faqen e INSTAT dhe në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit - shpallje për 28 pozicione gjithsej.

1.Rekrutimet për kategorinë ekzekutive të shërbim civil (Specialistë).

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimeve për 22 punonjës, nga të cilët:

- 5 punonjës janë rekrutuar me procedurë të lëvizjes paralele.
- 14 punonjës janë rekrutuar me procedurën e pranimit në shërbim civil (3 punonjës janë pranë Zyrate Rajonale).
- 2 pozicione nuk janë plotësuar sepse nuk ka patur fitues.
- 1 pozicion është plotësuar nga lista e pritjes, ndërkohë që ka dhe 1 person në listë pritje.

2. Rekrutime për kategorinë e nivelit i ulët drejtues (Përgjegjës Sektori).

Kanë përfunduar procedurat e rekrutimit për 2 pozicione (rekrutuar 1 punonjës), nga të cilët:

- 1 punonjës është rekrutuar me procedurë të ngritjes në detyrë
- 1 pozicion nuk është plotësuar sepse nuk ka patur fitues

3. Rekrutime për nëpunës civil të Nivelit të Lartë Drejtues (TND).

Janë shpallur 2 pozicione të Nivelit të Lartë Drejtues (TND),

- Ehtë përfunduar procedura rekrutimit për 1 punonjës
- 1 pozicion tjetër mbyllur pa fitues.

Punonjës me kontratë afatgjatë dhe me kontratë afatshkurtër

Gjatë vitit 2021 janë kontraktuar 387 punonjës me kontratë afatgjatë në pozicionet: kontrollor, kontrollor anketimi, operator dhe anketues. Numri i punonjësve me kontratë afatshkurtër ka qenë 607, të punësuar në pozicionet: anketues me kontratë të përkohshme në pozicionet sipas anketave, anketues, operatorë dhe kontrollorë ankete.

Trajnimet e stafit

-Gjatë vitit 2021, në zbatim të Programit shumëpërfitues të bashkëpunimit IPA 2017 është zhvilluar 1 trajnim afatgjatë, ku është trajnuar 1 punonjës si dhe nga trajnimet afatshkurtra të zhvilluara gjatë vitit janë trajnuar 53 punonjës.

-Gjithashtu, gjatë vitit 2021, Instituti i Statistikave, në zbatim të ligjit 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" si dhe të planit vjetor të trajnimeve, ka zhvilluar 11 trajnime për punonjësit e INSTAT, ku janë trajnuar 130 punonjës.

-Me mbështetjen e Projektit SALSTAT (Strong Albanian Local Statistics) financuar nga Swiss Development Cooperation Office (SDC) janë kryer 4 trajnime dhe kanë marrë pjesë 20 punonjës të INSTAT dhe 234 punonjës të Bashkive.

-Me mbështetjen e Projektit Sida është kryer 1 trajnim në cilin janë trajnuar 10 punonjës të INSTAT.

-Gjatë vitit 2021, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka kryer një sërë trajnimesh me tema, të cilat përfshijnë kategori të ndryshme njohurish dedikuar nivelit ekzekutiv apo drejtues, ku për 21 tema trajnimi janë trajnuar gjithsej 46 punonjës, si dhe i janë nështruar trajnimit të detyrueshëm për marrjen e statusit nëpunësit civil 19 punonjës të INSTAT.

Tiranë, 31 Mars 2022